

AFTËSI PËR PUNË

RAPORT STUDIMOR

Porositur nga:

Zhvilluar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



AFTËSI *për* **PUNË**

raport studimor

2016

Ky raport është porositur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Ambasada e Zvicrës në Shqipëri përmes projektit 'Aftësi për Punë'. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

Autorë të Raportit (në rend alfabetik)

Aleka Papa
Elona Dhëmbo (PhD)
Esmeralda Shehaj (PhD)
Sidita Dibra (PhD)

Kryeredaktor

Fation Dragoshi

Ky botim është pjesë e një serie raportesh dhe dokumentesh të prodhuara për nevojat e projektit 'Aftësi për Punë' me mbështetjen e SDC nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim – IDM nëpërmjet një skuadre kërkuesish shkencorë dhe ekspertësh pjesë e Grupit Kryesor Kërkimor dhe grupit të Ekspertëve dhe Kërkuesve të Lartë të cilët kanë kontribuar pjesërisht për këtë raport:

Grupi Kryesor Kërkimor (në rend alfabetik)

Elona Dhëmbo (PhD)
Esmeralda Shehaj (PhD)
Fation Dragoshi
Henry Leerentveld
Iris Batalli
Sidita Dibra (PhD)

Kërkuesit e Lartë (në rend alfabetik)

Alban Karapici
Ana Ktona (PhD)
Blendi Gërdoçi (PhD)
Prof. Ass. Ermira Shehi (PhD)
Gavrosh Zela (PhD(c))
Prof. Ilia Kristo (PhD)
Mimoza Agolli (PhD(c))
Prof. Mimoza Kasimati (PhD)
Rigers Bakui (PhD)
Selami Xhepa (PhD)

Gjuha origjinale Anglisht. Përkthyer në Shqip: Durim Tabaku

Faqesja: Eduart Cani

Foto e kopertinës: Freeimages / Eduardo Mota Silva

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime	8
Hyrje	11
Metodologjia	14
Struktura e Raportit	20
Pjesa 1: Përzgjedhja e sektorëve, qarqeve, dhe ofruesve	21
Pjesa 2. Politikat AFP në Shqipëri dhe Kuadri Institucional	24
Pjesa 3. Modalitetet e Ofrimit të AFP-së	26
Pjesa 4. Aksesit në AFP	30
4.1 Perceptimet për AFP si alternativë për zhvillimin e aftësive në Shqipëri	30
4.2 Kush përfundon në AFP dhe si?	31
Pjesa 5. Cilësia e ofrimit të AFP-së	49
5.1. Hartimi i kurrikulës	49
5.2. Mësuesit dhe instruktorët	54
5.3. Metodat e mësimdhënies	58
5.4. Materialet e mësimdhënies	60
5.5. Infrastruktura e të mësuarit	62
5.6. Administrimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional	64
Pjesa 6. Metodat TIK të të mësuarit në sistemin AFP	66
Pjesa 7. Mundësitë e punësimit, qëllimet për të ardhmen dhe pritshmëritë	77
7.1 Rezultatet e vëzhgimit të nxënësve dhe kursantëve	77
7.2 Rezultatet e vëzhgimit të mësuesve dhe instruktorëve	84
Pjesa 8. Punëdhënësit si pjesë e ekosistemit AFP	95
Pjesa 9. Përfundime	101
Referencat	108
Shtojcat	109
Shtojca I: TIK dhe Mjetet/Media e Lëvizshme në AFP	109
Shtojca II: Aktorët Ndërkombëtarë në AFP dhe Punësimi në Shqipëri	112

Lista e tabelave

Tabela 1. Lista e informuesve kyç të intervistuar	18
Tabela 2. Lista e fokus grupeve dhe intervistave	19
Tabela 3. Sektorët ekonomikë të parazgjedhur	21
Tabela 4. Faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikuar në zgjedhjen e AFP	48
Tabela 5: Struktura dhe profilet e arsimit profesional	50
Tabela 6: Raporti arsim i përgjithshëm – teoria profesionale– praktika profesionale	51
Tabela 7. Profilet e kërkuara nga tregu i punës pa regjistrime në AFP	53
Tabela 8. Dhënia e informacionit në nivel shkolle/qendre për mundësitë e punësimit	78
Tabela 9. Burimet përkatëse të informacionit për mundësitë e punësimit	79
Tabela 10. Çfarë keni ndërmend të bëni pas përfundimit të shkollës/kursit?	80
Tabela 11. Në cilën fushë mendoni se mund të gjeni punësim?	83
Tabela 12. Sa kohë mendon se mund të të duhet për të gjetur një punë pas mbarimit të shkollës?	83
Tabela 13. Faktorët më të rëndësishëm për mundësitë e punësimit	85
Tabela 14. A mendoni se nxënësit e diplomuar nga shkolla juaj kanë njohuri të mjaftueshme për të filluar punë?	86
Tabela 15. Vlerësimi i rëndësisë së njohurive dhe performancës së shërbimit të këshillimit dhe orientimit të karrierës	86
Tabela 16. Vlerësimi i instruktorëve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e programeve të shkollës me nevojat e tregut të punës (%)	89
Tabela 17. Si do ta vlerësonit nivelin e bashkëpunimit të institucionit tuaj me bizneset në lidhje me të mëposhtmet?	91
Tabela 18. Çfarë do t'iu rekomandonit drejtuesve të shkollës dhe vendim-marrësve në mënyrë që të rritet përputhshmëria e aftësive të marra në shkollë/qendër me ato që kërkon tregu i punës	92
Tabela 19. Sipas mendimit tuaj, sa përmirësim duhet në çështjet e mëposhtme në shkollën tuaj?	93

Lista e figurave dhe grafikëve

Diagrami 1. Modeli i projektimit të kërkimit	16
Diagrami 2. Trekëndëzimi i burimeve të të dhënave	17
Figura 1: Programet AFP dhe regjistrimet që i shërbejnë sektorëve të përzgjedhur ekonomikë	28
Figura 2: Regjistrimi në programet me kohë të plotë të arsimit profesional	28
Figura 3: Rrjeti i ofruesve	29
Figura 4. Gjinia dhe AFP në Shqipëri: Shpërndarja sipas profileve.	32
Figura 5. Nxënësit AFP dhe ndarja urbane/rurale	33
Figura 6. AFP dhe përfshirja e pakicave	34
Figura 7. Nxënësit AFP dhe konteksti i familjeve të tyre: Madhësia e familjes përkundër numrit të anëtarëve që sjellin të ardhura në të	34
Figura 8. Burimet alternative të të ardhurave për familjet e nxënësve AFP	35
Figura 9. Niveli i raportuar i anëtarit më të arsimuar të familjeve të nxënësve AFP	36
Figura 10. Nxënësit AFP dhe performanca e tyre akademike	36
Figura 11. Rezultatet mësimore në matematikë (nota e vitit të mëparshëm)	37
Figura 12. Vitet e shpenzuara arsimin parashkollor	38
Figura 13. Niveli i raportuar i vështirësisë për të shkuar në shkollë tek nxënësit AFP	39
Figura 14. Ku po rrini aktualisht?	39
Figura 15. A ofron shkolla juaj mundësi të barabarta?	40
Figura 16. Përqindja e atyre që besojnë se shkolla NUK ofron mundësi të barabarta duke u bazuar në:	42
Figura 17. Perceptimet e mësuesve për mungesën e mundësive të barabarta për nxënësit që të pranohen dhe të përparojnë në institucionet e AFP-së	43
Figura 18. A keni dëshmuar ndonjëherë raste të diskriminimit (në % e mësuesve që kanë dëshmuar “shpesh” dhe “shumë shpesh”)?	44

Figura 19. A ishte kjo shkollë zgjedhja jote e parë? (në % të përgjigjes "Jo")	45
Figura 20. Burimet kryesorë të informacionit për zgjedhjen e shkollës	46
Figura 21. Anëtarë të familjes me edukim AFP	47
Figura 22. Ndikimi i faktorëve për përzgjedhjen e profilit	48
Figura 23: Niveli i kënaqësisë me teorinë me praktikën dhe ngarkesën mësimore	51
Figura 24: Opinioni i mësuesve për kurrikulën	52
Figura 25. Opinioni i mësuesve dhe instruktorëve për kurrikulën	54
Figura 26: Përvoja dhe kualifikimi i mësuesve dhe instruktorëve	55
Figura 27: Opinioni nxënësve dhe kursantëve për stafin akademik	57
Figura 28: Opinioni i nxënësve sipas sektorëve për stafin pedagogjik	57
Figura 29. Trajnimet e stafit akademik	58
Figura 30: Metodatat e mësimdhënies	59
Figura 31: Metodatat e kontrollit të rezultateve	60
Figura 32: Materialet e mësimdhënies	61
Figura 33: Materialet e mësimnxënies	62
Figura 34: Nevoja për përmirësime në infrastrukturë	63
Figura 35. Përdorimi i mjeteve të teknologjisë (%)	67
Figura 36. Përdorimi i kompjuterëve në të gjithë sektorët (%).Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.	67
Figura 37. Përdorimi në përgjithësi i teknologjisë (%);Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.	68
Figura 38. Përdorimi i përgjithshëm i teknologjisë tek të gjithë sektorët (%);Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.	69
Figura 39. E kam të lehtë të mësoj të përdor pajisjet elektronike dhe programet standard të instaluar	70
Figura 40. Përdorimi i internetit nga nxënësit për studim në të gjithë sektorët (%)	71

Figura 41. Shpeshtësia e përdorimit të internetit për të studiuar në të gjithë sektorët (%)	72
Figura 42. Përdorimi nga mësuesit i faqeve të internetit për të studiuar ose përgatitur materialet mësimore (%)	72
Figura 43. Përqindja e nxënësve që nuk përdorin programe specifike të profilit në të gjithë sektorët	73
Figura 44. Perceptimi i mësuesve për përfitimet e të mësuarit të përzier (%)	75
Figura 45. Perceptimi i mësuesve për efikasitetin e metodave të ndryshme të mësimdhënies (%)	76
Figura 46. Perceptimi i mësuesve për aplikimin e të mësuarit të përzier (%)	76
Figura 47. A mendoni se me mbarimin e studimeve profesionale mundësitë e punësimit janë më të larta?	81
Figura 48. A mendoni se të diplomuarit e AFP kanë mundësi më të mira për hapjen e një biznesi të ri?	82
Figura 49. Cilët mendoni se janë 2 faktorët kryesorë që përcaktojnë hyrjen në tregun e punës?	87
Figura 50. Vlerësimi i mësuesve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e programeve të shkollës me nevojat e tregut të punës (%)	88
Figura 51. Vlerësimi mesatar i mësuesve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e kurrikulës	88
Figura 52. Vlerësimi mesatar i mësuesve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e kurrikulës	90
Figura 53. Sipas mendimit tuaj, sa përmirësim duhet në çështjet e mëposhtme në qendrën tuaj?	94
Figura 54: Karakteristikat e praktikës profesionale në mjedisin e biznesit	97
Figura 55: Përgjegjësia për praktikën profesionale në shkollat e arsimit profesional	97
Figura 56. Sa të kënaqur janë nxënësit me praktikën profesionale?	98
Figura 57. Fakte për praktikën profesionale në AFP	99
Figura 58. Nëse do të mund të filloje nga e para a do të kishe bërë të njëjtën zgjedhje?	101

Shkurtime

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AP	Arsimi profesional
ATP	Arsimi dhe Trajnimi Profesional
BE	Bashkimi Evropian
CAD/CAM	projektim i realizuar me kompjuter/prodhim i realizuar me kompjuter (Computer-aided design and computer-aided manufacturing)
CEDEFOP	Qendra Evropiane për Zhvillimin e Trajnimit Profesional (European Centre for the Development of Vocational Training)
CRT	Core Research Team
DFK	Diskutime në fokus grupe
ETF	Fondacioni Evropian i Trajnimit (European Training Foundation)
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës (International Labor Organization)
INSTAT	Instituti i Statistikave
KiE	Këshilli i Evropës
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MVP	Mësimi në vendin e punës
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (Organization for Economic Co-operation and Development)
QSF	Qendër Shumë-Funksionale
QTP	Qendra të Trajnimit Profesional
S4J	Projekti "Aftësi për Punë"
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
SKZHI	Strategjia Kombëtare dhe Zhvillim dhe Integrim
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SHP	Shkollë profesionale
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TiT	Trajnimi i trajnerëve
TP	Trajnimi profesional
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (United States Agency for International Development)
VFP	Vëzhgimi i Fuqisë Punëtore
ZP	Zyrë Punësimi
ZHAP	Zhvillimi i aftësive profesionale
VS	Vocational School
VSD	Vocational Skills Development
VT	Vocational Training
VTC	Vocational Training Centre
WBL	Work-Based Learning



Hyrje

Shqipëria udhëhiqet nga agjenda e integritit evropian. Në qershor të vitit 2014, vendit iu dha statusi i kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), hapi i parë drejt anëtarësimit të plotë në BE. Pavarësisht vështirësive me agjendën e papërfunduar të tranzicionit, qeveria shqiptare ka hartuar një vizion strategjik për të transformuar ekonominë e vendit nga një ekonomi me prodhimtari të ulët, informale dhe të varur nga import në një ekonomi moderne, novatore dhe shumë produktive. Me mbështetje ndërkombëtare dhe të frymëzuar nga Agjenda 'Evropa 2020' dhe EJK 2020, Shqipëria është drejt finalizimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim¹ (SKZHI), ndërkohë që tashmë ka hartuar 8 strategjitë sektoriale. Strategjitë e tjera do të përfundohen gjatë këtij viti.

Ekonomia shqiptare ia ka arritur të mbajë një rritje të kufizuar, por pozitive gjatë krizës globale financiare dhe ekonomike të kohëve të fundit. Gjendja e përgjithshme industriale dhe tregtare e vendit karakterizohet nga mungesa e aftësisë konkurruese të ekonomisë së saj. Ndër elementët kryesorë që pengojnë konkurrencën janë mungesa e fuqisë punëtore e specializuar dhe e aftë dhe ekonomia e madhe informale. Sipas Raportit Global të Konkurrueshmërisë 2015-2016, Shqipëria renditet në vendin e 93 nga 140 vendeve duke humbur 4 vende që nga periudha 2012-2013. Në efikasitetin e tregut të punës, vendi renditet në vendin e 97 (duke humbur 4 vende nga 2014-2015), ndërsa në lidhje me novacionin, Shqipëria zë

vendin e 118-të.² Për sa i përket zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomike, e matur nga Indeksi i Zhvillimit Njerëzor, vendi figuron në kategorinë e 'zhvillimit të lartë njerëzor', duke u renditur i 85-ti nga 187 vende dhe territore në vitin 2015, duke rënë me 15 vende në krahasim me vitin 2012³.

Tregu i punës në Shqipëri karakterizohet nga papunësia e lartë, veçanërisht mes popullatës në moshë të re, informaliteti dhe pjesëmarrja e ulët të grave dhe vajzave. Shkalla e papunësisë në Shqipëri (për grup-moshën 15-64 vjeç) është 17.9% (tremujori i katërt i vitit 2015) dhe, në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2013, kjo përqindje është rritur me 0.9 pikë përqindjeje.⁴ Papunësia e të rinjve (të moshës 15-29) mbetet një problem i madh, duke qenë se shkalla është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga 23.6% në tremujorin e parë të vitit 2012 në 34.1% në tremujorin e parë të vitit 2015. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç jo në punësim, arsim ose trajnimi llogaritet të përbëjnë 34.5% të të gjithë popullsisë në moshë të re në vitin 2014.⁵

Gratë në Shqipëri vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në punësim. Ato janë më pak të pranishme në pothuajse çdo sektor të punësimit të vendit⁶ dhe shumica e treguesve të tregut të punës janë krejtësisht të ulët për gratë. Indeksi i hendeku gjinor (0,701) e vë

1 Pritet të miratohet në pranverën e vitit 2016.

2 Raporti Global i Konkurrueshmërisë 2015-2016, Forumi Ekonomik Botëror

3 Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2015, PNUD

4 Vëzhgimi i Fuqisë Punëtore, Q1.2012-Q4.2015, INSTAT

5 INSTAT 2015

6 INSTAT (2014) http://www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf

Shqipërinë në vendin e 70 nga 145 vende gjithsej për vitin 2015.⁷ Përmirësimi me 38 vende në krahasim me vitin 2013 tregon një tendencë pozitive mbresëlënëse. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë kryesisht në drejtim të pjesëmarrjes në tregun e punës dhe fuqizimit ekonomik.

Punësimi informal është një shqetësim i madh për institucionet qeverisëse të tregut të punës në Shqipëri. Mbi një e katërta (25.6%) e atyre që marrin pjesë në fuqinë punëtore janë punëtorë kontribuues të familjes (femrat 1.7 herë më shumë se meshkujt) duke rritur numrin e madh të njerëzve që punojnë në mënyrë informale në ndërmarrjet mikro dhe të vogla.⁸

Të dhënat e vëzhgimit të fundit të fuqisë punëtore tregojnë se shkalla e punësimit (grupmosha 15-64 vjeç) është më e lartë për të punësuarit me arsim profesional të mesëm (64.8%), pasuar nga ata me arsim të lartë (62.2%). Kur krahasojmë të punësuarit me arsim të mesëm, shkalla e punësimit është shumë më e lartë për personat me arsim të mesëm profesional në krahasim me personat me arsim të mesëm të përgjithshëm, respektivisht 64.8% më shumë se 49%. Shkalla e papunësisë për personat me arsim të mesëm të përgjithshëm është 22.5% ose 4.8 pikë përqindje më e lartë se mesatarja kombëtare. Shkalla e papunësisë për personat me universitet është 20.8%, ndërsa për ata me arsim të mesëm profesional dhe ata me arsim 8/9 vjeçare, shkalla e papunësisë është 14.6%.

Me mbështetje ndërkombëtare dhe të frymëzuar nga Agjenda "2020 Evropa", Shqipëria ka hartuar një Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-

2020 për të siguruar mundësi më të mëdha për të rinjtë për të siguruar punë të mirë dhe të ardhura gjatë gjithë ciklit të jetës, duke kontribuar kështu në një rreth virtuoze të reduktimit të varfërisë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirjes sociale. Në nivel qendror, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) është përgjegjëse për sektorët e zhvillimit të aftësive profesionale dhe nxitjes së punësimit. Qëllimi i saj përfundimtar është të ndërtojë një sistem të fokusuar në zhvillimin e aftësive për tregun e punës me qëllim rritjen e perspektivave të punësimit dhe sipërmarrjes për të papunët në zonat rurale dhe urbane, ndërkohë që trajton në të njëjtën kohë nevojat e tyre për aftësim, si në sektorin formal ashtu edhe atë joformal. Rëndësia e bashkëpunimit me sektorin privat, në kuadër të një sipërmarrjeje të tillë po kuptohet dhe vlerësohet gjithnjë e më shumë. Dinamika e reformës së Zhvillimit të Aftësive Profesionale (ZHAP) përbën çastin më të mirë për ndërhyrje.

Zvicra ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në sektorin e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri gjatë një periudhë kohore prej pothuajse dy dekadash. Duke pasur parasysh vullnetin politik dhe mbështetjen institucionale për ta kthyer ZHAP në katalizator të rritjes së punësimit në Shqipëri, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në dialog me qeverinë e shqiptare hartoi në vitin 2015, Programin "Aftësitë për Punë" (S4J). Projekti ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e Shqipërisë në një ekonomi më konkurruese dhe për një shoqëri më gjithëpërfshirëse në aspektin social, duke përmirësuar dhe rritur ofertën ZHAP për gratë dhe burrat e papunët në Shqipëri, me fokus të veçantë tek të rinjtë, duke u mundësuar atyre të gjejnë një punë tërheqëse dhe të mirë. Projekti do të ndihmojë në zhvillimin e ofertave cilësore për formim profesional duke përfshirë përqasje të dyfishta dhe mënyra të reja të të mësuarit. Kjo do të lehtësojë zhvillimin e

7 Raporti Global i Barazisë Gjinore 2015, Forumi Ekonomik Botëror: <http://reports.weforum.org/global-gender-gap-report-2015/economies/#economy=ALB>

8 Vëzhgimi tremujor i fuqisë punëtore, tremujori i katërt 2015, INSTAT

ofruesve të formimit profesional në ofrimin e mjediseve të integritit në tregun e punës me rrjete të forta me punëdhënësit dhe organizatat e sektorit privat. Të rinjtë dhe të rejtat si dhe femrat së bashku me grupet me nevoja të veçanta do të përfitojnë nga tregu i ri i punës dhe oferta trajnime formale dhe jo-formale edhe për femrat.

Faza e parë e Projektit S4J zgjat nga muaji tetor 2015 deri në fund të muajit shkurt 2019 me financim nga SDC me një vlerë totale prej 6.3 milionë frangash zvicerane. Për zbatimin e projektit është kontraktuar Swisscontact. Faza fillestare ka nisur më 1 tetor 2015 dhe zgjati deri në mes të muajit prillit të vitit 2016. Kjo fazë shërbeu për të krijuar një bazë të fortë për: (1) Ngritjen e Njesisë së Zbatimit të Projektit, (2) zgjedhjen e sektorit ekonomik, (3) vendimin për zonat e fokusit gjeografik, (4) analizën e funksionimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional në mënyrë të veçantë në lidhje me mënyra të reja të të mësuarit gjithëpërfshirës, dhe (5) hartimin e Dokumentit të Projektit.

Swisscontact nënkontraktoi Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), organizatë kërkimore me qendër në Tiranë, për të ndërmarrë një analizë të plotë a) për të mbështetur me evidenca përzgjedhjen e sektorëve dhe fokusin gjeografik dhe b) të sistemit të funksionimit të arsimit dhe formimit profesional në mënyrë specifike në lidhje mënyrat e reja të të mësuarit gjithëpërfshirës. Hulumtimi u drejtua nga një Ekipi Bazë për Kërkim, mbështetur nga 10 ekspertë të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe 21 asistentë kërkimore. Ky raport paraqet në mënyrë të detajuar procesin që çoi në përzgjedhjen e sektorëve dhe të zonave gjeografike si dhe një analizë të plotë të sistemit të zhvillimit të arsimit dhe trajnimit profesional në Shqipëri, duke u përqendruar në katër sektorët e ekonomisë.

Metodologjia

Në hartimin, zbatimin dhe raportimin e analizës, ekipi bazë për kërkim punoi sipas vizionit të procesit të bazuar në evidenca të sakta dhe të besueshme. Përdorimi i evidencës për marrjen e vendimeve për veprimet është në themel të filozofisë së Projektit S4J. Vendimmarrja e bazuar në evidenca siguron që sektorët/rajonet/ndërhryjet e përzgjedhura të kenë më shumë gjasa të arrijë rezultatet e pritshme të projektit. Opsionet e bazuara në evidenca përfshijnë aktivitetet, ndërhryjet, dhe programet që janë të informuar nga evidencat më të mira, të përditësuara, të besueshme dhe që janë në dispozicion. Veprimet e bazuara në kërkime rezultojnë në përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit dhe akses të barabartë tek shërbimet dhe programet (Bowen dhe Zwi, 2005). Përveç identifikimit dhe priorizimit të veprimeve dhe programeve të reja, opsionet të bazuara në evidenca mund të përcaktojnë se cilat ndërhryje dhe programet aktuale duhet të ndryshohen dhe/ose të mbyllen. Projekti S4J do të funksionojë në bazë të këtij parimi.

Edhe pse nuk ka një përjasje të vetme për identifikimin e opsioneve të mbështetura në evidenca për veprimet “aftësi për punë”, ekipi bazë i kërkimit ndoqi këto udhëzime dhe hapa themelore:

1. Bën pyetje kërkimore që mund të marrin përgjigje për të drejtuar kërkimet në fusha
2. Kërkon për evidencat më të mira
3. Bën vlerësim kritik të të gjithë evidencave në dispozicion

4. Aplikon evidencat për pyetjet e paraqitura
5. Vlerëson procesin për identifikimin e opsioneve të mbështetura në evidenca

Qëllimi kryesor i kësaj analize është të ndihmojë projektin S4J të kuptojë plotësisht dhe qartësisht dhe të bëjë analiza se si funksionojnë sektorët ekonomikë në vend, nevojat përkatëse për aftësi dhe potencialin për punësim dhe sa tërheqëse janë për audiencën e synuar. Edhe pse hulumtimet e mëparshme kanë qenë të dokumentuara, qëllimi i këtij studimi mbetet ai i një hulumtimi eksplorues. Ndonëse hulumtimi eksplorues përkufizohet si hulumtim fillestar tek një ide hipotetike ose teorike, ai është ideal kur nevojitet të kuptohet më thellë një problem kërkimor. Më së shpeshti, hulumtimi eksplorues hedh bazat e para për hulumtimet e mëvonshme. Duke qenë se kërkimi ynë është bazë, ai do të shërbejë si bazë për hulumtimet e ardhshme për veprime në projekt. Si pjesë e analizave të hollësishme të kryera, të dhënat bazë u mblodhën edhe për ngritjen e një sistemi të mirë-mbështetur të Menaxhimi të Rezultatet të monitorimit (MRM).

Gjetjet e studimit bazë shërbejnë:

- Për të kuptuar siç duhet kontekstin në sektorët e përzgjedhur dhe për të evidentuar nevojat dhe mundësitë për sa i përket sektorëve dhe aktorëve që angazhohen për të kontribuar në qëllimin e përgjithshëm të përcaktuar të projektit;

- Për të kuptuar siç duhet sfidat e grupeve kryesore të synuara, të rinj dhe të reja, si dhe grupet me nevoja të veçanta, në sistemin e ofrimit të arsimit dhe formimit profesional dhe integrimin e tyre në tregun e punës;
- Për të identifikuar kufizimet që pengojnë ndryshimin dhe mirëfunksionimin e sistemit, përfshirë këtu analizën e thellë të marrëdhënieve, kapaciteteve dhe stimujve të aktorëve të përfshirë dhe “rregullat” dhe “funksionet” që mbështesin sistemin e ofrimit të arsimit dhe formimit profesional.

Për të realizuar këto objektiva, pyetjet kryesore që drejtuan kërkimin për studimin bazë ishin:

1. Cilët sektorë/qarqe/ofrues kanë potencialin për të realizuar ndryshimin dhe për të kthyer në histori suksesi në të cilin të investohet? Cili është niveli i gatishmërisë?
2. Sa mundësues është mjedisi aktual dhe si mund të përmirësohet ai për të rritur në maksimum hyrjen në tregun e punës të të rinjve me arsim dhe trajnim profesional (ATP) (formal dhe jo-formal)?
3. Cilat janë pengesat dhe mundësitë për të tërhequr të rinjtë drejt ATP (formal dhe jo-formal)?
4. Si mund t'u sigurohen mundësi të barabarta grupeve të marginalizuara (gratë, romët, egjiptianë, etj.)?

Për të trajtuar sa më mirë pyetjet kërkimore të analizës, ekipi aplikoi planin e metodës së përzier (Creswell, 2003)⁹. Për shqyrtim të

plotë të pyetjeve të kërkimit dhe për të rritur besueshmërinë e gjetjeve të mëvonshme, ne ndërthurëm edhe trekëndëzimin (triangulimin) e të dhënave, metodave dhe hulumtuesve duke siguruar kështu vlefshmërinë konvergjente të gjetjeve të synuara të mëposhtme:

- Identifikimin e sektorëve/qarqeve/ofruesve për ndërhyrje;
- Hartëzimin e plotë të kontekstit në sektorë specifikë; identifikimin e nevojave dhe mundësive për sa i përket sektorëve dhe aktorëve;
- Të kuptuarit plotësisht të sfidave me të cilat ndeshen të rinjtë dhe të rejtat si dhe grupet me nevoja të veçanta me sistemin e ofrimit të arsimit dhe trajnimit profesional dhe integrimin në tregun e punës; dhe
- Përcaktimi dhe të kuptuarit e kufizimeve në sistem që pengojnë ndryshimin dhe mirëfunksionimin e sistemeve, përfshirë këtu analizën e thellë të marrëdhënieve, kapaciteteve dhe stimujve të aktorëve të përfshirë dhe “rregullat” dhe “funksionet” që mbështesin sistemin e ofrimit të arsimit dhe formimit profesional.

Në këtë projektim kërkimi (Figura 1), trekëndëzimi shfaqet në të katër format (Denzin, 1970). Më poshtë po shtjellojmë secilin prej tyre.

1. Trekëndëzimi i të dhënave përfshin mbledhjen e të dhënave nëpërmjet disa strategjive të kampionimit, në mënyrë të bëhet e mundur mbledhja e copëzave të të dhënave në kohë të ndryshme dhe situata sociale si dhe për një larmi njerëzish.

Në këtë analizë, të dhënat gjenerohen

⁹ Në http://isites.harvard.edu/fs/docs/icb.topic1334586.files/2003_Creswell_A%20Framework%20for%20Design.pdf

Problemi/Pyetjet kërimore

1. Cilët sektorë/ qarqe/ofrues kanë potencialin për të realizuar ndryshimin dhe për të kthyer në histori suksesi në të cilin të investohet? Cili është niveli i gatishmërisë?

2. Sa mundësues është mjedisi aktual dhe si mund të përmirësohet ai për të rritur në maksimum hyrjen në tregun e punës të të rinjve me arsim dhe trajnim profesional (ATP) (formal dhe jo-formal)?

3. Cilat janë pengesat dhe mundësitë për të tërhequr të rinjtë drejt ATP (formal dhe jo-formal)?

4. Si mund t'u sigurohen mundësi të barabarta grupeve të marginalizuara (gratë, romët, egjiptianë, etj.)?

Komponentët e kërkimit

Kërkime dhe analizë të të dhënave dytësore

Sondazhe (komponenti sasior)

Studim i thelluar (komponenti cilësor; Intervista dhe diskutime në fokus grupe)

Gjetjet e kërkimit

1. Hartëzimi i plotë i kontekstit në sektorë specifikë; identifikimi i nevojave dhe mundësive për sa i përket sektorëve dhe aktorëve.

2. Identifikimi i sektorëve/ qarqeve/ofruesve për ndërhyrje

3. Të kuptuarit plotësisht të sfidave me të cilat ndeshen të rinjtë dhe të rejtat si dhe grupet me nevoja të veçanta me sistemin e ofrimit të arsimit dhe trajnimit profesional dhe integrimin në tregun e punës

4. Përcaktimi dhe të kuptuarit e kufizimeve në sistem që pengojnë ndryshimin dhe mirëfunksionimin e sistemeve, përfshirë këtu analizën e thellë të marrëdhënieve, kapaciteteve dhe stimujve të aktorëve të përfshirë dhe "rregullat" dhe "funksionet" që mbështesin sistemin e ofrimit të arsimit dhe formimit profesional

Diagrami 2. Trekëndëzimi i burimeve të të dhënave



burimet parësore nga një sërë njerëzish dhe nivelesh, që luhaten nga niveli mikro në atë makro. Siç jepet edhe në Figurën 2, në nivel makro, projekti kërkimor ka synuar përfituesit kryesorë të nismës, të rinjtë në ATP formal dhe jo-formal në Shqipëri. Në nivelin meso, të dhënat u mbledhën nga njerëz që përfaqësojnë institucionet kryesore, të cilat formësojnë/ndikojnë tek përfituesit, vendimmarrësit, pengesat dhe mundësit, d.m.th., shkollë/ofruesin dhe punëdhënësin. Së fundi, në nivel makro, pyetjet kërkimor u shtjelluan më tej nëpërmjet të dhënave të mbledhura prej përfaqësuesve të aktorëve kryesorë që formësojnë kuadrin ligjir dhe politikat, ku veprojnë dy kategoritë e tjera (në nivel makro dhe meso).

2. Trekëndëzimi i investiguesit i referohet përdorimit të një apo më shumë hulumtuesi në terren për të mbledhur dhe interpretuar të dhënat.

Ekipi i kërkimit kombinon ekspertizën nga këto katër fusha kryesore interesi: arsimi

dhe formimi profesional, integrimi i tregut të punës, pabarazia gjinore dhe sociale, dhe ekspertiza e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Po ashtu, ekspertët e lartë përkatës të sektorit dhe hulumtuesit në sektorët e zgjedhur të interesit kryen analiza sektoriale.

3. Trekëndëzimi teorik i referohet përdorimit të një apo më shumë pozicioneve teorike në interpretimin e të dhënave.

Të dhënat do të interpretohet nga disa paradigma të ndryshme që lindin nga shkencat ekonomike, shkencat sociale, arsimit, dhe shkollat TIK.

4. Trekëndëzimi metodologjik i referohet përdorimit të më shumë se një metode për mbledhjen e të dhënave.

Së fundi, por më e rëndësishme, në kërkim kombinohen një sërë metodash cilësore dhe sasore të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

▪ Sondazhi

Sondazhi u realizua gjatë muajit dhjetor 2015, duke përdorur metodën me dy faza me grupe të shtresëzuara. Për sondazhin e nxënësve, sektorët që aktualisht ofrohen në shkollat e arsimit profesional dhe qendrat e formimit profesional konsiderohen si shtresa. Plot 60% e shkollave që ofrojnë programe që lidhen ke atë sektor u zgjedhën në mënyrë rastësore brenda një shtrese duke përdorur probabilitetin proporcional sipas teknikave të kampionimit

të madhësisë. Në këtë teknikë, shkollat më të mëdha për sa i përket nxënësve të regjistruar kanë probabilitet më të madh për t'u përzgjedhur. Për të korrigjuar këtë, në fazën e dytë, i njëjti numër nxënësish u zgjedh në secilën shkollë të kampionit duke përdorur kampionimin e thjeshtë rastësor. Kampioni rezultoi në një madhësi prej 912 nxënësish dhe është përfaqësues në nivel profili/drejtimi. Kampionimi i thjeshtë rastësor u përdorë edhe për mësuesit e shkollave profesionale si dhe trajnerët dhe instruktorët e qendrave profesionale. Analiza

Tabela 1. Lista e informuesve kyç të intervistuar

Nr.	Emër mbiemër	Institucioni	Posti	Data e intervistës
1	Blendi Klosi	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Ministër	24.12.2015
2	Agron Pullumi	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Drejtor i Drejtorisë AFP	21.10.2015
3	Sonila Limaj	Agjencia Kombëtare Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	Drejtor	02.11.2015
4	Brikena Nallbani	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Zv. Drejtoreshë e Përgjithshme	21.10.2015
5	Ornela Koleka	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Drejtoreshë e Drejtorisë TIK	04.11.2015
6	Geron Kamberi	Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit	Drejtori i Përgjithshëm	13.11.2015
7	Silvana Mjeda	Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim	Oficere programi	05.11.2015
8	Sabine Hartig	Agjencia Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (GIZ)	Drejtor i Programit AFP	27.10.2015
9	Evelyn Viertel	Fondacioni Evropian i Trajnimit	Drejtor i Programit për Shqipërinë	24.11.2015
10	Maria Gomes	Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO)	Kryekëshilltar teknik	23.10.2015
11	Florenc Qosja	Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA)	Zv. Drejtor i Zyrës dhe Shef i Administratës	09.11.2015
12	Ana Zaharian	Swisscontact	Shefe e Administratës	26.10.2015
13	Dajna Sorensen	PNUD	Menaxhere e Projektit 'Aftësi për Punësim'	28.10.2015
14	Edlira Muhedini	Helvetas	Menaxhere e Projektit RISI Albania	29.09.2015
15	Evis Pogoni	Coca Cola, Shqipëri	Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore	10.11.2015
16	Anjeza Kelmendi	Balfin Group	Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore	12.12.2015

në këtë kapitull bazohet tek shifrat që lidhen me sistemin në të tërësi dhe të detajuar në katër sektorët e përzgjedhur.

▪ Intervistat e thelluara

▪ Diskutimet në fokus grupe

Me qëllim që të kuptojmë më mirë dhe më thellë perspektivën e grupeve të ndryshme të interesit për pyetjet se sa mundësues është mjedis, cilat pengesa hasen dhe si mund të trajtohen ato, u hartuan dhe u kryen intervista të thelluara dhe diskutime në fokus grupe me informuesit kyç (në fazën përgatitore të kërkimit) dhe me të rinjtë gjimnazistë dhe të rinj para dhe pas APF nga zonat urbane dhe rurale.

U kryen gjithsej 16 intervista me informues kyç që përfaqësonin politikëbërësit në MMSR dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), institucionet në varësi të tyre, si AKAFP dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP), donatorë të rëndësishëm dhe agjenci

ndërkombëtare për zbatimin e projekteve të arsimit dhe formimit profesional dhe punësimit si dhe përfaqësues të biznesit. Këto intervista u hartuan për të shqyrtuar situatën aktuale të zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional dhe punësimit të të rinjve, politikat, planet, nismat, sfidat, mësimet e nxjerra, me fokus të veçantë tek metodat novatore të bazuara në TIK dhe përfshirja e biznesit në ZHAP formal dhe jo-formal.

Intervistat e thelluara dhe diskutimet në fokus grupe me të rinjtë gjimnazistë dhe të rinj para dhe pas arsimit dhe formimit profesional u fokusuan kryesisht për evidentimit dhe të kuptuarit e:

- Arsyeve të zgjedhjes së arsimit profesional përkundër atij të përgjithshëm
- Sfidave dhe mundësive të hyrjes në tregun e punës mes të diplomuarve nga shkollat profesionale përkundër atyre të gjimnazeve.

Tabela 2. Lista e fokus grupeve dhe intervistave

Fokus grupet (shkolla e mesme publike)	Nr. i pjesëmarrësve	Meshkuj	Femra	Grupmosha
1 Maj	12	4	8	14-15
Katund i Ri	10	5	5	14-15
Farka	19	5	11	14
Gjithsej (3)	41	14	24	14-15
Intervista	Data	Meshkuj	Femra	Mosha
Shkollë AFP/e papunë	23.12.2015	-	Po	19
Shkollë AFP /i papunë	17.12.2015	Po	-	20
Shkollë AFP l/i punësuar	17.12.2015	Po	-	29
Shkollë AFP/i punësuar	17.12.2015	Po	-	22
E mesme e përgjithshme /e papunë	21.12.2015	-	Po	20
E mesme e përgjithshme/e punësuar	23.12.2015	-	Po	20
Gjithsej (6)	-	3	3	19-29

Struktura e Raportit

Ky raport ofron një përshkrim të procesit dhe rezultateve për përzgjedhjen e sektorëve të ekonomisë, gjeografisë ku do të ndërhyje Projekti “Aftësi për punë”, dhe ofruesit AFP që do të përfitojnë dhe të bashkëpunojnë me projektin. Raporti ofron edhe një analizë të kuadrit institucional dhe programet që ofrohen aktualisht në vend, duke u përqendruar kryesisht në evidencat e kohëve të fundit të përvetësuar nga të dhënat e mbledhura përmes një studimi përfaqësues në nivel sektori me nxënës të AFP, kursantët, mësuesit dhe instruktorët për të hedhur dritë mbi çështjet që lidhen me aksesin në AFP, cilësinë e dispozitave të AFP, përdorimi i metodave TIK të mësimdhënies në AFP, mundësia e punësimit, pritshmëritë për të ardhmen e të diplomuarve të AFP-së, dhe marrëdhënie me bizneset.

Ky raport organizohet si më poshtë.

Pjesa 1 përshkruan procesin që çoi në përzgjedhjen e sektorëve dhe qarqeve, ku do të fokusohet projekti si dhe ofruesit e AFP që do të përfitojnë kryesisht nga ndërhyrja.

Pjesa 2 jep një pamje të kuadrit institucional në bazë të të cilit funksionon AFP në Shqipëri, i ndjekur nga diskutimi mbi modalitetet e ofrimit të AFP, programeve, regjistrimit dhe rrjeteve të ofruesve në pjesën 3.

Pjesa 3. Evidencat e dhëna në këtë seksion bazohen tek të dhënat sekondare dhe intervistat me informatorët kyç.

Pjesa 4 përdor të dhënat nga sondazhi specifik të mbledhura në këtë projekt për të evidentuar pronlemtet që lidhen me aksesin në AFP. Kjo pjesë ofron profilin social-ekonomik të nxënësve AFP, përfshirë rezultatet shkollore të nxënësve AFP, lehtësinë e aksesit dhe mundësitë e barabarta.

Pjesa 5 jepet një përmbledhje e përgjithshme e cilësisë së AFP. Kjo pjesë përqendrohet në vlerësimin e programeve arsimore dhe të trajnimit, të tilla si raporti mes teorisë dhe praktikës, vlerësimi i metodave dhe materialeve mësimore, infrastruktura e të mësuarit, si dhe vlerësimi i përvojës dhe kualifikimi i stafit akademik sipas nxënësve/kursantëve.

Pjesa 6 ofront një pamje më e zgjeruar e mjeteve dhe metodave TIK që përdoren në sistemin AFP, të tilla si përdorimi i kompjuterëve, lehtësia e aksesit të tyre, përdorimi i internetit dhe teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në këtë pjesë përfshihet edhe një diskutim për sfidat e perceptuara, përfitimet dhe mundësitë që lidhen me zbatimin e kësaj teknike në sistemin aktual si dhe për të mësuarit e përzier (hipotetik).

Mundësitë për punësim dhe pritshmëritë e ardhshme të nxënësve dhe kursantëve analizohen në pjesën 7.

Pjesa 7. Në evidencë përfshihen lidhja dhe përshtatshmëria e informacionit për mundësitë për punësim, burimet kryesore

të informacionit, synimet dhe pritshmëritë e nxënësve për të ardhmen e afërt pas diplomimit, kohëzgjatja e tranzicionit, dhe punëdhënësit kryesorë të mundshëm. Po ashtu, në këtë pjesë diskutohen edhe të dhënat për faktorët e ndryshëm që duhet të trajtohen me qëllim përmirësimin e mundësive për punësim.

Pjesa 8 analizon marrëdhëniet e shkollave AFP dhe qendrave të formimit profesional me punëdhënësit, veçanërisht në lidhje me praktikën profesionale të nxënësve si dhe modalitetet e bashkëpunimit mes tyre.

Pjesa 9. Jep përfundimet e raportit.

Pjesa 1: Përzgjedhja e sektorëve, qarqeve, dhe ofruesve

Përzgjedhja e sektorëve

Detyrat e ekipit bazë të kërkimit ishte të ofronte rekomandime, në bazë të analizës, për aktorët kryesorë, që mund të ndihmojnë në marrjen e vendimit për përzgjedhjen e sektorëve a) që kanë nevojë për reformë profesionale me potencialin më të mirë për krijimin e më shumë vendeve më të mira të punës për të rinjtë dhe të rejtat, vende pune që të jenë të qëndrueshme; dhe, b) me potencialin më të mirë për të kontribuar në rritjen inteligjente të ekonomisë së vendit. Po ashtu, ekipi ofroi rekomandime për fokusin gjeografik dhe ofruesve AFP me potencialin e realizimit të ndryshimit nga ana e tyre

Analiza u fokusua në 9 sektorë të parazgjedhur nga ekipi i kërkimit sipas një

grupi treguesish (ekonomikë, tregut të punës, dhe socialë) dhe faktorësh (AFP, ndjeshmëria gjinore, teknologjia dhe novacioni, prioritetet e qeverisë, kërkimet e mëparshme përkatëse, ekonomia e gjelbër, dhe rritja inteligjente) me lidhje me qëllimin e përgjithshëm dhe objektivat specifike të projektit. Sektorët e përzgjedhur për analizë të mëtejshme janë si më poshtë:

Tabela 3. Sektorët ekonomikë të parazgjedhur

SEKTORI EKONOMIK	FOKUSI
Bujqësia	Prodhimi
Peshkimi dhe akuakultura	
Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	Gazi dhe energjia e rinovueshme
Turizmi	Mikpritja, agro-turizmi, trashëgimia kulturore
Tekstilet	Segmentet/procesi i zinxhirit me vlerë të lartë
Administrimi dhe trajtimi i mbetjeve	Trajtimi/riciklimi i mbetjeve
Ndërtimi	Ndërtesa të efikasitetit të energjisë/burimeve
Transporti	Transporti inteligjent dhe i gjelbër i mallrave dhe njerëzve
TIK	Zgjidhjet me sistemet e teknologjisë së informacionit (programet dhe pajisjet)
	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

Për qëllime të kësaj analize, ekipi i kërkimit iu referua klasifikimit statistikor të veprimtarive ekonomike në Shqipëri sipas NACE Rev 2

(21 kategori me një total prej 99 veprimtarish ekonomike). Çdo kategori dhe veprimtari ekonomike është "peshuar" veçmas.

Dhjetë hulumtues të vjetër/ekspertë¹⁰ me përvojë të madhe akademike/kërkimore në 9 sektorët e parazgjedhur ndihmuan ekipin bazë të kërkimit për të kryer analizat specifike të çdo sektori. Hulumtuesit kryen shqyrtimin e literaturës si dhe në total 90 intervista gjatë periudhës 15 nëntor-23 dhjetor 2015 me kompani/punëdhënës nga sektori publik dhe privat. Në bazë të shqyrtimit dhe gjetjeve nga intervistat, hulumtuesit përpiluan 9 raporte sektoriale që ofrojnë përgjigjet përkatëse për të katër pyetjet kërkimore, por në mënyrë të veçantë duke raportuar për potencialin e sektorëve ekonomikë për rritjen dhe krijimin dhe përmirësimin e vendeve të punës për të rinjtë dhe të rejat në qarqe të ndryshme të Shqipërisë. Po ashtu, ekipi bazë i kërkimit ndërmori rishikimin e literaturës dhe realizoi intervista të thelluara me informuesit kyç për të ndihmuar në procesin e përzgjedhjes së sektorëve.

Plot 15 tregues u përdorën për të kryer analiza krahasuese mes sektorëve të përzgjedhur përfundimisht sipas informacionit dhe përfundimeve të përpiluara nga hulumtuesit/ekspertët e sektorëve përkatës:

1. Kontributi në prodhimin e brendshëm bruto (PBB)
2. Kontributi në rritjen e vërtetë të PBB-së
3. Rritja e vërtetë e PBB-së sipas

sektorit të ekonomisë

4. Punësimi në tërësi
5. Punësimi i të rinjve
6. Punësimi i grave
7. Punësimi i grupeve të marginalizuara
8. Potenciali për të krijuar vende të reja pune – kryesisht për të rinjtë
9. Vende të denja pune në sektor
10. Prania e punëve të cënueshme/informale/të papaguara
11. Nevoja për përmirësimin e aftësive
12. Potenciali për novacion në prodhim/përpunim/ofrim shërbimi
13. Potenciali i sektorit për të zhvilluar dhe përdorur zgjidhje inteligjente
14. Sektorët e ekonomisë së gjelbër
15. Prioriteti i qeverisë

Për të krahasuar sektorët u përdor sistemi i pikëzimit nga 0 deri në 5 (në një rast me vlera negative) me përjashtim të treguesit 15 (prioriteti i qeverisë), rast në të cilin sektorëve me prioritet të qeverisë (siç janë përcaktuar në Programin e qeverisë të miratuar nga Parlamenti) iu dhanë të gjithëve nga një pikë aty ku duhej. Treguesve të ndryshëm iu dha rëndësi e ndryshme (që varionte nga 0.6 në 1.6) sipas lidhjes së tyre me projektin.

Nga analiza krahasuese, sektorët e mëposhtëm u renditën më të mirë dhe u përzgjedhën, në konsultim me MMSR dhe SDC:

- Turizmi dhe mikpritja (me fokus tek mikpritja, agroturizmi, trashëgimia kulturore)

¹⁰ Hulumtuesit e vjetër të angazhuar në këtë ushtrim janë: Prof. Ass. Ermira Shehi (PhD) për tekstilet; Selami Xhepa (PhD) për Energjinë; Gavrosh Zela (PhD(c)) për administrimin dhe riciklimin e mbetjeve dhe furnizimin me ujë; Prof. Ilia Kristo (PhD) për Hoteleri-Turizmin; Mimoza Agolli (PhD(c)) për Transportin; Rigers Bakiu (PhD) për Akuakulturën; Blendi Gërdoçi (PhD) për bujqësinë; Prof. Mimoza Kasimati (PhD) për ndërtimin; Ana Ktona (PhD) e Alban Karapici për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimi.

- Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (me fokus në zgjidhjen e sistemit të teknologjisë së informacionit (programet dhe pajisjet) dhe mbledhja e përpunimi i të dhënave)
- Tekstilet (me fokus tek segmentet/ procesi i zinxhirit me vlerë të lartë)
- Ndërtimi (me fokus tek ndërtesat me efikasitet të energjisë/burimeve)

Ekipi i projektit vendosi ta konsideronte TIK-un si temë ndërsektoriale, me qëllim hartimin e ndërhyrjeve të Projektit dhe jo si sektor për t'u përqendruar vetëm në të. TIK do të ndikojë në çdo profesion që nga kamerieri kur merr porosinë e pijeve, tek tekniku i instalimit të sensorëve në një ndërtesë me efikasitet energjie e deri tek operatori i procesit të tekstileve që punohen me programet CAD/CAM. Për këtë arsye, është e nevojshme që ekipi i projektit të shohë se si zhvillohet ky potencial në të ardhmen e afërt, pasi qëllimi është përparojë perspektivën ekonomike të Shqipërisë. Kjo kërkon që ato të përkthehen në programe të ndryshme shkollore: nga dërrasë e zezë, ku nxënësit marrin informacion në lidhje me detyrat e shtëpisë tek fillimi i prezantimit të të mësuarit jashtë shkollës.

Përzgjedhja e qarqeve

Me MMSR dhe SDC u krye një proces konsultimi për të përcaktuar përqasjen më të mirë për përcaktimin e qarqeve që do të mbulohen nga ky projekt. U ra dakord që projekti të ndërhynte në nivel qarku dhe në ato territore ku ka nevojë urgjente për reformë në nivelin profesional përveç potencialit për më shumë vende pune dhe më të mira për djemtë dhe vajzat e reja. Duke u mbështetur në parimet e bashkërendimit të veprimtarive të donatorëve, disa qarqe u përjashtuan nga përzgjedhja për të siguruar që nuk kemi mbivendosje dhe duplikim me donatorët e

tjerë që veprojnë në mbështetje të sistemit AFP. Ekipi bazë i kërkimit analizoi 5 qarqet e përzgjedhura përfundimisht për sa i përket potencialit për sektorët e përzgjedhur të ekonomisë në lidhje me krijimin e vendeve të punës për të rinjtë. Si rezultat, dhe në konsultim me MMSR dhe SDC, qarqet e Vlorës dhe Lezhës u përzgjedhën si zona të fokusit parësor dhe qarku i Beratit si zonë për veprimtari të përzgjedhura që përqendrohen në vlerësimin e mundësisë për të shërbyer si model zbatimi në zona të tjera.

Zgjedhja e ofruesve

Për fazën e parë të projektit (deri në fund të shkurt 2019), projekti ndjek një përqasje qarku. Projekti do të mbulojë ofruesit publikë dhe privatë të AFP si dhe sektorit privat në qark. Në qarkun e Vlorës, aktivitetet e projektit do të përqendrohen në një zonë tepër të ngushtë të përcaktuar të Vlorës, pasi donatorë të tjerë (d.m.th., Agjencia Austriake për Zhvillim - ADA) do të mbështesë ofruesit e AFP në Bashkinë e Sarandës. Qarku i Beratit do të përfitojë nga vlerësimet zbatimit të modelit dhe do të përfshihet në aktivitete të zgjedhura të projektit, d.m.th., mbështetje për drejtuesit e shkollës dhe veprimtaritë për trajnimin e trajnerëve (ToT) aktivitete.

Shkollat publike dhe qendrat e formimit profesional si më poshtë janë aktorët kryesorë dhe partnerët e bashkëpunimit të Projektit S4J në këto qarqe:

1. Lezhë: Shkolla e Mesme "Kolin Gjoka"
2. Vlorë: Shkolla e Mesme Industriale "Pavarësia"
3. Vlorë: Shkolla e Mesme Tregtare
4. Vlorë: Qendra e Formimit Profesional
5. Berat: Shkolla e Mesme "Kristo Isak"

Përqasja e qarqeve kuptohet si fazë pilot ku modelet dhe rezultatet e tjera të rëndësishme të zhvilluara në nivel vendor/ qarku sipas kushteve të projektit do të jenë gati për t'u përhapur dhe marra përmasa në nivel kombëtar në një fazë të dytë të mundshme. Projekti do të krijojë terrenin për ta bërë këtë realitet, duke zbatuar një perspektivë sistemi dhe duke punuar me aktorët e sistemit, ata me qendër në Shqipëri, me projektet përkatëse dhe donatorë që nga fillimi e më vonë (shih kreun përkatës). Prandaj, disa aktivitete do të realizohen në nivel kombëtar (p.sh., institucionalizimi i trajnimit të trajnerëve, zhvillimi i kapaciteteve në mbështetje të drejtuesve të shkollave, rishikimi apo zhvillimi i programit mësimor, apo zgjidhje specifike TIK që do të projektohen për zbatim në nivel kombëtar) me qëllim përgatitjen e terrenit për efektet që lidhen me sistemin, por edhe sepse në sistemin e centralizuar të zhvillimit të AFP në Shqipëri niveli kombëta ka mjaft rëndësi në shumë dimensione.

Pjesa 2. Politikat AFP në Shqipëri dhe Kuadri Institucional

AFP është aktualisht prioritet kombëtar.¹¹ Reformimi i sistemit nisi në vitin 2012 me qëllimin përfundimtar të bashkërendimit të politikave për punësimin, arsimin profesional dhe formimin profesional. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014-2020 është dokumenti strategjik që

harmonizon këto politika dhe që nga viti 2013 Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe institucionet në varësi të saj ngarkohen për të zbatuar atë. Përparësitë strategjike të SKPA 2014-2020 janë si më poshtë:

A. Nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës

B. Ofrimi i arsimit dhe kualifikimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit

C. Nxitja e përfshirjes sociale dhe e kohezionit territorial

D. Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve

Aktualisht, sistemi AFP në Shqipëri nuk po punon mirë për sa i përket qëllimit përfundimtar të punësimit të të diplomuarve. Në vend, vetëm 30% e nxënësve të arsimit profesional gjejnë punë pas diplomimit (GIZ / ETF, 2014), dhe 3.5% e kursantëve punësohen pas trajnimit (SHKP, 2015), në mënyrë të konsiderueshme më e ulët krahasuar me vendet e BE27+, ku punësohen 63.4% e të diplomuarve të AFP (CEDEFOP, 2012). Përditësimi i sistemit AFP po trajton rinovimin e infrastrukturës së ofruesve, trajnimin e mësuesve/ instruktorëve, rritjen e regjistrimit (në veçanti të grupeve të marginalizuara, për shembull, rome dhe egjiptiane, etj.), rritjen e përqindjes së të diplomuarve të AFP-së, nxitjen e bashkëpunimit me sektorin privat në institucionalizimin e mësimin në vendin e punës, rishikimin dhe orientimin e kurrikulës drejt tregut të punës dhe rritjen e autonomisë së ofruesve të AFP.

Plani afatmesëm i MMSR, siç tregohet nga zyrtarë të lartë të Ministrisë, është të racionalizojë rrjetin e ofruesve AFP në 13 ofrues të quajtur "shkolla të ekselencës",

¹¹ Programi i qeverisë shqiptare 2013-2017, f. 33, http://www.akti.gov.al/dokumenta/programi_qeverise_2013_2017.pdf

institucione me status më të lartë autonomie, që ofrojnë larmi më të madhe programesh AFP si dhe kurse afatshkurtra. Mbështetja e donatorëve konsiderohet tejet e rëndësishme në këtë përjasje duke ofruar asistencë financiare dhe teknike në nivel ofruesi. Reforma synon të integrojë ofrimin e arsimit profesional dhe formimin profesional në rrjetin e racionalizuar të ofruesve AFP duke synuar përdorimin efikas të burimeve dhe efektivitetin për sa i përket shërbimit AFP në tregun kombëtar dhe rajonal të punës dhe për nevojat sociale.

U hartua një ligji ri për AFP¹² për të parashikuar vizionin e sistemit të plotë AFP duke qenë se ligji aktual i AFP¹³ nuk kishte kapur të gjithë dinamikën e zhvillimit të AFP në Shqipëri në vitet e fundit dhe orientimet politike dhe instrumentet e BE-së. Elementë të caktuar të arsimit profesional dhe formimit profesional rregullohen aktualisht nëpërmjet ligjeve të ndryshme, të cilat kanë krijuar mbivendosje ose përplasje kompetencash në disa aspekte dhe "hapësira boshe" në disa të tjera. Ky projekt ligji është ende në diskutim në MMSR dhe duhet të merren ende vendime për sa i përket çështjeve të rëndësishme, veçanërisht për administrimin e sistemit të AFP dhe strukturave të arsimit profesional.

Administrimi i sistemit AFP

MMSR është institucioni më i lartë përgjegjës për AFP në vend. Në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të AFP, Punësimit dhe Migracionit është Drejtoria e

AFP. Në parim, MMSR harton politikat AFP dhe vepron në nivel strategjik, por që nga viti 2014, kjo ministri është përgjegjëse edhe për administrimin e shkollave profesionale. Kalimi i përgjegjësisë tek MMSR nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), që kishte përgjegjësi të plotës për shkollat e arsimit profesional deri në vitin 2013, po vazhdon ende dhe rezultatet nuk janë edhe aq të prekshme sa ç'pritej, për shkak të kompleksitetit të integritetit të të gjitha përgjegjësisë tek MMSR, performancës së ulët të mëparshme dhe të tejzgjatur të AFP, mungesës së kapaciteteve institucionale, burimeve të kufizuara, dhe largimit nga puna të stafit të AFP në të gjithë sistemin. Këshilli Kombëtar i Punës dhe Këshilli Kombëtar i AFP janë organe trepalëshe që i japin MMSR rekomandime politikash për AFP dhe punësimin. Gjithsesi, roli i tyre duket se është formal, nëse i referohemi kontributit të mëparshëm të tyre, që më shumë ka munguar prej tyre.

MAS ndan përgjegjësitë me MMSR për arsimin profesional, duke qenë përgjegjëse për arsimin e përgjithshëm si pjesë e arsimit profesional, për sa i përket kurrikulës për lëndët e përgjithshme, standardet profesionale të mësuesve. MAS administron edhe Maturën Shtetërore.

Agjencia Kombëtare për Arsimin Profesional, Trajnimin dhe Kualifikimin (AKAFP) është një tjetër institucion në varësi të MMSR (dikur pjesë e MAS) përgjegjës për zhvillimin e kualifikimeve dhe profesioneve (listën, standardet dhe përshkrimin) në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit; kurrikulën e AFP si dhe sigurimin e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional. Përgjegjësia e trajnimit të mësuesve/instruktorëve i është caktuar kohët e fundit kësaj agjencie, edhe pse kuadri ligjor përkatës për këtë funksion mungon.

Për të mbështetur veprimtarinë e AKAFP-

¹² Ligji për AFP është hartuar me asistencë të Fondacionit Evropian të Trajnimeve GIZ, ILO dhe përfaqësuesve të aktorëve të tjerë të interesuar.

¹³ Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin Nr. 10011 datë 30.10.2008, Ligjin Nr. 10434, datë 23.06.2011, dhe Ligjin Nr. 63/2014, datë 26.06.2014

së dhe për të siguruar një pjesëmarrje më të madhe të sektorit privat, me nismën e projektit Risi Albania të financuar nga SDC, pritet të krijohen komitetet e aftësive sektoriale në çdo sektor, me pjesëmarrje të gjerë të punëdhënësve dhe sektorit privat, duke synuar të ofrojnë një pamje realiste të nevojave për aftësi në çdo sektor, profilet profesionale dhe kualifikimeve të nevojshme për të mbushur këto boshllëqe.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) është institucion në varësi të MMSR-së përgjegjës për zbatimin e politikave të punësimit, mbledhjen e informacionit për nevojat e tregut të punës dhe koordinimin e zyrave rajonale të punës. Në lidhje me AFP, ky shërbim është përgjegjës për administrimin e qendrave të formimit profesional (QFP) dhe miratimin e licencave për ofruesit privatë të formimit profesional. Zyrat e punësimit janë në varësi të SHKP dhe janë ngritur në çdo qark ku japin informacione për vende të lira pune në tregun e punës, punësimin e menjëhershëm dhe ofrimin e orientimit për karrierë dhe profesione kryesisht për punëkërkuuesit.

Ofruesit zyrtarë të AFP në Shqipëri janë shkollat profesionale (SHP), të cilat ofrojnë programe të arsimit profesional, dhe qendrat e formimit profesional që ofrojnë formim profesional nëpërmjet kurseve afatshkurtra (3 muaj deri në një vit).

Aktorët ndërkombëtarë kanë luajtur një rol thelbësor në të gjitha dimensionet e zhvillimit të sistemit AFP, duke filluar që nga rekomandimet për politikën dhe kontributin në orientimin strategjik tek ndërhyrjet në nivel ofruesi të AFP. Mbështetja e tyre financiare ka qenë e pazëvendësueshme për sistemin e keqfinancuar të arsimit dhe formimit profesional në vend. Aktorët ndërkombëtarë vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm duke prezantuar modele të suksesshme të AFP, të cilat i përshtatin për

kontekstin shqiptar. Prezantimi i sistemit të dyfishtë të vendeve gjermanisht-folëse në sistemin AFP të Shqipërisë është në rendin e ditës të qeverisë shqiptare.¹⁴ Gjithsesi, kjo përjasje konsiderohet tepër optimiste për realitetin shqiptar ku sektori privat heziton drejt AFP dhe dominohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Në kuadrin e 'Skemës së Praktikës për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri' AKAFP po zbaton një projekt të financuar nga ERASMUS+. Në kuadër të këtij sektori, po prezantohet për sektorin e turizmit një udhërrëfyes për modelin shqiptar të të mësimnxënies në vendin e punës me elementë të sistemit të dyfishtë. Në Shtojcën 2 jepen hollësi të mëtejshme për donatorët e AFP-së dhe agjencitë zbatuese të tyre.

Pjesa 3. Modalitetet e Ofrimit të AFP-së

Aktualisht, formimi profesional në Shqipëri mund të sigurohet duke ndjekur programet e arsimit profesional apo kurset e formimit profesional ose duke aplikuar për njohjen e mësimnxënies së përfutur jashtë vendit.¹⁵ Njohja e përfuturit informal dhe jo-formal të njohurive të mëparshme nuk është zhvilluar ende.¹⁶

Në Shqipëri ka 52 ofrues publikë të AFP, nga të cilët 42 ofrojnë programe të arsimit

14 Programi i qeverisë shqiptare 2013-2017, f. 33

15 AKAFP aktualisht është përgjegjës për njohjen e mësimnxënies së përfutur jashtë vendit, edhe pse procedurat për këtë gjë nuk janë zyrtarizuar ende.

16 Edhe pse nuk është pilotuar ende në sektorin e tekstileve me asistencë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nëpërmjet projektit të financuar nga IPA 2010 për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore në Shqipëri.

profesional dhe 10 qendra trajnimi ofrojnë kurse afatshkurtra të formimit profesional, të përhapura në pothuajse të gjitha qarqet, me një përqendrim më të lartë në Shqipërinë qendrore. Edhe pse ka nevojë dhe mundësi që shkollat e arsimit profesional të ofrojnë kurse afatshkurtra, për momentin vetëm Qendra Shumë-Funksionale e Kamzës po ofron kurse të tilla në sajë të statusit të saj të veçantë ligjor si qendër pilote shumë-funksionale. Në vizionin e MMSR-së, siç shprehet edhe në ligjin e ri për arsimin dhe formimin profesional, parashikohet që të gjitha shkollat profesionale të kenë mundësinë të ofrojnë kurse afatshkurtra. Nëntë qendra publike të formimit profesional ndodhen në qytetet kryesore (si Shkodra, Tirana (2), Durrësi, Elbasan, Fieri, Vlora, Korça, Gjirokastrë), dhe një qendër e lëvizshme është angazhuar për verilindjen e Shqipërisë.

Sipas statistikave të MMSR-së, në vitin shkollor 2014-2015, plot 17,339 nxënës u regjistruan në arsimin profesional me kohë të plotë. Ka gjithsej 44 drejtime profesionale, të ndara në gjithsej 110 profile të ofruara në sistemin publik (Nano, 2015). Në 17 shkolla profesionale ofrohen gjithsej 13 drejtime profesionale me kohë të pjesshme për 3,654 nxënës (në vitin shkollor 2014-2015). Objektivi kryesor për këtë modalitet janë të rriturit që punojnë dhe janë të interesuar për të marrë një kualifikim profesional. Lëndët teorike merren në institucionin arsimor, ndërkohë që praktika zhvillohet kryesisht në vendin e punës së nxënësit. Që nga viti 2014, regjistrimi në vitin e parë në programet e arsimit profesional me kohë të pjesshme është përkohësisht i pezulluar duke pasur parasysh zbatimin e dobët dhe nevojën për të hartuar një sistem të duhur për këtë modalitet, një gjetje që mbështetet edhe në studimet e mëparshme (GIZ / ETF, 2014).

Në lidhje me trajnimin profesional, janë certifikuar plot 13,102 kursantë pas përfundimit me sukses të kurseve

afatshkurtra të formimit në qendrat publike gjatë vitit 2014, 47% më shumë krahasuar me vitin 2013. Vitin e kaluar, këto qendra e zhvendosën fokusin tek kurset afatshkurtra që u ofrohen të papunëve (62% të certifikuar), të cilëve këto kurse trajnimi u ofrohen falas. Kategori të tjera të marginalizuara përfitojnë nga kurset e trajnimit falas, të tillë si romët, egjiptianët, jetimët, gratë e trafikuar, individët me aftësi të kufizuara, ish të burgosur, emigrantët e kthyer), por numri është i kufizuar (170 në total ose 1.3% e kursantëve në 2014) (SHKP, 2015).

Edhe pse qendrat e formimit profesional janë të njëjta për sa i përket ofertës së tyre dhe ndryshojnë për nga numri i kursantëve, ka një larmi të madhe mes shkollave të arsimit profesional në lidhje me numrin e nxënësve të regjistruar dhe drejtimeve profesionale që ofrojnë. Janë të ashtuquajtura (i) shkolla industriale, që ofrojnë profile teknike, si elektroteknikë, mekanikë, riparim makinash, termohidraulikë, TIK; (ii) shkolla të industrisë së lehtë, që ofrojnë degët tekstil-veshje, turizëm, industri ushqimore, ekonomi dhe biznes; (iii) shkolla bujqësore, që ofrojnë bujqësi dhe profile të tjera të lidhura me të, si agro-ushqimi, agrobiznes, veterinar, etj. Qendra Shumë-Funksionale e Kamzës është e vetmja që ofron nëntë drejtime të ndryshme profesionale dhe kurse afatshkurtra. Vetëm dy shkolla të arsimit profesional ofrojnë vetëm një profil, TIK. Në dy shkolla të tjera ofrohen gjuhët e huaja si profil i veçantë. Shkollat publike kanë larmi edhe për sa i përket performancës, ku më të mëdhatë ndihmohen nga donatorët, duke qenë kështu në avantazh (GIZ/ETF, 2014). Që nga viti 2014, MMSR po kryen një racionalizim të rrjetit të AFP që konsiston në transferimin e ofertës në shkolla profesionale që punojnë më mirë/me performancë më të lartë, duke mbyllur kështu disa profile ose institucione që nuk punojnë mirë.¹⁷


17 Ky proces filloi në Qarkun e Shkodrës në 2014-2015.

Oferta AFP në sektorët e zgjedhur

Analiza e sektori ekonomik zbuloi se në total ka 12 drejtime profesionale, 29 profile dhe


20 kurse afatshkurtra që përgatisin punonjës të kualifikuar për profilet profesionale në sektorë të TIK, ndërtim, turizëm, dhe tekstile. Siç mund të vërehet, sektorët ekonomikë

Figura 1: Programet AFP dhe regjistrimet që i shërbejnë sektorëve të përzgjedhur ekonomikë



Burimi: Statistikat e MMSR për vitin 2015

Figura 2: Regjistrimi në programet me kohë të plotë të arsimit profesional



Burimi: Statistikat e MMSR për vitin 2015

Shkolla 'Zija Buliqi', duke ofruar profilin veterinar në Shkodër, u transferua në Shkollën Bujqësore 'Ndre Mjeda' në Bushat, me afat të mesëm të bashkimit të ofertës duke u bërë kështu një ofrues. Profilet e lidhura me ndërtimin të Shkollës 'Kol Idromeno' u transferuan tek Shkolla 'Arben Broci'. Në vitin shkollor 2015-2016, 7 ofrues, që vepronin si shkolla të bashkuara (i njëjti institucion ofron arsimim të përgjithshëm dhe programe të arsimit profesional) nuk regjistruan nxënës në vitin e parë në programet e arsimit profesional, duke çuar në ndërprerjen graduale të këtyre programeve.

ndryshojnë për nga numri i përkatës drejtimeve të arsimit profesional, profilet dhe kurse trajnimi të ofruara nga sistemi formal i AFP-së publike. Përfaqësimi i femrave në arsimin profesional është përgjithësisht i ulët.

Oferta e shkollave profesionale për sektorin e turizmit është e kufizuar për vetëm një drejtim profesional, hotelieri-turizëm, me numër të lartë regjistrimi të nxënësve. Kjo ofertë është në 10 shkolla në Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Berat dhe Korçë me 2,660 nxënës të regjistruar. Për këtë sektor ofrohen gjashtë kurse të ndryshme trajnimi profesional: Banakier, kamerier, kuzhinier, operator turistik, pastičier, dhe sportelist për një total prej 2343 kursantësh. Gatimi është kursi më i kërkuar i trajnimit dhe ofrohet pothuajse në të gjitha qendrat e formimit profesional.


Për sektorin e tekstilit, drejtimi tekstilveshje përfaqëson zhvillimin e aftësive profesionale për teknikët e nivelit të mesëm, të ofruar si kurrikulë pilote dhe kombëtare në pesë shkolla në Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë dhe Elbasan, ku në total u regjistruan 441 nxënës. Numri i kursantëve në kurset sektoriale është 1,254 vetë, më i madh se numri i nxënësve. Qepja është kursi më i kërkuar i ofruar pothuajse në të gjitha qendrat e formimit profesional.

Në Shkodër, në qendrën e lëvizshme të formimit profesional ofrohet kursi i qepjes së mekanizuar të këpucëve.

Sektori i ndërtimit akomodon një numër më të lartë të drejtimeve të arsimit profesional, të tilla si ndërtim, gjeodezia, termo-hidraulika, instalimet termo-hidraulike (pilot), dhe elektroteknika, të ofruara aktualisht në 20 ofrues në të gjithë Shqipërinë për 1,913 nxënës. Për këtë sektor ka një ofertë të gjerë të kurseve të afatshkurtra trajnimi. Plot 2,444 kursantë janë trajnuar gjatë vitit 2015 në kurse afatshkurtra të ndërtimit, si hidraulik, instalim panelesh diellore dhe elektrike, të cilat janë edhe më të preferuarat.

TIK, si sektor i veçantë dhe gjithëpërfshkues, përfshin të diplomuarit në degët e TIK dhe elektronikë, të ofruar në 18 ofrues në çdo qark të vendit ku më parë jepej arsimi profesional zyrtar. Sipas statistikave të MMSR për vitin 2015, 2,509 nxënës janë regjistruar në këto degë dhe tendenca është në rritje, veçanërisht në TIK, që nuk është degë tradicionale profesionale, por u hap

Figura 3: Rrjeti i ofruesve



masivisht para gjashtë viteve shkollore, më së shumti në shkollat e arsimit profesional ku ofrohen elektroteknikë në përputhje me prioritetin që i është dhënë TIK-ut nga qeveria shqiptare.

Po të krahasojmë numrin aktual dhe atë të pritshëm të ofruesve të arsimit profesional që shërbejnë në çdo sektor të ekonomisë pas racionalizimit, mund të vihet re se ndërtimi dhe TIK kanë një ofertë më të kufizuar për sa i përket ofruesve dhe shpërndarjes gjeografike. Ofruesit ku oferta e arsimit profesional po transferohet apo mbyllet ndodhen në zona gjysmë rurale dhe në qytete të vogla. Si rezultat, sektori i bujqësisë do ta "vuajë" më shumë. Profilet e tekstit

përballen me problemin e mbipopullimit. Numri i nxënësve për klasë është rritur dhe numri i mësuesve, klasave, pajisjeve dhe i bazës prodhuese nuk është i mjaftueshëm. Statistikat e fundit mbi shkollat profesionale private në 2014-2015 tregojnë se ka 9 shkolla të arsimit profesional me 1,369 nxënës të regjistruar. Në përgjithësi, informacioni mbi ofruesit privatë është i kufizuar. Shkollat "Harry Fultz", "Shën Jozefi Punëtor", "Peter Maringer", "Frymë Dashurie", "Don Bosco" dhe "Ekonomisti" janë shkollat jo-publike të arsimit profesional me numrin më të madh të nxënësve (Nano, 2015).

Megjithatë, këto nivele regjistrimit janë ende larg nga mesatarja e regjistrimit në arsimin profesional në vendet e Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (OECD, me një mesatare prej 34%) (OECD, 2013).¹⁸ Në kërkimin tonë, përdorim të dhëna sasiore dhe cilësore parësore të mbledhura dhe analizuara me qëllim që të kuptojmë çështjet e thithjes, aksesit dhe mundësive të barabarta, të cilat mund të shpjegojnë ose të na ndihmojnë të kuptojmë pse panorama aktuale e AFP në vend nuk është ende shumë optimiste. Në gjetjet tona jepet një kombinim i faktorëve që kontribuojnë (shpesh) në paragjykimet dhe qëndrimet negative ndaj AFP-së, duke filluar nga faktet dhe shifra dekurajuese, paragjykimet dhe stereotipet në AFP që (ndonjëherë) i bëjnë publicitet të kundërt ofertës së AFP-së.

Ekziston një stereotip i fortë tek grupet moshore dhe gjinore, qarqet dhe sektorët se AFP është alternativë e "dorës së dytë" për arsimim. Si rezultat, AFP rrallëherë përbën zgjedhjen e parë, nëse nxënësi nuk është shumë i dobët në mësim dhe nuk mund t'ia dalë dot në arsimin e përgjithshëm ose

Pjesa 4. Aksesit në AFP

4.1 Perceptimet për AFP si alternativë për zhvillimin e aftësive në Shqipëri

Rritja e numri të nxënësve në arsimin profesional ka qenë një nga objektivat e strategjive të AFP. Në strategjinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (2014-2020), objektivi (nën prioritetin B) është rritja me deri në 25% e regjistrimit të djemve dhe vajzave në AFP. Të dhënat e fundit tregojnë se numri i të regjistruarve në AFP është rritur këto vitet e fundit. Të dhënat zyrtare për vitin shkollor 2014-2015 tregojnë se plot 22,801 nxënës kanë ndjekur arsimin profesional në shkolla publike dhe jo-publike të arsimit profesional, afërsisht 16.3% e numrit total të nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm (MMSR, 2015).

Pavarësisht të dhënave premtuese mbi regjistrimin, shumë shkolla profesionale po

18 Për më shumë hollësi shih: [http://www.oecd.org/education/skills-beyond-school/EDIF%202013--N17%20\(eng\).pdf](http://www.oecd.org/education/skills-beyond-school/EDIF%202013--N17%20(eng).pdf)

nuk ka mundësi të synojë për rrugën tjetër (më të mirë) të zhvillimit të aftësive, d.m.th., arsimin universitar.

Sipas të dhënave cilësore, reputacioni i dobët i AFP raportohet të përforcohet (jo) qëllimisht nga aktorë të ndryshëm. Mënyra se si reklamohet AFP nga programet qeveritare dhe strukturat, shkollat e mesme, etj., përforcon stereotipe të caktuara tek të rinjtë dhe familjet e tyre se AFP është për nxënësit “e dobët” dhe “problematikë”. Përkundrazi, nëse e doni shkollën, regjistrimi në AFP konsiderohet “i çuditshëm” ose opSION “pa lidhje” në një kontekst ku diploma universitare, si bachelor dhe master, kanë fryrë nivelin e konkurrencës në tregun shqiptar të punës.

Stereotipet dhe përforcimi i tyre nga mekanizma të ndryshëm shpesh ushqehen si rezultat i fakteve dhe shifra dekurajuese në lidhje me AFP-në. Në terma krahasuese në shkollat e mesme të përgjithshme në vend, shkollat e arsimit profesional karakterizohen nga dominimi i nxënësve me rezultate mësimore nën mesataren akademike. Po kështu, kurrikulat dhe stafi renditen si shumë herë më të mirë në shkollat e mesme të përgjithshme në krahasim me ato të shkollave të arsimit profesional që, nga ana tjetër, konsiderohen të ngushtë dhe të varfër edhe nga pjesëmarrësit në komponentit cilësor të këtij studimi. Gjithashtu, sa i përket punësimit dhe objektivave afatmesme ose afatgjata që kanë të rinjtë për karrierën e tyre të ardhshme profesionale, AFP mendohet të ketë vetëm një avantazh - hyrjen e hershme të mundshme në tregun e punës. Megjithatë, të metat e mundin këtë avantazh. AFP zakonisht të mundëson punë, që nuk paguhet mirë, është e pasigurt, e dominuar nga informaliteti, ose që të çon në vetë-punësim më të gjitha sfidat që e shoqërojnë atë.

Së fundi, AFP nuk është tërheqëse për të rinjtë, duke qenë se ofruesit e AFP ofrojnë pak ose aspak jetës social-kulturore për nxënësit e tyre. Ndarja gjinore është shumë e fortë në AFP, e cila shpesh çon në mjedise edhe më të varfra dhe më pak stimuluese për të rinjtë. Në pjesët e mëposhtme do t'i kthehemi secilës nga këto perspektiva që kanë ndarë të rinjtë para dhe pas arsimit dhe formimit profesional në intervista dhe diskutime në fokus grupe me ato që u mbledhën nga dhënat parësore sasiore nëpërmjet atyre që tregojnë nxënësit aktualë të AFP-së, mësuesit, trajnerët dhe instruktorët.

4.2 Kush përfundon në AFP dhe si?


4.2.1. Profili social-ekonomik i nxënësve të AFP

Gjinia

Në një kontekst ku perceptimi për AFP-në mes të rinjve dhe tek publiku i përgjithshëm luhet mes atyre të paraqitura në pjesën e mëparshme, kemi të drejtë të shqyrtojmë edhe se si e gjithë kjo del se ndikon në profilin e atyre që ndjekin arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri. Me pak fjalë, të dhënat tona parësore sasiore tregojnë se AFP është kryesisht “bota e mashkullit të zakonshëm nga fshati”. Pjesa më e madhe e nxënësve AFP janë meshkuj. Kjo është e vërtetë për të gjithë sektorët, me përjashtim të profileve të tekstilit ku gratë janë në shumicë.

Gjetjet tona konfirmojnë atë që kanë gjetur hulumtimet e mëparshme në këtë

Figura 4. Gjinia dhe AFP në Shqipëri: Shpërndarja sipas profileve.




fushë. Në një studim bazë të vitit 2014 (GIZ / ETF, 2014), u evidentua dominimi i nxënësve meshkuj në AFP si në shkollat e arsimit profesional ashtu edhe në qendrat e formimit profesional (82% në SHP dhe 61% në QFP). Përqindja e nxënësve femra në shkollat profesionale ishte vetëm 18% dhe u pretendua se strukturat sociale të ofruesve AFP, fragmentizimi i tregut të punës, dhe një sërë pengesash të tjera për pjesëmarrjen e tyre (p.sh. mungesa e kualifikimeve, faktorët

e situatës, dhe pengesat institucionale) ishin faktorët kryesorë (GIZ, 2014).

Vendndodhja

Në vitin 2014, mbi 55% e nxënësve vinin nga zonat rurale (GIZ/ETF, 2014), por përbërja në shkollë ndryshonte shumë sipas vendndodhjes. Nxënësit zgjidhnin kryesisht një shkollë që ndodhej afër. Nëse shkolla ndodhet në zonë rurale, pjesa më e madhe e

Figura 5. Nxënësit AFP dhe ndarja urbane/rurale



nxënësve janë nga zonat rurale.¹⁹

Edhe pse shifrat tona nuk e mbështetin plotësisht profilin rural të perceptuar për nxënësit e AFP-së, sepse aktualisht vetëm 47% e kampionit të të anketuarve kishin (dhe i kanë ende) familjet në zonë rurale, perceptimi i fortë lidhet me atë që na ndihmojnë të kuptojmë edhe më mirë të dhënat cilësore. Edhe brenda 53% të familjeve urbane nga ku vijnë pjesa tjetër e nxënësve siç deklarojnë vetë ata, shumica dërrmuese e tyre besohet se janë nga familje që kanë ardhur kohët e fundit nga zonat rurale në ato urbane ose vijnë nga familje që jetojnë në zonat periferike të qyteteve të mëdha. Po ashtu, disa shkolla dhe profile (si bujqësia, energjia, etj.) po e përforcojnë këtë imazh të ofertës AFP duke u dominuar kryesisht nga djemtë që vijnë nga zonat rurale.


AFP dhe pakicat

AFP nuk rezulton të ketë përfshirë edhe pakicat. Në përgjithësi, rezultatet nga vëzhgimi ynë tregojnë se pakicat janë pothuajse jashtë panoramës së AFP-së në Shqipëri. Vetëm tekstilet, bujqësia dhe TIK kanë gjurmë të nxënësve që vijnë nga grupet e pakicave. Shqyrtimet e mëtejshme me fokus tek pakicat mund të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë arsyet prapa këtyre shifrave. Një pjesë e tendencës që vërehet vetëm tek TIK mund të jetë në sajë të politikës së veçantë të aplikuar për të rinjtë e komunitetit rom, për të cilët nuk zbatohet kriteri i notës mesatare, siç shpjegohet nga intervistat informatorët kyç. Edhe pse një politikë e tillë ka bërë që të rritet paksa numri i regjistrimit të të rinjve romë në profilin e TIK-ut, një gjë e tillë nuk është shoqëruar me masat mbështetëse që do të ndihmonin në trajtimin e hendekut në nivelin e nxënësve për përgatitjen akademike (e trashëguar nga nivelet e ndryshme të aftësive dhe njohurive nga sistemi i arsimit të mëparshëm që kanë ndjekur).

19 Për shembull, u evidentua se në Shkollën e Mesme Profesionale 'Beqir Çela' që ndodhet në rrethinat e Durrësit, 60% e nxënësve janë nga zonat rurale, ndërsa në Shkollën Ekonomike Teknike, që ndodhet në qendër në Tiranë, 82% e nxënësve vijnë nga qyteti (Xhumari, Dibra, 2013).

Figura 6. AFP dhe përfshirja e pakicave

A i përket ndonjë komuniteti minoritar në vend?




Konteksti i familjes së nxënësve të AFP-së

Statusi i familjes së nxënësve që ndjekin AFP në përgjithësi evidentohet ai i një

profili të cënueshëm. Në një hulumtim të vitit 2013, Xhumari dhe Dibra konstatuan se në shkollat që vëzhguan vetëm 29% e nxënësve i kishin të dy prindërit në punë, ndërsa 46% e nxënësve i kishin nënat të papunë (Xhumari dhe Dibra, 2013). Edhe të dhënat tona tregojnë hendekun mes numrit

Figura 7. Nxënësit AFP dhe konteksti i familjeve të tyre: Madhësia e familjes përkundër numrit të anëtarëve që sjellin të ardhura në të



të anëtarëve të familjes që marrin të ardhura mujore kundrejt tipologjisë së familjeve të mëdha për nga numri i anëtarëve në familjet e të anketuarve. Shumica e të anketuarve në të katër profilet jetojnë në familje të mëdha që variojnë nga 5 deri në 15 anëtarë. Megjithatë, pjesa më e madhe e të anketuarve raportojnë se vetëm dy ose një sjell të ardhura në familje.

Prania e burimeve të tjera të të ardhurave dominon mes nxënësve të profilit të ndërtimit, gjë që raportohet më pak tek nxënësit e tekstit. Një gjë e tillë mund të argumentohet se mund të lidhet ngushtë me faktin se shumica e nxënësve në profilin e ndërtimit vijnë nga zonat rurale (shih të dhënat e paraqitura në seksionin e mëparshëm), që do të thotë se toka dhe migracioni janë shpesh burime alternative (por jo të sigurta) të ardhurash. Në këto rrethana, të dhënat mund të sugjerojnë për një standard të ulët të jetesës të nxënësve të AFP-së dhe familjeve të tyre.

Jo vetëm statusi ekonomik i shumicës së familjeve të nxënësve të arsimit profesional

është mesatarisht i brishtë, por ato karakterizohen edhe nga niveli relativisht i ulët arsimor. Kjo, pjesërisht, mund të shpjegojë edhe disa nga ndryshimet që kanë familjet për sa i përket situatës së të ardhurave të pasqyruar më sipër. Xhumari dhe Dibra (2013) kanë konstatuar se niveli arsimor i prindërve ndryshon sipas qarkut (prindërit e nxënësve që vijnë nga shkollat e zonave rurale janë më pak të arsimuar), ndërkohë që konstatojmë se ky ndryshim është i konsiderueshëm edhe tek të gjithë sektorët. Siç jepet në grafikun e mëposhtëm, profili i vetmi ku nxënësit raportojnë në shumicë që të kenë (të paktën) një anëtar të familjes me diplomë universitare ose pas-universitare është TIK (58,90%); në të tri profilet e tjera, vihet re e kundërta. Në ndërtim, turizëm dhe tekstil, në më shumë se 70% të rasteve, anëtarë më të arsimuar i familjes nuk shkon përtej studimeve para-universitare.

Figura 8. Burimet alternative të të ardhurave për familjet e nxënësve AFP





Figura 9. Niveli i raportuar i anëtarit më të arsimuar të familjeve të nxënësve AFP




4.2.2. Cilësia e nxënësve të AFP-së

Në përputhje me perceptimin e përgjithshëm se AFP është për "nxënësit e dobët", evidencat tregojnë se kjo është e vërtetë dhe konfirmohet edhe nga të dhënat zyrtare dhe rezultatet e kërkimit. Nxënësit AFP kanë mesatarisht rezultate të ulëta mësimore. Kjo konsiderohet si reklamë negative për


sistemin gjë që bën që ky lloj arsimi të jetë më pak tërheqës për nxënësit e mirë. Duke u bazuar tek të dhënat e MMSR (2015), nota mesatare e nxënësve AFP është 6.4 nga 10 që është maksimalja. Nxënësit e regjistruar në TIK kanë mesatare më të lartë, mbi 8, të ndjekur nga ata në profilet e ekonomikut dhe hoteleri-turizëm.

Figura 10. Nxënësit AFP dhe performanca e tyre akademike

Rezultatet shkollore para pranimit në AFP




Rezultatet e vitit të mëparshëm shkollore



Në vëzhgimin tonë, kemi shqyrtuar prirjet aktuale të performancës së nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2015-2016. Në përgjithësi, profilet e AFP-së (përfshirë TIK)

tekstil dhe vetëm një pakicë në tre profilet e tjera e prirë nga TIK me 4.10% të nxënësve me 10 dhe 12.7% me 9 në matematikë në vitin e mëparshëm akademik.

Figura 11. Rezultatet mësimore në matematikë (nota e vitit të mëparshëm)



nuk janë shumë tërheqëse për nxënësit me notat më të mira. Në veçanti, ndërtimi dhe tekstilet janë më pak të preferuarat duke qenë se pesha specifike e nxënësve të dobët është më e madhe. Ajo që është edhe më e habitshme është se evidentohet një përkeqësim i performancës akademike edhe kur këta nxënës regjistrohen në sistem. Ndryshe nga besimi i përgjithshëm se arsimi profesional është më i lehtë se arsimi i përgjithshëm për të marrë nota të mira, tkurrja e grupit të nxënësve të mirë në të gjitha profilet konfirmon të kundërtën. Grafiku me rezultatet e vitit të mëparshëm akademik tregon se ndërtimi dhe turizmi janë dy profilet që vuajnë më shumë nga ulja në performancën akademike të nxënësve.

Duke parë edhe më tej në rezultatet mësimore të nxënësve aktualë, tendencat mbështeten edhe nga variacionet në rezultatet mësimore në matematikë. Nxënësit me nota të larta (9 ose 10) në matematikë nuk figurojnë fare në

Është argumentuar se, për të hetuar siç duhet çështjen e AFP nga pikëpamja ekonomike dhe sociale, AFP duhet të shihet si pjesë e një procesi të të gjithë ciklit të jetës në formimit të aftësive, e cila fillon që në mitër dhe përfundon në varr (Piedro et. al. 2010). Investimet në krijimin e aftësive duhet të fillojnë që në vitet e para të jetës. Studime të ndryshme në krijimin e aftësive tregojnë se përfitimet ekonomike nga investimet në aftësi janë më të mëdha në fëmijërinë e hershme dhe bien gjatë ciklit jetësor (Carneiro dhe Heckman, 2003). Megjithatë, investimi në krijimin e aftësive, (si njohës dhe jo-njohës) vetëm në jetën e hershme nuk mjafton. Këto investime duhet të ndiqen nga investime të mëtejshme për aftësitë, përndryshe ekziston rreziku i madh se individët nuk do të jenë në gjendje të përmbushin potencialin e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për individët që vijnë nga familje me të ardhura të pamjaftueshme socio-ekonomike, të cilët


jo vetëm kanë tendencë ta nisin me pak investime, por që më pas kanë akses në shkolla të cilësisë më të dobët dhe kështu bëjnë më pak investime të mëtejshme (Piedro et. Al. 2010). Këto pika të evidentuara nga literatura janë të rëndësishme për profilin e nxënësve të AFP në vëzhgimin tonë. Prirjet e investimeve të dobëta që në edukimin e hershëm mund të vihen re që në vitet e fëmijërisë së hershme të të anketuarve tanë.

është i varfër dhe më pak i aksesueshëm në zonat rurale në të gjithë vendin.

4.2.3. Akses fizik

Në intervista dhe diskutime në fokus grupe u shtjellua edhe qëndrimi i të rinjve nga


Figura 12. Vitet e shpenzuara arsimin parashkollor



Siç tregohet në Figurën 12, pjesa më e të anketuarve tanë kanë kaluar 2 vjet ose më pak në një institucion parashkollor. Përveç kësaj, në të katër sektorët, më shumë se 7% e të anketuarve nuk kanë qenë kurrë në një mjedis parashkollor para se të hynin në sistemin e detyrueshëm arsimor. Profili i tekstit, që ka edhe pjesën më të madhe të atyre me performancë të dobët akademike, ka edhe numrin më të madh të nxënësve që nuk kanë qenë kurrë në sistemin arsimor parashkollor (11.5% e të anketuarve në tekstil). Ky trend i përgjithshëm mund të lidhet lirshëm me origjinën rurale të shumë prej nxënësve të AFP. Sistemi parashkollor

shkollat e mesme të përgjithshme dhe ato profesionale për sa i përket aksesit në shkollë. Edhe pse distanca nga shkolla apo qendra e formimit profesional nuk u evidentuan si faktor i rëndësishëm, kur shohim prirjet e ravijëzuara nga të dhënat sasiore të nxënësve të regjistruar në arsimin profesional, mund të dallohen ndryshime të caktuara nga njëri profil në tjetrin. Në përgjithësi, aksesit tek institucioni AFP nuk është dhe aq i lehtë për një pjesë të mirë të të anketuarve. Nxënësit në TIK duket se kanë akses më të lehtë për në ndërtimin e shkollës, ndërkohë që më të vështirë e kanë nxënësit e profilit të energjisë, turizmit dh

Figura 13. Niveli i raportuar i vështirësisë për të shkuar në shkollë tek nxënësit AFP




ndërtimit. Në mënyrë të veçantë, për nxënësit e profilit të ndërtimit largësia nga shkolla duket se përbën çështje shqetësuese. Këtu vlen të rikujtojmë faktin se ky është profili në të cilin pjesa më e madhe e nxënësve vijnë nga zonat rurale, ndaj edhe largësia nga institucioni shkollor është edhe më e madhe.

Aksesi tek shkolla është rezultat i distancës nga ofruesi dhe i mundësisë për të vendosur

në konvikte kur të jetë e nevojshme. Në përgjithësi, të gjithë nxënësve të arsimit profesional që jetojnë në distancë 5 km ose më shumë nga shkolla u ofrohet mundësia që të vendosen në 23 konvikte shtrira në të gjithë vendin. Megjithatë, jo të gjitha shkollat e arsimit profesional e kanë mundësinë për të akomoduar nxënësit e tyre në konvikte. Rreth 9% e nxënësve të arsimit profesional jetojnë në konvikte. Edhe pse regjistrimi në

Figura 14. Ku po rrini aktualisht?



arsimin profesional është rritur dhe mbi 55% e nxënësve vijnë nga zonat rurale (d.m.th., që kanë të drejtë të jetojnë në konvikte sipas kritereve të përcaktuara), numri i nxënësve që zgjedhin të qëndrojnë në konvikt ka rënë. Kjo është kryesisht për shkak të kushteve të këqija të konvikteve publike, duke çuar në rritjen e numrit të nxënësve që zgjedhin të qëndrojnë në konvikte private, shtëpi me qira apo të qëndrojnë tek të afërmit që jetojnë në qytet (Dibër, 2015).


Megjithatë, të dhënat tona parësore konfirmojnë se qëndrimi me familjen është opsioni më dominues, pavarësisht distancës/vështirësive të raportuara për të shkuar në shkollë. Vetëm në ndërtim ka një numër tepër të madh nxënësish që raportojnë se aktualisht rrinë në konvikt. Është e rëndësishme të kujtojmë se edhe pjesa më e madhe në këtë profil janë meshkuj. Mundësitë e tjera, të tilla si shtëpi me qira të përbashkët me shokët, ose qëndrimi tek të afërmit, janë raste sporadike.

4.2.4. Mundësitë e barabartë dhe AFP

Regjistrimi i grupeve të marginalizuara në AFP

Në përgjithësi, regjistrimi në arsimin profesional në vend formësohet, mes faktorëve të tjerë, në bazë të kritereve të caktuara dhe masave të marra me qëllim rritjen e shkallës së regjistrimit, siç janë: (i) kriteret e regjistrimit të cilat në arsimin profesional kufizohen me mbarimin e arsimit të detyruar; (ii) skemë për bursa për nxënësit që jetojnë më shumë se 5 km larg nga shkolla e arsimit profesional, që rrinë në konvikte dhe që vijnë nga familje me kushte të vështira ekonomike, të regjistruar në një profil të një rëndësie strategjike për ekonominë dhe kanë rezultate të larta, qoftë rezident në zonat e privuar në verilindje dhe juglindje të Shqipërisë, ose që i përkasin grupeve të tjera specifike të rrezikuara (nxënësit e ish-të përndjekurve politikë, ata me aftësi të kufizuara, jetimët); (iii) fushata e regjistrimit të organizuara nga shkolla të ndryshme të vendit; (iv) trajnimi në qendrat e formimit profesional që ofrohet

Figura 15. A ofron shkolla juaj mundësi të barabarta?



falas për grupet e marginalizuara²⁰, përfshirë këtu të papunët e regjistruar; dhe (v) dyfishimi i ndihmës sociale për invalidët,²¹ nëse individit ndjek një program të arsimit dhe formimit profesional (shih Xhumari dhe Dibrën, 2013).

Të dhëna të tjera më të fundit, të tilla si ato të studimeve të GIZ/ETF (2014) tregojnë se në lidhje me aksesin e personave me aftësi të kufizuara, 50% e qendrave të formimit profesional raportojnë të kenë procedurë të veçanta për pranimin e tyre. Në disa qendra, individëve me aftësi të kufizuara thuhet se u është dhënë prioritet në procesin e regjistrimit. Disa qendra të formimit profesional deklarojnë se bashkëpunojnë me shoqatat dhe/ose hartojnë programe të veçanta për këtë grup specifik. Si për kontrast, shkollat e arsimit profesional duket se janë më pak të hapura për nxënësit me aftësi të kufizuara (vetëm 10% e këtyre shkollave kanë procedurë të veçanta për invalidët). Për sa i përket kushteve fizike, në përgjithësi nuk ka dispozita të hartuara për të lehtësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit

dhe formimit profesional. Vetëm shkollat profesionale që janë ndërtuar kohët e fundit në Projektin e IPA 2008 dhe Shkolla “Isuf Gjata” kanë rampe, që lehtësojnë hyrjen në ndërtesa për karrocën me rrota. Me ndihmë Projekti i KiE për Arsimin Gjithëpërfshirës, kjo e fundit ka përmirësuar indeksin e përfshirjes sociale përmes metodave gjithëpërfshirëse mësimore, mjedisit më të mirë në shkollë, dhe më shumë mundësi për aktivitete jashtëshkollore dhe mirëpret më shumë nxënës nga grupet e marginalizuara. Në këtë shkollë, 8% e nxënësve vijnë nga komuniteti rom dhe ai egjiptian, 2% janë me aftësi të kufizuara, 5.6% jetimë dhe 22% vijnë nga familje me prindër të papunë.

Pavarësisht këtyre masave, kur përshkruajmë profilin e përgjithshëm të nxënësve të AFP, konstatojmë se jo vetëm gjysma e popullsisë së re (vajzat) në vend vazhdojnë janë të nën-përfaqësuar, por që edhe pakicat e çdo lloji pothuajse mungojnë në sistem. Vëzhgime të tilla mbështeten edhe nga të dhënat që zbulojnë çështje të rëndësishme dhe nganjëherë të habitshme për mundësitë e barabarta në këtë sektor, që në aspektin e mundësive për të hyrë dhe për të bërë përpara në AFP. Përtej ndarjes së thellë gjinore sipas sektorëve dhe profileve, siç u theksua më parë, sistemi jep mundësi të kufizuara të barabarta për të hyrë dhe për të përparuar në sistem. Mundësitë e barabarta sfidohen nga një sërë treguesish socialë.

Edhe pse pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në vëzhgimin tonë nuk raportojnë mungesë të mundësive të barabarta brenda arsimit profesional që ndjekin, nga ata që raportojnë mungesë të tillë, paaftësia fizike dhe origjina (qarku) perceptohen si baza kryesore për mungesën e barazisë së mundësive.

Duke shqyrtuar edhe më tej diferencat e mundshme mes sektorëve/profileve, konstatojmë se origjina e nxënësit është faktor më i rëndësishëm për pranimin në

20 Edhe pse zyrtarisht regjistrimi në sistemin e arsimit dhe formimit profesional nuk lejohet pa përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, ka raste që bëhen lëshime për të lejuar romët të ndjekin kurse trajnimi. Problemi kryesor për edukimin e romëve është mungesa e arsimit fillor, të paktën ai i aftësive bazë të leximit dhe shkrimit. Fëmijët romë regjistrohen në kurset e trajnimit të qendrave të formimit profesional nëse janë të moshës 14-16 vjeç, me leje nga Inspektorati i Punës. Janë promovuar modele të mira të vajzave të mëparshme të suksesshme rome (parukiere) dhe djemtë (bukëpjekës) në programin e formimit profesional në Durrës financuar nga PNUD.

21 Aksesin në AFP për nxënësit me aftësi të kufizuara mbetet problematik. Sipas Vëzhgimit Inventari dhe Kushte e Shkollës - Shqipëri 2011, “4.1% e objekteve shkollore në Shqipëri janë të aksesueshëm për karrocën me rrota, 2.4% janë të aksesueshëm vetëm në katin e parë. Vetëm 1.7% e ndërtesave kanë klasa që arrihen lehtë pa nevojën e një rampe. Vetëm 5% e objekteve shkollore në Shqipëri kanë të paktën një tualet të përshtatur për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara, shumica e të cilave janë në zonat urbane.” Disa prej shkollave po bëjnë të pamundurën për të akomoduar nxënësit me aftësi të kufizuara me infrastrukturën ekzistuese. Shkolla ekonomike, për shembull, po akomodon nxënësit me aftësi të kufizuara fizike në katet e parë dhe ka ndërtuar një banjë specifike me ta, edhe pse asnjëra prej zgjidhjeve nuk përmbush standardet e BE-së (Xhumari, Dibra, 2013).

profilet e administrimit të mbetjeve dhe përparimin në profilin e ndërtimit. Por pranimi në profilin e ndërtimit pengohet më së shumti nga paaftësia fizike. Kjo paaftësi mund të jetë kufizim serioz në përparimin edhe brenda profileve të sektorëve të administrimit të mbetjeve dhe energjisë.

Situata ekonomike e familjes mendohet se përcakton më së shpeshti mundësitë për t'u pranuar në profilin e ndërtimit dhe për përparim në atë të energjisë.


Përkatësia fetare, faktori i dytë i renditur për pabarazinë në AFP, merr më shumë pikë për pranimin në profilin e energjisë dhe të menaxhimit të mbetjeve si dhe në lidhje me mundësinë për të bërë përpara me shanse të barabarta në profilet e energjisë dhe ndërtimit. E fundit por jo më pak e rëndësishme, gjinia, edhe pse nuk është një ndër përcaktuesit e parë për kufizimin e mundësive të barabarta (në përgjithësi, është zgjedhja e tretë më popullore), bën që

mundësitë të ndryshojnë në këtë drejtim për sa i përket pranimi në profilet e bujqësisë, turizmit, menaxhimit të mbetjeve dhe ndërtimit. Përparimi në profilet e bujqësisë dhe ndërtimit lidhet kryesisht edhe me mundësitë e ndryshme në bazë të dallimeve gjinore.

Ndërtimi ka një incidencë më të lartë duke iu referuar të gjithë treguesve. Duke u fokusuar më tej në 4 profilet e interesit si dhe tek nëngrupet e atyre që deklarojnë se shkolla e tyre nuk ofron mundësi të barabarta, ne i krahasojmë tendencat ndërmjet tyre dhe rezultatet e përgjithshme të të gjithë kampionit. Rezultatet jepen në grafikun e mëposhtëm.

Në ndërtim, frenuesit më të fortë për t'u pranuar dhe për të përparuar raportohet të jenë paaftësia fizike dhe gjendja ekonomike e familjes që në hyrje. Paaftësia mbetet një frenues që perceptohet se ndikon fuqishëm në përparim. Megjithatë, përkatësia fetare

Figura 16. Përqindja e atyre që besojnë se shkolla NUK ofron mundësi të barabarta duke u bazuar në:



zë vendin e parë si bazë për pabarazi në shanset për përparim në ndërtim. Në profilin e TIK, gjendja ekonomike dhe përkatësia fetare mbizotërojnë, si në pikën e pranimit ashtu edhe të përparimit, kur regjistrohen në shkollë. Gjinia bëhet e një rëndësie parësore vetëm kur marrin parasysh Tekstilin dhe Turizmin. Në të dy këto profile, gjinia është e rëndësishme si bazë pabarazie për t'u pranuar dhe për të përparuar në shkollë. Është interesante të evidentohet se përkatësia fetare vazhdon të jetë faktori i dytë më i rëndësishëm edhe në tekstile dhe turizëm. Edhe pse hulumtimet e mëparshme kanë studiuar pabarazitë në bazë të gjinisë, paaftësisë fizike dhe gjendjes ekonomike, përkatësia fetare për herë të parë identifikohet si faktor i fortë. Është shumë e nevojshme të bëhen kërkime të mëtejshme për të kuptuar më shumë pse dhe si ndikon përkatësia fetare mundësi për pranimin dhe përparimin në AFP.

Çështjet e mundësive dhe diskriminimit në AFP u trajtuan edhe nga perspektiva e mësuesve në të njëjtët institucione. Mes mësuesve që kanë raportuar mungesën

e mundësive të barabarta në AFP e tyre përkatëse për nxënësit që të pranohen dhe të përparojnë, përkatësia gjinore evidentohet si arsyeja dominuese për pabarazinë në pranimin në AFP, ndërsa gjendja ekonomike është pothuajse dy herë më e rëndësishme për rrezikun që ka ndaj mundësive të barabarta të nxënësve për përparim.

Edhe pse diferenca në moshë është e vogël mes nxënësve që të përbëjë bazë për ndryshim në mundësitë e ofruara, situata me mësuesit ndryshon. Kur pyeten për shpeshtësinë e rasteve që dëshmojnë për diskriminimin në vendin e punës (d.m.th., në shkollën përkatëse të arsimit profesional) ku përfshihen nxënës dhe/ose mësues, këta të fundit perceptojnë një situatë paksa më të ndryshme. Ndër situatat më shpesh të dëshmuara të diskriminimit që raportojnë ata janë mosha dhe paaftësia fizike. Ndryshe nga nxënësit, për mësuesit përkatësia fetare vjen e fundit. Edhe këtu nevojiten hulumtime të mëtejshme për të shkuar përtej kësaj prirjeje dhe për të kuptuar variacione të tilla.

Çështjet e pabarazisë së bashku me

Figura 17. Perceptimet e mësuesve për mungesën e mundësive të barabarta për nxënësit që të pranohen dhe të përparojnë në institucionet e AFP-së

A ofron shkolla mundësi të barabarta (% e mësuesve që thonë "Jo")





Figura 18. A keni dëshmuar ndonjëherë raste të diskriminimit (në % e mësuesve që kanë dëshmuar “shpesh” dhe “shumë shpesh”)?



problemet e tjera socio-psikologjike të nxënësve pritet të trajtohen nga shërbimi psikosocial në shkollë. Çdo shkollë duhet të ketë një psikolog me kohë të pjesshme në shkollë që të jetë përgjegjës për (të paktën) krijimin e hartës sociale me të dhëna sociale dhe ekonomike për të regjistruarit e rinj, por jo të gjitha shkollat e arsimit profesional përfitojnë nga ky shërbim. Edhe kur e marrin këtë shërbim, numri i nxënësve për psikolog (apo punonjës social) është shumë i lartë që të mund të bëjë punë intensive/ të individualizuar kur evidentohen probleme.

4.2.5. Zgjedhja e AFP – Zgjedhja e profesionit (Orientimi)

Zgjedhja e arsimit profesional si alternativë arsimimi vlerësohet shpesh si e vështirë edhe duke pasur parasysh faktin se vendimi lidhet menjëherë me zgjedhjen e një orientimi dhe një profesioni shumë herët në jetë (kur nxënësi është vetëm 15 vjeç). Në këtë seksion, kemi shqyrtuar se si të rinjtë zgjedhin AFP-në dhe veçanërisht orientimin kur futen brenda në sistem.

Në vitin 2014, shpërndarja e nxënësve nëpër profilet me kohë të plotë të AFP ndryshon si në grafikun e mëposhtëm, me shërbimin e makinave që është edhe profili më i kërkuar (15%), e ndjekur nga ekonomiku dhe biznesi (13%), TIK (12%), dhe hotelieri-turizëm (11%) (GIZ / ETF, 2014).

Trajnimi profesional ofrohet në 10 qendra publike të trajnimit profesional që veprojnë në qarqe të ndryshme të Shqipërisë dhe në një numër të madh qendrash private të trajnimit (340 subjekte të licencuara dhe 30 që operojnë si qendra të trajnimit profesional) që ofrojnë kurse trajnimi afatshkurtër (SKPA 2014-2020). Kursantët që marrin pjesë në kurset afatshkurtra të ofruara në QFP publike tregojnë për një mungesë ekuilibri mes kurseve profesionale dhe atyre plotësuese (gjuhë të huaja dhe njohuritë për kompjuterin), ku ky i fundit kishte 38% të kursantëve në vitin 2013 (22% që ndjekin kursin e gjuhës angleze). Kurset afatshkurtra për instalimet elektrike, termo-hidraulike, rrobaqepësi dhe kulinari përbëjnë regjistrimin e dytë më të lartë, me rreth 7% secila (GIZ / ETF, 2014). Të

dhënat e fundit për kursantët nga QFP-ve tregojnë se në vitin 2014, numri i kursantëve (13,102, nga të cilat 45% femra) u rrit me më shumë se 47% në krahasim me vitin 2013 (SHKP). Gjithsesi, mungon informacioni për regjistrimin në qendrat jopublike.

Përkundër këtyre dispozitave dhe regjistrimeve, konstatohet se kërkesa për AFP tek nxënësit e rinj të klasës së 9-të mbetet shumë e vogël dhe e paqartë. Në diskutimet e fokus grupeve me profile të ndryshme të kësaj grupmoshe është konfirmuar se ylli udhëzues që orienton zgjedhjet e tyre për zhvillimin e aftësive dhe karrierë në Shqipëri është universiteti. Universiteti është një domosdoshmëri në mendjet e shumë djemve dhe vajzave të reja dhe sidomos në mendjet e anëtarëve më të mëdhenj në familjet e tyre (prindërit apo vëllezërit e motrat më të mëdhenj). Fakti i thjeshtë se shkolla e mesme e përgjithshëm ju përgatit më mirë dhe ju jep mundësinë për t'u vlerësuar me pikët më të larta për të hyrë në universitet e bën arsimin profesional automatikisht një alternativë më pak të preferuar.

Në komponentin sasior të studimit tonë, pyetëm nxënësit nëse shkolla aktuale që ishin të regjistruar ishte edhe zgjedhja e tyre e parë. Në total 17.8% ndiqnin një program që nuk e preferonin si zgjedhje të parë. Pjesa e kësaj kategorie nxënësish ishte shumë më e madhe në profilin e tekstilit. Pothuajse një në tre nxënës të tekstilit kishte një zgjedhje të ndryshme të parë nga ajo ku ishte i regjistruar aktualisht.

Zgjedhje të tilla nuk janë gjithmonë vendim i marrë nga nxënësi. Në përgjithësi, 11.6% e pjesëmarrësve raportuan se ishin përfshirë në një program që një person tjetër e kishte zgjedhur për të. Një gjë e tillë ishte më e zakonshme mes nxënësve të TIK. Pothuajse 15% e këtyre nxënësve të përfshirë në kampionin tonë raportonin se ishin nxitur drejt profilit TIK.

Të dhënat për kursantët tregojnë një realitet tjetër. Ndryshe nga nxënësit AFP, gati 97% e kursantëve në AFP kanë zgjedhur vetë kursin e trajnimit ku ishin të regjistruar aktualisht.

Figura 19. A ishte kjo shkollë zgjedhja jote e parë? (në % të përgjigjes "Jo")





Figura 20. Burimet kryesorë të informacionit për zgjedhjen e shkollës




Vështirësitë apo pasiguritë në zgjedhjen dhe marrjen e vendimit për të ardhmen e arsimimit të tyre lidhen me mungesën ose dobësinë e programeve për orientimin profesional dhe ose shërbime që synojnë këtë kategori të rinjsh. Orientimi profesional është një nga pikat e dobëta në zinxhirin e institucioneve dhe aktorëve që orientojnë dhe mbështesin të rinjtë shqiptarë në zgjedhjen dhe përparimin në AFP. Në përgjithësi, 82% e të anketuarve që janë marrin pjesë në AFP kanë pasur të njëjtin ofrues si zgjedhjen e parë dhe 89% e të anketuarve raportojnë ta kenë marrë vetë vendimin për ndjekjen e arsimit profesional. Kur u pyetën për llojet e burimeve që përdorën për të marrë vendimin se cilën shkollë të ndiqnin, ata renditën të parën lëndën e “orientimit të karrierës”, pjesë e kurrikulës të arsimit 9-vjeçar. Fatkeqësisht, ky burim i rëndësishëm i raportuar nga të anketuarit është hequr aktualisht nga kurrikula. Intervistat me fokus grupet me nxënës të shkollave 9-vjeçare konfirmuan se ndryshimet në vitet e fundit në programin shkollor kishin ndikim të drejtpërdrejtë në mungesën totale të kësaj lënde.

Nga ana tjetër, burimet kryesore të informacionit për kursantët për të mësuar në lidhje me qendrën janë miqtë dhe të afërmit (72%). Burimi i dytë më i rëndësishëm raportohet të jenë zyrat e punësimit (26%), një faktor që është ekskluziv për kursantët AFP dhe që nuk ka lidhje me nxënësit e AFP.

Edhe pse programet promovuese në shkollë dhe interneti janë dy burime të tjera më të rëndësishme informacioni, të dhëna cilësore na ndihmojnë të kuptojmë se karriera e këtyre të rinjve ndikohet kryesisht nga prindërit dhe bashkëmoshatarët edhe pse përmes internetit mund të bëhen kërkime të mëtejshme. Kjo mund të shpjegojë edhe përqindjen e konsiderueshme të atyre që zgjedhën opsionin “tjetër” (16%). Në fakt, tradita e arsimit profesional në familje rezulton mjaft e përhapur tek nxënësit që ndjekin aktualisht këtë lloj arsimit. Grafiku i mëposhtëm tregon se më shumë se gjysma e nxënësve të TIK kanë të paktën një anëtar të familjes që ka ndjekur arsimin profesional. Incidenca e të njëjtit profil të traditës familjare është e lartë edhe tek të sektorët e tjerë ku

Figura 21. Anëtarë të familjes me edukim AFP



më të ulët in e ka ndërtimi me 35%. Madje edhe në ndërtim, një në tre nxënës pranon që arsimi profesional të ketë qenë pjesë e familjes para se të ndërmerrenin rrugëtimin e tyre drejt arsimit profesional.

Në fakt, ndryshe nga sa konstatojnë Xhumari dhe Dibra²², familja dhe miqtë përbëjnë faktorin më të rëndësishëm që ndikon në zgjedhjen dhe vendimmarrjen e nxënësve për ndjekjen e arsimit profesional përkundër atij të përgjithshëm. Në përgjithësi, 53.5% e të intervistuarve tanë rendisin familjen dhe miqtë si faktorin kryesor. Së dyti, faktori më i rëndësishëm është punësimi që besohet se ofron shkollë/profilin (për rreth 40% të të anketuarve). Tek të gjithë profilet, konstatojmë familjen dhe miqtë që konfirmohen si faktori nr. 1 kontribuues në profilet e tekstit dhe ndërtimit. Nga ana tjetër, TIK dhe Turizmi ndryshojnë nga tekstili dhe ndërtimi, siç ndryshojnë edhe për nga rezultati i përgjithshëm. Faktori

më i rëndësishëm për nxënësit e këtyre dy profileve raportohet të jetë "Më kanë pëlqyer drejtimet që shkolla ofron", me 49.66% dhe 41.71% në turizëm dhe TIK përkatësisht. (Për më shumë detaje shih Tabela 4 më poshtë.). Kjo prioritet vlen edhe për kursantët e AFP. Për të zgjedhur qendrën e formimit profesional, ata raportojnë se familja dhe miqtë janë ndër faktorët kryesorë (në 33% të rasteve). Megjithatë, dy faktorët kryesorë janë më shumë të lidhur me talentin/interesat (40%) dhe mundësinë për të mësuar një profesion të ri me anë të praktikës (35%). Variacionet e vërejtura mes nxënësve dhe kursantëve duhet të testohen më tej (duke qenë se kampioni i kursantëve ishte më i vogël). Megjithatë, mund të hidhet hipoteza se diferenca e moshës mes dy grupeve mund të jetë faktor përcaktues në hendekun midis dominimit të familjes/miqve tek nxënësit dhe interesit individual/talentit tek kursantët.


Pas zgjedhjes së arsimit profesional, nxënësit e AFP-së duhet të vendosin se cilat profilet të ndjekin. Në marrjen e këtij vendimi hyn në lojë ndikimi i faktorëve të

22 Rezultatet treguan se arsyet kryesore për zgjedhjen e AFP ishin mundësitë për punësim, ndjekur nga profilet interesante dhe mundësitë për të vazhduar universitetin. Pritshmëritë e familjes dhe miqve ishin faktorë më pak të rëndësishëm (Xhumari dhe Dibra, 2014).

Tabela 4. Faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikuar në zgjedhjen e AFP

Renditja	TOTAL	Turizmi	Tekstili	TIK	Ndërtimi
1	53.50% Familja/miq të	49.66% Më kanë pëlqyer drejtimit që shkolla ofron	49.18% Familja/miq të	41.71% Më kanë pëlqyer drejtimit që shkolla ofron	59.72% Familja/miq të
2	39.57% Mundësia që me jep kjo shkollë për t'u punësuar në të ardhmen	36.62% Mundësia që me jep kjo shkollë për t'u punësuar në të ardhmen	31.16% Më kanë pëlqyer drejtimit që shkolla ofron	40.17% Familja/miq të	38.81% Mundësia që me jep kjo shkollë për t'u punësuar në të ardhmen

Figura 22. Ndikimi i faktorëve për përzgjedhjen e profilit



tjerë. Për të gjithë popullatën e kampionit tonë, "Mundësitë për të fituar më shumë të ardhura" janë faktori më i rëndësishëm që ata marrin në konsideratë kur zgjedhin profilin. Megjithatë, kjo ndryshon mes profileve tona të interesit. Faktori kryesor i përgjithshëm konfirmohet vetëm në ndërtim. Turizmi rezulton më tërheqës duke qenë se programi perceptohet nga nxënësit si interesant. Ndërsa në profilet e TIK dhe tekstileve, është talenti/interesi, ai që mbizotëron mes të gjithë faktorëve ndikues.²³

Është me interes të evidentohet se për kursantët faktori më shumë ndikim në zgjedhjen e profilit/kursit lidhet me modulet që zhvillohen në kurs (29.31%). Brenda pritshmërive futet edhe faktori i dytë më i rëndësishëm, mundësia për të kombinuar lëndët teorike me praktikën (21%), që mendohet se është më e madhe në programet e formimit profesional.

Pjesa 5. Cilësia e ofrimit të AFP-së

5.1. Hartimi i kurrikulës

Kualifikimet profesionale në sistemin e arsimit të mesëm ofrohen në një, dy ose tre nivele apo bllok, duke ndjekur strukturat përkatëse të arsimit të 2 + 2 ose 2 + 1 + 1, dhe 4 vjet, me pikë dalje dhe ri-hyrjes, gjë që, në parim, do të mundësojë fleksibilitet vertikal dhe horizontal. Pas përfundimit me sukses

të çdo niveli, nxënësit i jepet një certifikatë profesionale dhe në fund të vitit të katërt edhe një diplomë e maturës shtetërore (pas provimeve të maturës shtetërore). Në nivelin e parë (2 vjet), nxënësit ndjekin drejtimin profesional duke fituar kompetenca të përgjithshme në lidhje me kualifikimin. Në vitin e tretë, nxënësit mund të zgjidhni një nga profilet që ofrohen në çdo drejtim. Në strukturat arsimore 2 + 1 + 1, vitin e fundit (niveli i tretë) është përsëri i përgjithshëm në lidhje me drejtimin profesional.

Kurrikula e arsimit profesional ndahet në: (i) arsim të përgjithshëm. (ii) teori profesionale; dhe, (iii) praktikë profesionale, të llogaritura në orë mësimi dhe organizohet në kornizën kurrikulare kombëtare dhe në kurrikulën e shkollës. Korniza kurrikulare kombëtare hartohet nga AKAFP. Komponenti i arsimit të përgjithshëm përpilohet nga Ministria e Arsimit, ndërsa pjesa profesionale e kurrikulës organizohet sipas strukturës modulare dhe bazohet në rezultatet e të nxënit. Kurrikula mësimore hartohet nga mësuesit e lëndëve të teorisë dhe praktikës profesionale, të cilët përkthejnë kornizën kurrikulare në programe mësimore, që do të ishte mirë harmonizoheshin me nevojat specifike rajonale. Në këtë aspekt, roli i mësuesve dhe aftësia e tyre për të përmbushur këtë detyrë merr rëndësi tepër të madhe, po aq sa edhe kushtet e infrastrukturës, marrëdhëniet të institucioneve AFP me punëdhënësit si dhe kuadri ligjor.

Projektet ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e sistemit shqiptar të arsimit profesional për vite me radhë kanë ndihmuar në hartimin e kurrikulave pilot sipas strukturës ekzistuese, p.sh., GIZ/PEM me Projektin "Mbështetje Veri-Lindje për AFP-në" në tekstile dhe veshje, Projekti "AlbVET" mbështetur nga SDC/Swisscontact për Termo-Hidraulikën. Statistikat për regjistrimin në arsimin profesional (MMSR, (2015) dhe GIZ/ETF (2014)) tregojnë

²³ Ky konstatim është në përputhje edhe me gjetjet nga kërkimet e mëparshme (shih Dibra, 2015)

Tabela 5: Struktura dhe profilet e arsimit profesional

Sektori	Drejtimi profesional	Struktura	Profilet
TIK	TIK	2+2	Mbështetje teknike për përdoruesit TIK; rrjeti i të dhënave; krijim faqe ueb; multimedia; elektronika e teknologjisë së automatizuar; pilot Austria
	Elektronika	2+1+1	Telekomunikacioni; riparimi i pajisjeve elektronike; mekatronika
Ndërtimi	Ndërtimi	2+1+1	Murator/suvatues; ndërtim rruge; shtrim; marangoz, përpunim hekuri dhe betoni
	Gjeodezi	4	Gjeodezi
	Termo-Hidraulika	2+1+1	Instalime hidraulike; instalim sistemi ftohje/ngrohje; instalime termo-hidraulike; panele diellore dhe hidraulike ²⁴
	Elektro-teknika	2+1+1	Instalime elektrike civile dhe industriale ²⁵
Turizmi	Hoteleri-turizëm	2+1+1	reception; bar restorant; kuzhinë dhe ëmbëltore; guidë turistike
Tekstilet	Tekstile-konfeksione	2+1+1	rrobaqepësi; tekstile; modelim; produkte lëkure; konfeksione

Burimi: të dhënat nga AKAFP dhe MMSR. Llogaritjet e autorit

se qëndrueshmëria e këtyre ndërhyrjeve është e lartë vetëm nëse projekte ndjekin një përfaqëse sistemi duke mbështetur komponentëve të tjerë të AFP-së, të tillë si zhvillimi i kapaciteteve, përmirësimi i infrastrukturës, formalizimi i rrjeteve me partnerët e biznesit, etj., dhe nëse ndërhyrja bëhet në nivel kombëtar e jo vendor.

Në tabelën e mëposhtme jepet përbërja e kurrikulës së strukturave të ndryshme të arsimit profesional.²⁴ Arsimi i përgjithshëm, që është pjesë e orëve të kurrikulës, është më i pranishëm në vitin e parë dhe të dytë të shkollës. Në përgjithësi, përqindja më e madhe e praktikës profesionale është në vitin e tretë të studimeve.

AKAFP mendohet se është përgjegjëse edhe për kurrikulën kombëtare të kurseve të trajnimit, por nuk po e kryen plotësisht këtë detyrë për shkak të periudhës kalimtare të transferimit të të gjitha përgjegjësisë për arsimin dhe formimin profesional tek MMSR dhe institucionet në varësi të saj si dhe duke qenë të ligjit për arsimin profesional është ende në diskutim. Për momentin, në lidhje me kurset në rang kombëtar, qendrat e formimit

24 E gjitha kurrikula mund të merret nga faqja e AKAFP në internet. Kjo strukturë i referohet kornizës kombëtare kurrikulare. Kurrikulat pilot kanë një tjetër ndarje të orëve të mësimi.

25 Panelet solare dhe hidraulike përbëjnë një specializim në vitin e tretë. Kurrikula u hartua me mbështetje nga AlbVET. Nuk ka informacion të saktë nëse zgjidhet dhe disponohet ende ky profil.

26 Ndër profilet e tjera janë edhe: elektro-mekanika, instalimi dhe mirëmbajtja e linjave të voltazhit të lartë dhe të ulët, riparimi i pajisjeve elektroshtëpiake, teknologjia e automatizimit.


Tabela 6: Raporti arsim i përgjithshëm – teoria profesionale– praktika profesionale

Struktura	Niveli	Klasa	Arsimi i përgjithshëm		Teoria profesionale		Praktika profesionale	
			Orë	%	Orë	%	Orë	%
2+1+1	I	10	540	48%	360	32%	216	19%
		11	374	35%	272	26%	408	39%
	II	12	240	24%	238	24%	511	52%
		13	510	50%	306	30%	204	20%
2+2	I	10	540	48%	360	32%	216	19%
		11	442	43%	272	27%	306	30%
	III	12	324	30%	324	30%	432	40%
		13	442	43%	272	27%	306	30%
4	III	10	540	50%	324	30%	216	20%
		11	396	35%	396	35%	324	29%
		12	432	39%	288	26%	396	35%
			476	45%	272	26%	306	29%

Burimi: AKAFP. Llogaritjet e autorëve

profesional po punojnë me programet e hartuara më parë nën përgjegjësinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ndërsa për kurset shtesë afatshkurtra që ofrohen nga qendrat, për hartimin e programit të kursit të trajnimit janë përgjegjës instruktorët sipas udhëzimeve të dhëna. Rreth 76% e instruktorëve raportojnë se janë përgjegjës

Figura 23: Niveli i kënaqësisë me teorinë me praktikën dhe ngarkesën mësimore



për hartimin e programit të kursit të trajnimit dhe për 79% të tyre udhëzimet e dhëna janë të qarta.


Të dhënat nga vëzhgimi tregojnë se sa të kënaqur janë nxënësit, mësuesit, kursantët dhe instruktorët me raportin mes praktikës dhe teorisë. Në përgjithësi, nxënësit janë më të kënaqur me këtë raport krahasuar me kursantët. Ky ndryshim mund të interpretohet me faktin që kursantët presin më shumë praktikë, duke qenë se interesi i tyre për njohuri të përgjithshme mund të jetë i vogël për shkak të arsimimit të tyre të mëparshëm dhe planeve për të ardhmen (punësim përkundër vazhdimit të arsimimit). Në këtë drejtim është e nevojshme të bëhen studime të mëtejshme.

Nxënësit e regjistruar në profilet e lidhura me sektorin e tekstit janë më të kënaqur me raportin teori-praktikë krahasuar me sektorët e tjerë. Kjo diferencë mund të jetë edhe si rezultat i përqindjes së të anketuarve në vitin studimi. Përqindja më e lartë e nxënësve në vitin e trete, që ka edhe përqindjen më të madhe të orëve të praktikës, i përkasin profilit të tekstit.

Nxënësit e regjistruar në programet TIK janë më pak të kënaqur me këtë raport. Në këtë drejtim nevojitet një analizë më e thellë, por pritet që nxënësit TIK të kenë nevojë për më shumë lëndë praktike.

Opinionin dominues i mësuesve për kurrikulat ka të bëjë me realizimin e orëve të praktikës pranë subjekteve të biznesit. Plot 79.5% e mësuesve mendojnë se kjo është e rëndësishme ose shumë e rëndësishme për të arritur rezultatet e të nxënësve. Lidhur me pjesën e komponentëve të ndryshëm, në kurrikula, më shumë se gjysma e mësuesve (52%) janë dakord ose janë plotësisht dakord se ka një ekuilibër të mirë mes teorisë dhe praktikës. Rritja e orëve të praktikës profesionale është opsioni për të cilin bien më shumë dakord për sa i përket ndryshimeve hipotetike në kurrikula. Pohimi që ka marrë më pak pëlqimin e mësuesve lidhet me reduktimin e orëve të lëndëve të përgjithshme në ngarkesën mësimore. Kjo mund të jetë rezultat i përgjigjes që japin kësaj pyetjeje mësuesit e lëndëve të përgjithshme, që përfaqësojnë 43% të të anketuarve. Vlera mesatare e këtij opsioni "Duhet të reduktohet përqindja e orëve të lëndëve të njohurisë së përgjithshme" rritet

Figura 24: Opinioni i mësuesve për kurrikulën



në 2.71 (nga 2.24) nëse marrim parasysh përgjigjet e vetëm mësuesve të lëndëve profesionale.

Kur pyeten vetëm mësuesit e lëndëve profesionale (të teorisë dhe praktikës) si dhe instruktorët e qendrave të formimit profesional, pjesa më e madhe e tyre besojnë se lëndët, që janë pjesë e kurrikulës profesionale, përmbajnë module të rëndësishme për profesionin. Pohimi më pak i miratuar për kurrikulën e arsimit profesional është mundësia e infrastrukturës për të realizuar programin, dimension që për qendrat e formimit profesional është më pak problematik.

Ky konstatim për arsimin profesional mbështetet nga statistikat e MMSR (2015), sipas të cilave vetëm një numër i kufizuar profilesh zgjidhen për çdo drejtim profesional, duke mos shfrytëzuar rastin e ofertës së pasur dhe të larmishme. Ka plot 29 profile që ofrohen në drejtime profesionale të lidhura me sektorët dhe vetëm 20 prej tyre zgjidhen. Mendohet që kjo zgjedhje e kufizuar është për shkak të numrit të nxënësve që regjistrohen në çdo drejtim dhe për shkak të burimeve të kufizuara për sa i përket infrastrukturës (pajisjet dhe materialet bazë, laboratorë, klasa) dhe burimeve njerëzore.

Analiza sektoriale e kryer për qëllime kërkimore në fazën fillestare të Projektit Aftësi për Punë evidentoi se disa nga këto profile janë më të kërkuarat sipas sektorëve ekonomikë përkatës ose të lidhur me to. Nga sektorët e zgjedhur, në tekstile dhe TIK, mungesa e materialeve dhe infrastrukturës u identifikuan si faktorë që kufizojnë hartimin e kurrikulës së shkollës.

Mësuesit e lëndëve profesionale në shkollat e arsimit profesional dhe qendrat e formimit profesional konstatojnë mungesën e materialeve mësimore që përdoren në klasat apo kurset e tyre si problematik, dimension që do të shqyrtohet më shumë në një seksion të veçantë.

Mes pohimeve më pak të miratuara është "Programet janë të përshtatura me zhvillimet e reja të teknologjisë", gjetje që mbështetet edhe nga analiza sektoriale.


Opinionin e mësuesve për kurrikulën e arsimit profesional tregojnë nevojën për ndërhyrje në formë dhe përmbajtje, me qëllim që ajo të bëhet më e absorbueshme për nxënësit e AFP (nxënës të dobët në mësim që në praninë). Ngritja e kapaciteteve të mësuesve nevojitet në lidhje me hartimin e programeve

Tabela 7. Profilet e kërkuara nga tregu i punës pa regjistrime në AFP

Sektori ekonomik	Profili i pazgjedhur	Drejtimi	Struktura
Turizëm	Agro-turizmi	Agrobiznes	2+2
	Turizëm; guidë turistike	Hoteleri-turizëm	2+2
Ndërtim	Marangoz, përpunues hekuri dhe betoni	Ndërtim	2+1+1
Tekstile	Tekstili, modelim	Tekstile – konfeksione	2+1+1
TIK	Krijues faqe ueb	TIK	2+2

Burimi: Statistikat e MMSR 2015 dhe studime të tjera sektoriale

Figura 25. Opinioni i mësuesve dhe instruktorëve për kurrikulën



mësimore sipas rezultateve të të nxënit dhe krijimit të mekanizmave për kontrollin e të nxënit.

Gjetjet e mësipërme që vijnë nga vëzhgimi i mësuesve dhe instruktorëve tregojnë se formimi profesional, sigurimi i zhvillimit të aftësive profesionale me anë të kurseve afatshkurtra dhe kurrikula më pak e ndërlikuar dhe më shumë e decentralizuara hasin më pak sfida në krahasim me arsimin profesional. Si rezultat, reforma e programit mësimore në arsimin profesional duhet të jetë më e plotë dhe e hartuar me më shumë kujdes.

5.2. Mësuesit dhe instruktorët

Personeli pedagogjik në shkollat e arsimit profesional përbëhet nga mësues që japin lëndët e arsimit të përgjithshëm, mësuesit e lëndëve të teorisë profesionale dhe

të praktikës profesionale.²⁷ Në qendrat e formimit profesional stafi pedagogjik përbëhet vetëm nga instruktorët. Në këtë vëzhgim u përfshinë gjithsej 216 mësues të arsimit profesional, që japin lëndë të përgjithshme, teori profesionale dhe praktikë profesionale si dhe 71 instruktorë të kurseve afatshkurtra. Mësuesit japin 1 deri në 4 lëndë dhe nuk ka gjithnjë një ndarje të qartë të llojit të lëndës që japin mësim. Pjesën më të madhe të kohës, lëndën janë të së njëjtës fushë, siç mbulon një mësues historinë, gjeografinë turistike dhe trashëgiminë kulturore, ose një mësues tjetër jep biologji dhe zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor, etj. Edhe pse të gjithë të anketuarit deklarojnë se kualifikimi i tyre përputhet (plotësisht ose pjesërisht) me lëndën që japin mësim, nëse hedhim një vështrim më nga afër të përgjigjeve për lëndët që japin do të shohim raste të mësuesve që japin edhe

²⁷ Mësuesit e praktikës profesionale shpesh quhen "instruktorë", por në këtë studim termi "instruktor" përdoret vetëm për personat që japin mësim në kurset afat shkurtër të trajnimit.


lëndët e praktikës së termo-hidraulikës dhe biologjinë, ose historinë dhe biologjinë. Kjo mund të jetë si rezultat i përdorimit me efikasitet (edhe pse jo efektive) të burimeve njerëzore për plotësuar ngarkesën minimale mësimore dhe për të mbuluar të gjithë kurrikulën.

Të dhënat demografike të burimeve njerëzore në AFP tregojnë se në shkollat e arsimit profesional pjesa më e madhe e mësuesve janë femra, ndërsa në qendrat e formimit profesional shumica e instruktorëve janë meshkuj. Kjo është si rezultat i faktit që femrat janë më të orientuar drejt arsimit të mesëm në këto vitet e fundit dhe preferojnë kualifikimin si mësues përkundër meshkujve që janë më të orientuar drejt industrisë. Edhe mosha e stafit akademik sa vjen e rritet, veçanërisht e vërtetë kjo për mësuesit dhe instruktorët e arsimit profesional. Më shumë se gjysma e mësuesve të lëndëve profesionale (teori dhe praktikë) dhe 41% e instruktorëve janë mbi 50 vjeç. Një pjesë e konsiderueshme e mësuesve janë pranë moshës së pensionit (21.4% e stafit akademik del në pension në vitin 2019 sipas të dhënave GIZ/ETF, 2014). Kjo gjë paraqet

problem, sepse perspektiva si mësues i arsimit profesional nuk i tërheq shumë të diplomuarit e rinj, pasi paga është shumë e ulët krahasuar me punët e tjera në industrinë përkatëse. Edhe pse mësuesit me përvojë të gjatë e konsiderojnë institucionin e tyre të arsimit profesional si punëdhënës për gjithë jetën, mësuesit e rinj janë më të prirur ta lënë punën dhe të kalojnë në sektorin e industrisë. Ky fenomen është veçanërisht i vërtetë për mësuesit e arsimit profesional në profilet e ndërtimit dhe TIK.

Profesioni i mësuesit është profesion i rregulluar dhe që të japësh mësim duhet të kesh të paktën diplomë universitare që është një kriter minimal për t'u punësuar në shkollat e arsimit profesional. Për instruktorët (dhe mësuesit e praktikës profesionale), kjo diplomë nuk është kusht i domosdoshëm, por i jepet përparësi përvojës profesionale. Në kampionin e pjesëmarrësve në vëzhgimin tonë, mbi 90% e mësuesve të arsimit profesional kanë të paktën një diplomë universitare në krahasim me 62% të instruktorëve të qendrave të formimit profesional.

Figura 26: Përvoja dhe kualifikimi i mësuesve dhe instruktorëve



Siç pritej, krahasimi i gjithanshëm të dhënave për stafin pedagogjik²⁸ të shkollave profesionale tregon një tendencë të mësuesve të lëndëve të arsimit të përgjithshëm për të shfaqur një nivel më të lartë arsimit, të pasuar nga ata të teorisë profesionale dhe mësuesve të praktikës profesionale dhe instruktorët e qendrave të formimit profesional në fund me vetëm 51% me diplomë universitare. Shpërndarja sipas nivelit të kualifikimit tregon se mes mësuesve ata që japin lëndët e përgjithshme janë në avantazh për kualifikimi zyrtar si mësues, ndërsa është për t'u theksuar fakti se 28% e mësuesve që japin teorinë profesionale nuk janë të diplomuar si mësues. Mësuesit e arsimit profesional dhe instruktorët kanë përfunduar arsimin e mesëm në pjesën më të madhe të rasteve.

Në lidhje me përvojën e punës, vëzhgimi tregon se mësuesit e arsimit profesional kanë përvojë të kufizuar në industri, ndërsa mësuesit e praktikës profesionale janë në avantazh në këtë drejtim. Duke qenë se ata kanë kaluar pjesën më të madhe të përvojës më të fundit të punës në institucion arsimor kjo gjë e kufizon mundësinë e tyre për të sjellë zhvillimet e reja të teknologjisë në ambientin e mësimin. Për më tepër, 69% e mësuesve që mbulojnë lëndët e teorisë profesionale dhe 60% e atyre që japin praktikën profesionale deklarojnë se nuk kanë marrë trajnim të përditësuar pranë subjekteve të biznesit dhe pjesa më e madhe e tyre (60% e mësuesve të teorisë profesionale dhe 69% e praktikës profesionale) deklarojnë se ky lloj trajnimi është i rëndësishëm deri në shumë i rëndësishëm për ta. Qendrat e formimit profesional kanë një avantazh në këtë drejtim duke qenë se vijnë kryesisht nga industria. Gjithsesi, ata rendisin "Mundësitë e mësuesve për trajnim të


vazhdueshëm" si aspektin më të nevojshëm për t'u përmirësuar.

Opinionin e nxënësve/kursantëve për mësuesit/instruktorët tregon se kursantët në përgjithësi janë të kënaqur me instruktorët, krahasuar me nxënësit në shkollat profesionale dhe vlerësojnë në mënyrë të veçantë aftësitë dhe njohuritë praktike për lëndën nga ana e instruktorëve. Kjo mund të jetë si rezultat i përvojës së instruktorëve në industri. Në arsim, nxënësit janë më të kënaqur me mësuesit e lëndëve të teorisë profesionale, komunikimin, etikën profesionale, aftësitë praktike dhe punën e pavarur me nxënësit. Kjo tregon se mësuesit e kualifikuar më mirë (siç janë mësuesit të lëndëve teorike) perceptohen nga nxënësit si mësues që punojnë më mirë. Gjithsesi, mësuesit e praktikës profesionale kanë avantazh në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. Këto gjetje duhet të hulumtohen edhe më tej, por mund të jetë si rezultat i kurrikulës, përfshirë programet kompjuterike në modulet e praktikës profesionale.

Nga një analizë më e thellë e profileve të sektorit tregohet se nxënësit e TIK-ut janë më pak të kënaqur se të tjerët në të gjitha dimensionet në lidhje me mësuesit, me përjashtim të etikës profesionale. Për nxënësit e TIK-ut, mësuesit e praktikës profesionale janë në një disavantazh mjaft të konsiderueshëm në krahasim me mësuesit e teorisë profesionale. I mbështetur nga gjetjet e mëparshme (GIZ/ETF, 2014) dhe në intervistat informatorëve kyçë, drejtimi profesional TIK "vuan" nga thithja e mësuesve të kualifikuar duke qenë se të diplomuarit në TIK ose profesionistët tërhiqen më shumë nga punët që paguhen mirë në industrinë ku u ofrohen më shumë mundësi për përparimin dhe zhvillimin krahasuar me institucionet e AFP-së. Profili TIK po tërheq nxënësit më të mirë të AFP (me notë mesatare më të lartë) dhe mes


28 Ky krahasim duhet të interpretohet në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në pjesë të ndryshme të kurrikulës dhe jo si kategoritë e mësuesve.

Figura 27: Opinioni nxënësve dhe kursantëve për stafin akademik



të diplomuarve më të mirë nga shkolla e detyrueshme, që kanë nevojë për mësues të kualifikuar, të përditësuar rregullisht dhe të aftë për t'iu përgjigjur pritshmërive të tyre (të nxënësve). Po ashtu, nga intervista me të diplomuarit të këtij profili u deklaruan pakënaqësinë e tyre me mësuesit që kishin.


Figura 28: Opinioni i nxënësve sipas sektorëve për stafin pedagogjik



Nxënësit e tekstilit janë në përgjithësi më të kënaqur me mësuesit e tyre të lëndëve profesionale, në krahasim me moshatarët e tyre në profilet e tjera. Mësuesit e praktikës së tekstilit janë në avantazh për aftësitë e komunikimit, duke përdorur teknologjinë, etikën profesionale, aftësitë praktike dhe punën e pavarur me nxënësit. Mësuesit e praktikës së tekstilit po përdorin programe të kompjuterizuara në mësimdhënie si CAD/

mësuesit patën trajnim fillestar në pedagogji, ku mësuesit e lëndëve të përgjithshme janë në avantazh. Mësuesit deklarojnë se kanë marrë trajnim për metodat e mësimdhënies, veçanërisht duke përdorur metodat TIK dhe ato të mësimdhënies interaktive. Instruktorët janë më pak të trajnuar se mësuesit, sidomos në mësimdhënien me mjetet TIK. Mungesa e trajnimit para shërbimit në AFP nxiti Programin AFP të GIZ të ofronte një cikël

Figura 29. Trajnimet e stafit akademik



CAM. Bazuar në analizën e sektorit të tekstilit të parashikuar për këtë hulumtim, në kuadër të projektit të financuar nga USAID "Rritje Albania" (2013), Departamenti i Tekstilit dhe Modës në Universitetin Politeknik të Tiranës hartoi programe të përshtatura për kurset të Dizajnit CAD/CAM për prodhimin e veshjeve, ku disa mësues të shkollave të arsimit profesional e përfunduan me sukses atë.


5.3. Metodatat e mësimdhënies

Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se jo të gjithë

të testuar tashmë trajnimesh për mësuesit e trajnimit profesional, pas përfundimit të ciklit të trajnimit të trajnerëve. Kjo nismë mund të përhapet me lehtësi në zona të tjera të vendit.

Si nxënësit ashtu edhe mësuesit u pyetën për metodatat e mësimdhënies dhe të kontrollit të rezultateve të të mësuarit që përdoren në AFP. Nxënësit/kursantët deklarojnë se në mjediset e të mësuarit përdoren më shpesh metodatat jo interaktive, ndërsa 84% e mësuesve dhe 95% e instruktorëve deklarojnë se diskutimet e hapura dhe demonstrimet me shembuj praktikë janë metodatat që përdoren më shpesh. Folës

Figura 30: Metodatat e mësimdhënies




të ftuar nga sektori privat është formë që përdoret më pak gjë që u kufizon nxënësve mundësinë e zgjerimit dhe përditësimit të njohuritë dhe aftësive të tyre dhe që tregon për izolimin e institucioneve AFP dhe nivelit të ulët të rrjetëzimit. Qendrat e arsimit profesional duken më aktive në këtë drejtim, sepse rreth 40% e instruktorëve deklarojnë se i përdorin shpesh ose shumë shpesh folësit e ftuar në krahasim me 20% të mësuesve. Kjo metodë përdoret më shpesh në drejtimet profesionale të tekstilit, turizmit dhe ndërtimit. Nxënësit në profilin e tekstilit deklarojnë një mjedis më të hapur dhe bashkëpunuese mësimor përmes pyetjeve dhe përgjigjeve dhe diskutimeve të hapura.

Mësuesit në përgjithësi të deklarojnë se aplikojnë më shpesh metoda të ndryshme të mësimdhënies, në krahasim me instruktorët e qendrave të formimit profesional, por kursantët, në krahasim me nxënësit, deklarojnë të kundërtën. Këto rezultate duhet të shtellohen më tej, por pritet që ato të jenë të ndikuar nga profilet e ndryshme të kursantëve (më pak të arsimuar dhe në moshë mesatare më të madhe).

Përgjigjet e nxënësve/kursantëve si dhe të mësuesve/instruktorëve tregojnë për një përdorim të shpeshtë të metodave të kontrollit të rezultateve të të mësuarit, sidomos në arsimin profesional. Sipas nxënësve, metoda që përdoret më shpesh janë testet me shkrim (70%), e ndjekur nga detyrat e shtëpisë (67%) dhe detyrat e projektit (66%), ndërkohë që mësuesit dhe instruktorët deklarojnë se përdorimi më shpesh metoda të tilla si puna në grup (74% dhe 94% përkatësit) dhe detyrat e pavarura të nxënësve (75% dhe 89% respektivisht). Edhe kursantët e qendrave të formimit profesional deklarojnë se përdoren më shpesh këto dy metoda (89% dhe 83%). Detyrat e projektit përdoren kryesisht në profilet e lidhura me sektorët e turizmit dhe të ndërtimit, të njëjtën gjë për demonstrimet dhe shembuj praktikë e punën në grup. Mësuesit dhe instruktorët konsiderojnë të mësuarit në grupe të vogla dhe detyrat e projektit si metodat më efektive të mësimdhënies.

Duket se në arsim ka një nivel më të lartë përdorimi të metodave të ndryshme të

Figura 31: Metodatat e kontrollit të rezultateve



mësimdhënies dhe të kontrollit të njohurive në krahasim me formimin profesional. Programet e edukimit profesional zgjasin më shumë dhe kanë një larmi më të madhe lëndësh dhe mësuesish, në krahasim me kurset afatshkurtra, të cilat jepen nga instruktori përkatës. Për më tepër, mësuesit e arsimit profesional kanë një kualifikim të lartë pedagogjik krahasuar me instruktorët e formimit profesional.


5.4. Materialet e mësimdhënies

Mësuesit u pyetën nëse e kanë të lehtë të sigurojnë materiale mësimore dhe “as të lehtë as të vështirë” ishte opsioni më i zgjedhur, me 39% e mësuesve, ndërsa për rreth 25% të mësimdhënësve është e vështirë apo shumë e vështirë të sigurohen materialet mësimore. Mësuesit dhe instruktorët raportuan se përdorin një larmi burimesh për të siguruar materiale mësimore. Mësuesit e arsimit profesional po përdorin më shumë materialet nga AKAFP, duke nxjerrë rregullisht kornizat e programeve dhe udhëzimeve për t'i hartuar

ato si duke mbështetur materialet mësimore. AKAFP përdoret më pak nga instruktorët. Siç u tha edhe më sipër, hatimi i kurrikulës së formimit profesional iu caktua AKAFP-it si një funksion në kuadër të kalimit të përgjegjësisë AFP tek MMSR.

Mësuesit e arsimit të përgjithshëm kanë shkallë më të lartë të përdorimit të teksteve, duke qenë se teksti është materiali kryesor mësimor që përdorin. Ata përfitojnë nga mundësia për të përdorur tekste të arsimit të përgjithshme, veçanërisht në lëndët e vitit të parë programi i të cilëve është i krahasueshëm me gjimnazin. Krahasuar me mësuesit e lëndëve teorike, mësuesit e lëndëve profesionale i përdorin më pak tekstet. Në parim, tekstet nga shtëpia botuese zyrtare (BOTEM) dalin sipas parimit të ekonomisë së shkallës. Ka shumë gjasa që librat të mos botohen, nëse regjistrimi në profilin përkatës profesional është i ulët. Kjo vlen më shumë për lëndët teorike. Për më tepër, mësuesit e lëndëve profesionale inkurajohen të hartojnë vetë materialet mësimore për të siguruar përditësimin e vazhdueshëm me teknologjinë më të fundit dhe përshtatjen me

Figura 32: Materialet e mësimdhënies




nevojat e nxënësve të programit mësimor të hartuar. Duke pasur parasysh nivelin e ulët të kualifikimit dhe nevojën e lartë për trajnim të mësuesve të AFP-së që mbulojnë praktikën profesionale, aftësia e tyre për hartimin e materialeve mësimore është e diskutueshme dhe ka nevojë të trajtohet me kujdes.

Literatura e huaj dhe materialet mësimore nga homologët e tyre janë burimet më pak të përdorura, gjë që tregon për një nivel të përgjithshëm të ulët të përditësimit të mësuesve. Kjo mund të jetë si rezultat i mungesës së njohurive të gjuhëve të huaja (47% e mësuesve dhe 56% e mësuesve nuk kanë njohuri ose nuk kuptojnë apo flasin shumë pak anglisht) dhe i mungesës së rrjetëzimeve mes kolegëve në institucionet e ndryshme. Mes mësuesve të arsimit profesional, ata të lëndëve teorike duket se kanë një akses më të mirë dhe të larmishëm tek materialet mësimore në krahasim me mësuesit e praktikës profesionale. Instruktorët e formimit profesional përdorin kryesisht leksionet që kanë përgatitur vetë dhe kanë nivelin më të lartë të përdorimit të materialeve nga interneti.

Sipas përgjigjeve të nxënësve dhe kursantëve, shënimet dhe tekstet janë materialet më të përdorura për mësim, të ndjekur nga fotokopjet e sugjeruara nga mësuesi ose instruktori, dhe materialet nga interneti. Për kursantët, shënimet që jepen nga mësuesi janë materiali kryesor i të mësuarit, gjë që mbështetet edhe nga përgjigjet e instruktorëve duke nënkuptuar materialet e përgatitura nga vetë ata si burimin kryesor të materialeve mësimore.

Analiza ndërsektoriale tregon se nxënësit e profilimit TIK kanë një normë më të lartë përdorimi të materialeve nga interneti, sugjeruar kryesisht nga mësuesit dhe normën më të ulët të përdorimit të teksteve shkollore. Nuk ka kurrikula dhe tekste të reja dhe mësuesit përfitojnë nga materialet që gjenden në internet. E kundërta është e vërtetë për profilet e lidhura me ndërtimin, ku nxënësit përdorin kryesisht tekstet shkollore dhe shumë pak materiale nga interneti. Kjo ndodh për shkak të regjistrimit të lartë të nxënësve në profile profesionale që lidhen me industrinë e ndërtimit, sidomos termohidraulikën dhe elektro-teknikën. Për më tepër, këto drejtime profesionale mbështeten

Figura 33: Materialet e mësimnxënies



nga projektet ndërkombëtare, përfshirë këtu zhvillimin e materialeve mësimore. Nxënësit e profilin të tekstilit përdorin tekstet shkollore si materialin kryesor të mësimit, ndërsa nxënësit e turizmit përdorin shënime që jep mësuesi.

5.5. Infrastruktura e të mësuarit

Infrastruktura AFP është një nga problemet më të mëdha në sistemin publik të AFP-së duke qenë se pjesa më e madhe e ofruesve nuk ofrojnë materialet dhe pajisjet e nevojshme për të ofruar programe cilësore të arsimit dhe formimit profesional. Sistemi është i keqfinancuar dhe për shumë vjet varet kryesisht nga donatorët, ndaj edhe pjesa më e madhe e rindërtimeve dhe instalimit të pajisjeve të mëdha në shkolla kanë të ardhur si rezultat i ndihmës së huaj ndërkombëtare, nganjëherë të lidhur sipas sektorëve, si termo-hidraulika nga Programi AlbVET (SDC), shkollat ekonomike nga projekti ALBiz (KulturKontakt / ADA), mbështetja rajonale AFP (Program i arsimit profesional për verilindjen nga GIZ), ose

vetë donatori direkt (si në rastet e shkollës Beqir Çela, QMF Kamza nga qeveria zvicerane dhe gjermane, respektivisht). Përmes programeve IPA 2008 dhe 2011, BE ka mbështetur ndërtimin e 8 qendrave të formimit profesional që mbulojnë pothuajse të gjithë sektorët. Në bazë të marrëveshjes, qeveria shqiptare ishte përgjegjëse për sigurimin e pajisjeve dhe mobilimin e këtyre qendrave. Në përgjithësi, këtyre shkollave të rindërtuara/sapo ndërtuara u mungojnë specifikimet e një ndërtese të arsimit profesional, sepse nuk kanë hapësirë për bazën prodhuese (GIZ / ETF, 2014). Fondet mbështetëse të buxhetit IPA II (2015) do të përdoren për përmirësimin e rrjetit të racionalizuar të këtyre institucioneve dhe MMSR aktualisht po bën identifikimin e nevojave për të hartuar fishat e projekteve.

Kur nxënësve, kursantëve, mësuesve dhe instruktorëve iu kërkua të identifikonin nevojën për përmirësime për një sërë faktorësh që lidhen me arsimin dhe formimin profesional, të gjithë të anketuarit evidentuan pajisjet dhe mjetet e përdorura për praktikën profesionale si ndërhyrjen më të nevojshme. Si prioritet i lartë u cilësuan edhe dimensionet

të tjera të lidhura me infrastrukturën. Kur krahasojmë arsimin me trajnimin në lidhje me nevojën për përmirësimin e infrastrukturës, ky studim konfirmon studimet/vlerësimet e mëparshme: që infrastruktura e qendrave të formimit profesional është më e mirë se ajo e shkollave profesionale. Sipas mësuesve, baza prodhuese dhe kushtet laboratorike kanë nevojë për përmirësim. Nxënësit që shpenzojnë kohë të konsiderueshme në mjediset e shkollës së përzgjedhur mund të identifikojnë nevojën e përmirësimit edhe të laboratorëve dhe klasave.


Një krahasim mes sektorëve ekonomikë lidhur me programet e arsimit tregon se kushtet infrastrukturore janë më problematike në profilin e tekstilit, për të gjitha dimensionet përkatëse, ndjekur nga hoteleri-turizmi (në nivel mesatar). Analiza e sektorit ekonomik nxori në pah rëndësinë

handikap pasqyrohet në besueshmërinë e programeve që ofrojnë.

Donatorët ndërkombëtarë kanë ofruar mbështetje të konsiderueshme në infrastrukturën e profileve të tjera që janë të orientuara më shumë drejt industrisë, të tillë si ndërtimi. Në analizën e detajuar të infrastrukturës së arsimit profesional në shkollat e ndërtimit në raportin e sektorit përkatës u identifikua se lënda profesionale e termo-hidraulikës është e pozicionuar më mirë në drejtim të pajisjeve, por ende vuan nga mungesa e materialeve të konsumit.

Për sektorin e turizmit, baza materiale, numri i nxënësve për klasë dhe i laboratorëve duket se janë më problematike. Në intervistat me drejtorët e shkollave të hoteleri-turizmit u deklarua se ata e kanë shumë të vështirë të ofrojnë module praktike që lidhen

Figura 34: Nevoja për përmirësime në infrastrukturë



e infrastrukturës të AFP-së në ofertën për arsim e formim profesional në profilin e tekstilit. Për ato institucione që kanë pasur mangësi të theksuara të burimeve për shumë vite në drejtim të pajisjeve, ky

me shërbimin e ushqimit duke qenë se shkollat nuk janë në gjendje të ofrojnë në kohë përbërësit e nevojshëm për shkak të procedurave të centralizuara të menaxhimit

financiar. Regjistrimi është rritur si rezultat i propagandës së qeverisë dhe shkollave si dhe i mundësive të mëdha për punësim në sektorin e turizmit, por akomodimin i këtyre nxënësve në të njëjtën infrastrukturën shkollore është duke shkaktuar humbje në cilësi.

5.6. Administrimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional

Institucionet e arsimit dhe formimit profesional funksionojnë nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë apo institucioneve të varësi të saj. Niveli i autonomisë është kryesisht i ulët, por ndryshon sipas institucioneve të ndryshme. MMSR është përgjegjëse për planin financiar, burimet njerëzore, dhe planin shkollor të rrjetit të AFP-së. Shërbimi Kombëtar i Punësimit prej shumë vitesh është përgjegjës për menaxhimin e rrjetit të qendrave të formimit profesional (QFP), ndërsa për shkollat profesionale, që më parë ishin nën varësinë e MASH-it, ky funksion mbulohet tashmë drejtpërdrejt nga Drejtoria e AFP-së pranë MMSR-së. QFP janë më të pavarur dhe me më shumë përvojë në menaxhimin e institucioneve. Shkollat profesionale vuajnë ende pasojat e centralizimit në MASH. Siç evidentohet edhe nga studimi i GIZ/ETF (2014), shkollat më të mëdha me një traditë dhe histori, kryesisht ato që kanë pasur status shkollë kombëtare, që gëzonte një nivel të caktuar më të lartë autonomie dhe të ndihmuar nga aktorët ndërkombëtarë, kanë një strukturë tepër të mirë funksionale si dhe kapacitete. Vizioni i MMSR, siç shprehet nga vetë Ministri, është të ndërtohet një rrjet shkollash ekselence të arsimit profesional që gëzojnë një nivel më të lartë autonomie dhe ofrojnë një portofol të gjerë profilesh të arsimit profesional dhe kurse trajnimi. Gjithsesi, statusi aktual i këtyre shkollave

paraqet sfida të mëdha në këtë proces të reformës në arsimin profesional. Mësuesit deklarojnë se autonomia dhe menaxhimi i institucioneve të AFP kanë nevojë të përmirësohen (përkatësisht 39% dhe 35% e mësuesve).

Për sa i përket autonomisë financiare, sistemi i financimit publik i AFP është i centralizuar në nivel ministrie, që është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit bazuar në nevojat e identifikuar. Ofruesit e arsimit profesional kanë funksioneve të kufizuara të deleguara, kryesisht në ekzekutimin e buxhetit për pagat e personelit dhe shpenzimet operative. Që nga janari i vitit 2015, të gjithë institucionet AFP e kanë tashmë këtë autonomi dhe ato kanë caktuar specialist finance për të mbuluar këtë detyrë. Investimet kapitale janë zakonisht nën autoritetin e MMSR-së. Menaxhimi shumë i centralizuar financiar dhe sistemi i keqfinancuar krijojnë shpesh vështirësi në lëvrimin e fondeve gjë që pengon zhvillimin normal të aktivitetit mësimor. Të ardhurat e krijuara nga ofruesit e AFP-së, siç lejohet me ligj, mund të jenë zgjidhje e pjesshme e këtij problemi. Megjithatë, sipas legjislacionit ekzistues, ka edhe paqartësi si për të gjeneruar të ardhura ashtu edhe për t'i përdorur ato për shkak të mundësive të kufizuara (Dibra, 2015).

Ofruesit AFP kanë autoritet të kufizuar për menaxhimin e burimeve njerëzore. MMSR miraton në fillim të çdo viti shkollor numrin e përgjithshëm të punonjësve të personelit akademik dhe administrativ. Rekrutimi i punonjësve, ngarkesa e punës, zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe kompensimi janë çështje që rregullohen sipas kuadrit ligjor në fuqi. Institucionet AFP mund të zgjedhin stafin e tyre në bazë të procedurave të hapura të plotësimit të vendit të punës dhe vendimit të komisionit të përzgjedhjes (me përfaqësues të vetë institucionit AFP dhe komunitetit vendor). Shkollat duhet të hartojnë planin e zhvillimit të kapaciteteve,

edhe pse për shkak të burimeve të kufizuara kjo gjë kufizohet kryesisht në zhvillimin e brendshëm duke përdorur përqasjen e të mësuarit nga njëri-tjetri mes kolegëve. Programi AFP i GIZ po ndihmon AKAFP-në dhe MMSR-në të trajtojë këtë çështje dhe të hartojë planin për një tranzicion të butë të përgjegjësisë dhe aktiviteteve të mëposhme (GIZ, 2016).

Shkollat e arsimit profesional dhe qendrat e formimit profesional kanë nivele të ndryshme të autonomisë akademike. Në arsimin profesional, mësuesit e lëndëve profesionale janë të lirë të hartojnë vetë kurrikulën e kornizës kombëtare. Më pas drejtori i shkollës e miraton këtë plan mësimor. Megjithatë, shkollat nuk gëzojnë autonomi për të ofruar programe shtesë arsimimi apo kurse afatshkurtra për palë të treta, edhe pse është bërë kërkesë dhe treguar gatishmëria treguar disa herë nga ana e drejtuesve të shkollave. Siç u përmend më sipër, vetëm Qendra Multi-Funksionale e Kamzës ofron kurse afatshkurtra, pasi ka një status të veçantë. Drafti i ri i AFP Ligji e parashikon këtë mundësi për të gjithë ofruesit e tjerë të AFP sapo ata të kenë gjetur burimet e fondeve për të mbuluar kostot.

Drejtori është figura kryesore e administrimit të institucionit të arsimit dhe formimit profesional, i ndihmuar nga zv. drejtori (përgjegjësi për materialet e kursit në QFP), sekretarja – nëse numri i nxënësve në shkollën e arsimit profesional është i lartë dhe një financiar. Stafi pedagogjik organizohet sipas departamenteve lëndore. Çdo shkollë profesionale ka këshillin pedagogjik dhe këshillin e prindërve.

Ofruesit e AFP-së, veçanërisht shkollat, funksionojnë më së shumti si institucione të izoluara dhe rrjetëzimi i tyre me aktorët lokalë dhe ofrues të tjerë është mjaft i ulët. Organet apo pozicionet e punës që mund

të krijojnë lidhje mes ofruesit AFP dhe aktorëve të jashtëm si dhe të performancës dhe kufizimeve që lidhen me to janë si më poshtë:

- (i) Bordi i institucionit arsimor, i kryesuar nga një përfaqësues i biznesit, me anëtarë aktorë vendorë (Drejtorja Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore, këshilli i qarkut, zyra vendore e punësimit, organizata të nxënësve/kursantëve, mësuesve dhe punonjësve të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional). Ky organ (sipas kuadrit ligjor) është përgjegjës për miratimin e planit strategjik, të burimeve njerëzore dhe të planit financiar të ofruesit të AFP-së; për të ofruar këshilla në lidhje me veprimtarinë e gjenerimit të të ardhurave; dhe për të nxitur bashkëpunimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ky organ i rëndësishëm është kryesisht formal dhe jo funksionale.
- (ii) Drejtori i institucionit AFP, si përfaqësues i institucionit, luan funksionin e krijimit të lidhjeve dhe rrjetëzimit. Analiza e fundit për kapacitetet menaxheriale të ofruesve të AFP-së (GIZ/Dibrës, 2015) nxori në pah se kapaciteteve institucionale dhe menaxheriale të stafit kanë nevojë të përmirësohen për të mundësuar funksionimin e rrjeteve.
- (iii) PASO (koordinatori i shkollës për marrëdhëniet me partnerët socialë) u prezantua nga projekti AIBiz në të

gjitha shkollat e mbështetura nga ky projekt, si personi përgjegjës për marrëdhëniet e shkollës me bizneset. Ky pozicion mbulohet kryesisht nga mësuesi i lëndëve profesionale i trajnuar për këtë detyrë dhe me një ngarkesë javore mësimore të reduktuar, sipas udhëzimit përkatës të ministrit. Të dhënat e anketës tregojnë se 36% e mësuesve u janë caktuar detyra të ngjashme me PASO-n por vetëm 7% e tyre kanë ngarkesë mësimore të reduktuar për të mundësuar realizimin e kësaj detyre.

Në nivel ofruesi (shkolle) nuk ka struktura që të mundësojnë këshillimin për orientimin profesional dhe karrierën apo këshillimin për punësim.

Pjesa 6. Metodat TIK të të mësuarit në sistemin AFP

Në këtë pjesë shqyrtohen të dhënat e vëzhgimit në lidhje me mundësinë e përdorimit (aksesin) tek infrastruktura që mbështet procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies me anë të teknologjisë, tendencat në përdorimin e përgjithshëm të teknologjisë në mjedisin shkollor dhe përfitimet dhe sfidat e perceptuara nga të anketuarit për aplikimin e dixhitalizimit dhe të mësuarit të përzier në AFP.²⁹

Aksesi në teknologji


Nxënësve dhe kursantëve iu kërkua të vlerësonin mundësinë për të përdorur një sërë pajisjesh teknologjike (të lidhura ose jo me internetin) si në shtëpi ashtu edhe mjediset shkollore.³⁰

Të dhënat konfirmojnë praninë e një aksesi e çekuilibruar tek pajisjet teknologjike - ku shtëpia është mjedisi më i zakonshëm për përdorimin e teknologjisë nga nxënësit krahasuar me shkollat. Nxënësit raportojnë se kompjuterët (78,26%), ndjekur nga laptopët (69,71%) mund të jenë të aksesueshëm “lehtë ose shumë lehtë” për shumicën dërrmuese të familjeve të tyre. Për më tepër, mund të vihet re fare lehtë rritja e përdorimit të pajisjeve celulare (përfshirë këtu tableta) mes nxënësve dhe familjeve të tyre; 58,63% e nxënësve thonë se kanë mundësi “të lehta ose shumë të lehta” përdorimi të tabletave në shtëpitë e

29 Shih Shtojcën 1 për një pamje të përgjithshme të infrastrukturës TIK në AFP në Shqipëri


30 Në pyetësorët për nxënësit dhe kursantët jepej pyetja e mëposhtme: “A ke mundësi të përdorësh pajisjet dhe shërbimet e mëposhtme?”

Figura 35. Përdorimi i mjeteve të teknologjisë (%)



Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.

Figura 36. Përdorimi i kompjuterëve në të gjithë sektorët (%).



Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.

tyre. Nga ana tjetër, vetëm 38,58% e tyre raportojnë mundësinë e aksesimit të lehtë të kompjuterëve në shkollë, e ndjekur nga nivele teje të ulëta të mundësisë për përdorimin e tabletave (16.38%) dhe laptopëve (15.37%), në përputhje me rrethanat.

Kjo mospërputhje mes mjedisit të shkollës dhe shtëpisë vihet re edhe tek popullata

e kursantëve. Mundësia e përdorimit të kompjuterit në qendrat e formimit profesional (32.86%) është shumë më e ulët krahasuar me mjedisin në shtëpitë e kursantëve (79.45%).

Zbërthimi i të dhënave për mundësinë e përdorimit të teknologjisë në të katër sektorët me interes konfirmon tendencën e

përgjithshme të aksesit të çekuilibruar tek teknologjia mes mjedisit shkollës dhe atij të shtëpisë. Edhe këtu, kjo mospërputhje teknologjike priret të jetë më pak e theksuar tek nxënësit në sektorin e Turizmit dhe atë të TIK-ut, me diferencë tek mundësitë për të aksesuar pajisjet kompjuterike.³¹ Nga ana tjetër, në sektorin e ndërtimit, mundësia e përdorimit të kompjuterit priret të jetë shumë më e ulët si në shtëpi ashtu edhe në shkollë; vetëm 2 në dhjetë nxënës të anketuar në sektorin e ndërtimit (22.87%) raportojnë të kenë akses “të lehtë ose shumë të lehtë” tek kompjuterët në shkollë, në krahasim me 63.74% e atyre që e kanë në shtëpi. Shih Figurën 36 për një pamje grafike të aksesit tek kompjuterët në të gjithë sektorët.

Për sa i përket aksesit në një larmi më të madhe pajisjesh teknologjike, nxënësit e sektorit të tekstilit kanë më shumë gjasa të raportojnë se kanë më shumë mundësi të përdorin pajisjet teknologjike në shtëpi (80.07% që raportojnë se kanë akses “të


lehtë ose shumë të lehtë” tek kompjuterët, 74.46% tek laptopët, dhe, 71.43% tek tabletat), pasuar nga nxënësit në sektorin TIK (84.96% që raportojnë se kanë akses “të lehtë ose shumë të lehtë” tek kompjuterët, 70.03% tek laptopët, dhe, 51.51% tek tabletat).

Megjithatë, gjetjet e vëzhgimit nxjerrin në pah se kompjuterët vazhdojnë të jenë më mbizotëruesit si në shtëpi ashtu edhe në mjedisin shkollor, të ndjekur nga laptopët dhe tabletat. Megjithatë, në mjedisin shkollor, nxënësit në sektorin e tekstilit raportojnë se kanë akses më të lehtë tek tabletat (37.1%) sesa tek laptopët (34.45%); e njëjta gjë raportohet edhe nga nxënësit e sektorit TIK (15.19% krahasuar me 8.55%).

Përdorimi në përgjithësi i teknologjisë

Vëzhgimi ofron të dhëna për prirjet në përdorimin e përgjithshëm të teknologjisë

Figura 37. Përdorimi në përgjithësi i teknologjisë (%);



Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.

31 Mospërputhja e shifrave llogaritet si diferencë pikë përqindjeje mes aksesit të lehtë në shtëpi dhe aksesit të lehtë në shkollë. Aksesueshmëria e lehtë i referohet shkallës së raportuar nga nxënësit në 4 dhe 5 të shkallës 5-pikëshe Likert për pyetjen përkatëse në këtë vëzhgim.

duke i pyetur nxënësit/kursantët dhe mësuesit/instruktorët sa shpesh përdorin mjediset, pajisjet dhe shërbimet TIK.³²


Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se në përgjithësi nxënësit janë bërë tejet të lidhur me teknologjinë duke përdorur rregullisht telefonat e tyre inteligjentë, rrjetet sociale në internet dhe aplikacionet e komunikimit në jetën e tyre të përditshme. Për shembull, 71.92% e nxënësve pranojnë se e përdorin telefonin e tyre “rregullisht ose pothuajse gjithmonë”. Po ashtu, pothuajse 6 në 10 prej tyre (60.27%) raportojnë për një përdorim të rregullt të internetit, ndjekur nga më shumë se gjysma e nxënësve (52.74%) që përdorin rrjetet sociale. Si për kontrast, duket se përdorimi i postës elektronike (email) mbetet prapa tek nxënësit; vetëm 39.84% e tyre përdorin postën elektronike rregullisht.

Kjo tendencë e përgjithshme në rritje për sa i përket përdorimit të teknologjisë mund të shihet edhe te kampioni i kursantëve. Për më

tepër, të dhënat nga vëzhgimi sugjerojnë se kursantët duken si përdorues më të rregullt të internetit (62%) dhe të rrjeteve sociale (62%) sesa nxënësit (60.27% dhe 52.47% përkatësisht). Përkundrazi 44.47% e tyre raportojnë se përdorin postën elektronike “rregullisht ose pothuajse gjithmonë”.

Në krahasim me popullatën e mësuesve, nxënësit ia kalojnë atyre për përdorimin e shpeshtë të telefonave inteligjentë (71.92% e nxënësve krahasuar me 54.06% e mësuesve) dhe të rrjeteve sociale (54.47% e nxënësve krahasuar me 45.7% e mësuesve). Nga ana e tyre, mësuesit raportojnë të përdorin më shpesh internetin (60.27% e nxënësve krahasuar me 86.23% e mësuesve) dhe të postës elektronike (39.84% e nxënësve krahasuar me 72.02% e mësuesve). Për më shumë hollësi, referojini figurës 37.³³ Nga ana tjetër, edhe instruktorët ia kalojnë kursantëve të tyre për përdorimin e shpeshtë të internetit (74.6% e instruktorëve përkundër 62%

Figura 38. Përdorimi i përgjithshëm i teknologjisë tek të gjithë sektorët (%)



Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.

32 Në këtë vëzhgim, nxënësit dhe kursantët u pyetën: 'Sa shpesh i përdorni të mëposhtmet?'

33 Në vëzhgimin e mësuesve bëhet kjo pyetje: 'Në përgjithësi sa shpesh përdorni pajisjet dhe shërbimet e mëposhtme?'

e kursantëve) dhe të postës elektronike (67.74% e instruktorëve përkundër 44.74% e kursantëve).


Një vështirësi nga afër në të gjithë sektorët tregon se nxënësit në profilin e ndërtimit kanë tendencë të jenë më pak të lidhur me teknologjinë në krahasim me sektorët e tjerë. Për shembull, edhe pse interneti përdoret rregullisht dhe në masë të madhe nga pothuajse shumica e nxënësve në sektorët e tjerë (duke u luhatur nga 73.22% në 85.65%), vetëm më pak se gjysma e nxënësve (49,26%) raportojnë të përdorin "shpesh ose pothuajse gjithmonë" internetin në sektorin e ndërtimit. Në lidhje me përdorimin e pajisjeve apo mjete të tjera, përdorimi i telefonave inteligjentë është më i madh mes nxënësve në sektorin e turizmit (79,81%), ndërsa faqet e rrjeteve sociale (67,92%) dhe adresa e-mail (58,98%) përdoren më shpesh nga nxënësit në sektorin e tekstit.

Kur, nga ana tjetër, nxënësit u pyetën për besimin dhe lehtësinë e të mësuarit të përdorimit të pajisjeve të reja elektronike dhe programeve të instaluar, gjetjet priren

të pasqyrojnë përdorimin aktual të raportuar të mjeteve, mjediseve dhe shërbimeve TIK. P.sh., Për shembull, nxënësit në TIK (76,73%) dhe sektorin e tekstit (71,83%) priren të shfaqin një besim më të madh për të mësuar përdorimin e pajisjeve të reja sesa popullata mesatare e nxënësve (65,14%). Në anën tjetër të spektrit, besimi dhe lehtësia bie në 45.86% tek nxënësit e ndërtimit; 1 në 4 nxënës në sektorin e ndërtimit thotë se nuk është e lehtë për ta të mësojnë të përdorin pajisjet elektronike dhe programe të reja të instaluar. Për më shumë shih Figurën 39.

Për krahasim, kursantët në tërësi (48.1%) mendojnë se kanë më pak besim dhe lehtësi se nxënësit (65.14%). Për më tepër, shumica e mësuesve (66,83%) dhe e instruktorëve (77,08%) duket se raportojnë edhe më shumë besim dhe lehtësi në krahasim me nxënësin mesatar (65,14%) apo popullatën e kursantëve (48.1%), respektivisht. Analiza relacionale paraqet një korrelacion domethënës ndërmjet besimit të perceptuar të mësuesve për të mësuar përdorimin e pajisjeve të reja elektronike dhe programet e instaluar dhe nivelin e tyre

Figura 39. E kam të lehtë të mësoj të përdor pajisjet elektronike dhe programet standard të instaluar




të njohurive kompjuterike: sa më të mëdha të jenë njohuritë e raportuara të mësuesve për kompjuterin, aq më të sigurt prirën të jenë ata për të mësuar përdorimin e pajisjeve të reja.

Përdorimi i teknologjisë për qëllime të mësimnxënies/mësimdhënies

studimi është mjaft i zakonshëm mes nxënësve në AFP; raportohet se përdoret nga $\frac{3}{4}$ e nxënësve (74,75%) në shkollat profesionale dhe 63.41% e kursantëve në qendrat profesionale. Variacioni në të gjithë sektorët tregon se nxënësit në TIK (88,39%), siç pritej, kanë më shumë gjasa të përdorin internetin për të studiuar, ndjekur nga nxënësit në sektorin e turizmit (76,61%). Po ashtu, nxënësit në sektorin e ndërtimit prirën

Figura 40. Përdorimi i internetit nga nxënësit për studim në të gjithë sektorët (%)



Vëzhgimi ofron të dhëna për tendencat aktuale të përdorimit të teknologjisë për qëllime të mësimnxënies/mësimdhënies duke iu kërkuar nxënësve/mësuesve të thonë nëse e përdorin internetin për të studiuar apo për të përgatitur materialet mësimore, sa shpesh dhe ku e përdorin, dhe nëse përdorin programe kompjuteri që lidhen specifikisht me profilin e tyre profesional.³⁴

Së pari, gjetjet tregojnë se, në përgjithësi, përdorimi i faqeve të internetit për qëllime


të përdorin internetin në një masë më të vogël. Vetëm 62,89% e nxënësve të sektorit të ndërtimit raportojnë se përdorin faqet e internetit për qëllime studimore në krahasim me mesataren e nxënësve prej 74.75%.

Së dyti, interneti përdoret më shpesh nga nxënësit për të punuar për detyrat e tyre³⁵ (54.8%) dhe për të komunikuar në mënyrë elektronike me mësuesit apo nxënësit e tjerë (53,96%). Kursantët kanë të njëjtën prirje si me popullatën e nxënësve; 42.86% e tyre shpesh përdorin internetin për detyra, si dhe një pjesë pothuajse e njëjtë (41.18%)

34 Në vëzhgim bëhen këto pyetje: "A përdorni faqe Interneti për të studiuar apo përgatitur materiale mësimore?", "Sa e përdor internetin për të mësuar" dhe "A përdor programe kompjuterike specifike për profilin tënd profesional?"

35 Detyrat këtu i referohen detyrave të shtëpisë.

Figura 41. Shpeshësia e përdorimit të internetit për të studiuar në të gjithë sektorët (%)




Shënim: Përqindja e nxënësve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert.

e përdor atë për komunikim me instruktorët ose kursantët e tjerë.

Zbërthimin sipas sektorëve sugjeron se nxënësit në turizëm (58,66%), ndjekur nga nxënësit në TIK (55,95%), kanë më shumë gjasa të përdorin internetin për të punuar më detyrat e tyre se popullsia mesatare e nxënësve.

Së treti, përdorimi i faqeve të internetit për qëllime studimi shfrytëzohet thuajse në mjedisin e klasës apo laboratorët përkatëse. Mesatarisht, vetëm gati 2 në 10 nxënës (21.88%) e përdorin internetin "shpesh ose pothuajse gjithmonë" në mjedisin e klasës, ndërsa 26,85% e tyre e përdorin atë në laborator. Siç pritej, interneti në klasë dhe laborator përdoret më së shpeshti nga

Figura 42. Përdorimi nga mësuesit i faqeve të internetit për të studiuar ose përgatitur materialet mësimore (%)




nxënësit e profilit TIK (41.08% dhe 55.63%, përkatësisht), dhe më pak e përdorur nga nxënësit e sektorëve të ndërtimit (18.8% dhe 18.11%, respektivisht) dhe tekstitit (19.97% dhe 14.33%, respektivisht). Plot 27,71% e nxënësve të profilit të turizmit raportojnë se përdorin shpesh internetin për qëllime mësimore në laboratorë (për më shumë shih Figurën 41). Nga ana tjetër, në krahasim me popullatën e nxënësve, shumica e mësuesve (93,53%) dhe instruktorëve (86,36%) raportojnë nivele të larta të përdorimit të internetit për të studiuar ose për të përgatitur materialet e mësimi; vetëm 7% e mësuesve pranojnë se vizitojnë ndonjë faqe interneti për të studiuar ose përgatitur materiale mësimore (shih Figurën 42 për një pamje grafike). Në lidhje me gjuhën e faqeve të internetit të përdorura, shumica e mësuesve ose 41% e tyre përdor faqet e internetit në gjuhën shqipe, ndërsa një përqindje pak më e vogël (36%) përdor faqet e internetit si në shqip ashtu edhe në gjuhë të tjera të huaj.

Së katërti, të pyetur për ndihmë në gjetjen e këtyre faqeve në internet, si nxënësit ashtu edhe mësuesit evidentojnë se i gjejnë vetë ato, duke mos u mbështetur shumë tek

rekomandimet e shokëve/kolegëve apo në burime të tjera informacioni. Pjesa më e madhe ose 68,35% e nxënësve mbështeten tek vetja e tyre, ndjekur nga 20.1% e tyre që ndihmohen nga mësuesit e tyre; vetëm 1 nxënës në 10 merr rekomandime nga shokët për të gjetur këto faqe interneti. Ky konstatim i përgjithshëm duket se vlen për të gjithë sektorët, me përjashtim të sektorit të tekstitit, në të cilën pothuajse 1 në 3 nxënës (31.03%) mbështetet tek shokët për sugjerimet mbi faqet e internetit për qëllime mësimi, ndjekur nga 17.03% e tyre që mbështetet tek mësuesit e tyre. Përqindja e nxënësve që mbështetet më shumë tek mësuesit evidentohet në sektorin TIK (26.9%). Popullata e kursantëve sugjeron se ndihmohet më tej nga mësuesit në gjetjen e faqeve të internetit që përdorin për qëllime studimi (32,26%), në krahasim me mesataren e popullatës së nxënësve (20.1%). Nga ana tjetër, edhe mësuesit duket se në një masë të madhe i gjejnë vetë faqet e internetit për studime ose për përgatitjen e materialeve mësimore (66,38%); vetëm 16.16% e mësuesve marrin rekomandime nga kolegët e tyre në zgjedhjen e faqeve të internetit dhe 9.17% nga institucionet.

Figura 43. Përqindja e nxënësve që nuk përdorin programe specifike të profilit në të gjithë sektorët



Së pesti, kur pyeten për përdorimin e programeve kompjuterike specifike për profilin e tyre, ndërkohë që 44.95% e nxënësve deklarojnë se përdorin softuerë specifike për profilin e tyre, një përqindje paksa më e vogël (41.86%) raportojnë se nuk përdorin softuerë të tillë. Fakti që nuk përdoren softuerë specifike për profilin është më e theksuar në sektorët e tekstilit (52.43%) dhe ndërtimit (51.71%), në krahasim me nxënësit në sektorin TIK (44.98%). Për një pamje grafike më të plotë shihni Figurën 43. Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se disa prej programeve të përmendur më shpesh janë: AUTOCAD, CAM, Multisim, Packet Tracer dhe paketa Microsoft Office. Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se në qendrat e formimit profesional, përdorimi i programeve specifike të profilit të instaluar në kompjuter mbetet prapa; 58.67% e kursantëve (në krahasim me 41.86% të nxënësve) dhe 61.67% e instruktorëve (në krahasim me 48.17% të mësuesve) raportojnë se nuk përdorin asnjë softuer që lidhet me profilin e tyre.

Nga ana tjetër, nga perspektiva ekskluzivisht e mësuesve, kur pyeten për përdorimin e teknologjisë për qëllime profesionale/ të mësimdhënies, pjesa më e madhe e mësuesve raportojnë se kompjuterët (58.77%), laptopët (55.39%), dhe projektuesit (52.36%) kanë më shumë gjasa të përdoren “shpesh ose pothuajse gjithmonë”. Për më tepër, 49.46% e mësuesve raportojnë përdorimin e internetit në mjedisin e klasës për simulime dhe 41.63% e tyre përdorin postën elektronike (e-mail) shpesh. Megjithatë, teknologjitë më të reja të tilla si tableta (23.15%), smart-bordet (22.29%) dhe telefonat inteligjentë (21.27%) kanë një përdorim relativisht të ulët dhe ende nuk po rritet në mënyrë të konsiderueshme përdorimi i tyre. Duke pasur parasysh këto rezultate të njëjta, instruktorët duket se kanë edhe më shumë gjasa të përdorin kompjuterët (61.54%) dhe

internetin për simulimet në klasës (59.65%) mes teknologjive të tjera.


Perceptimet e përfitimeve dhe sfidave të përdorimit të teknologjisë në klasë

Së fundi, nga vëzhgimi rezultojnë të dhëna në lidhje me perceptimin e mësuesve për sa i përket përfitimeve dhe sfidave të mundshme nga rritja e dixhitalizimit dhe aplikimit të mundshëm të të mësuarit të përzier në arsimin dhe formimin profesional.

Të pyetur për mendimin e tyre për pohime të ndryshme mbi temën e të mësuarit të përzier, të dhënat tregojnë një interes në rritje në të mësuarit të përzier tek popullata e mësuesve dhe instruktorëve, ku pjesa më e madhe e mësuesve të anketuar u treguan shumë optimistë për ndikimin pozitiv të teknologjisë në punën e tyre dhe tek rezultatet profesionale të nxënësve. Shih Figurën 44 më poshtë për pamje grafike të disa pohimeve të rëndësishme të përdorura për të vlerësuar përfitimet e perceptuara të të mësuarit të përzier.

Pjesa më e madhe (75.37%) e mësuesve “janë dakord ose plotësisht dakord” se rritja e larmisë së metodave të të mësuarit përmirëson rezultatet e të nxënësve tek nxënësit si dhe një shumicë e ngjashme (75%) duket se janë dakord se teknologjia përmirëson edhe rezultatet e tyre profesionale. Për më tepër, një pjesë e pothuajse identike e mësuesve (75.12%) mendojnë po ashtu se teknologjia vlen për të marrë informacione për profilin e tyre profesional. Pothuajse të gjithë mësuesit (79.9%) pranojnë se digjitalizimi ka potencial për të bërë arsimin profesional më tërheqës për të rinjtë. Në anën tjetër, më pak se gjysma (48.19%) besojnë se digjitalizimi dhe të mësuarit të përzier ul kostot e AFP-së dhe gati një e treta (34.17%) e mësuesve mendojnë se

Figura 44. Perceptimi i mësuesve për përfitimet e të mësuarit të përzier (%)



Shënim: Përqindja e mësuesve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert


është më e lehtë të kontrollohen njohuritë me anë të testeve online.

Kur u pyetën për perceptimin në lidhje me efektivitetin e metodave të ndryshme të mësimdhënies, të dhënat e vëzhgimit sugjerojnë se mësuesit duket se i konsiderojnë metodat e reja të mësimdhënies si më efektive se ato tradicionale. Pjesa më e madhe e mësuesve e perceptojnë mësimdhënien në grupe të vogla (67,17%) dhe punën e projektit (63,13%) si “efikase ose shumë efikase”. Për më tepër, mësimdhënia në grupe të vogla (75,81%) dhe punët e projektit (73,02%) duket se renditen më lartë edhe tek popullata e instruktorëve.

Për më tepër, kombinimi i të mësuarit tradicional në klasë me mësimin dixhital pritet të jetë “efektiv ose shumë efektive”, siç vlerësohet nga 61.45% e mësuesve dhe 55.56% e instruktorëve respektivisht. Edhe këtu, instruktorët duket se janë më rezistentë se mësuesit ndaj metodave të reja të mësimdhënies: 55.56% e tyre prirën të vlerësojnë “efikas ose shumë efikas” mësimin tradicional ku mësuesit shpjegojnë

dhe kontrollojnë njohuritë përmes pyetjeve dhe provimeve me shkrim. Si për kontrast, vetëm 1 në 4 mësues (25.25%) mendon kështu. Përveç kësaj, edhe klasat dixhitale perceptohen të jenë më pak efektive nga instruktorët në krahasim me popullatën e mësuesve (37,93% e instruktorëve mendojnë se janë “efektive apo shumë efektive” përkundër 53.4% e mësuesve). Nga ana tjetër, instruktorët thonë se media dixhitale mund të jetë më efektive, nëse përdoret si material mbështetës mësimor apo për qëllime ilustrimi. Mësuesit (19.46%) dhe instruktorët (17.74%) e perceptojnë të mësuarit në distancë si një tjetër metodë mësimdhënieje e bazuar në TIK, si metoda më pak efektive e mësimdhënies. Po ashtu, mësimdhënia e personalizuar/e përshtatur sipas aftësive dhe interesave të nxënësve perceptohet të jetë më efektive në trajnim. Plot 62,07% e instruktorëve mendojnë kjo metodë mësimdhënieje është “efektive ose shumë efektive” përkundër 55.27% e mësuesve. Ky konstatim konfirmon mendimin e kursantëve se mësimi i personalizuar është fusha e dytë më e rëndësishme që ka nevojë për përmirësime


Figura 45. Perceptimi i mësuesve për efikasitetin e metodave të ndryshme të mësimdhënies (%)



Shënim: Përqindja e mësuesve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të Likert

në qendrën e formimit profesional³⁶ nga të kursantëve në QFP-ve, kryesisht në një listë me 12 faktorë (ku përfshihen infrastruktura, kurrikula, mësimdhënia dhe faktorët që lidhen me karrierën). Kjo mund të vijë si rezultat i larmisë në përgjithshme

Figura 46. Perceptimi i mësuesve për aplikimin e të mësuarit të përzier (%)



Shënim: Përqindja e mësuesve të anketuar që raportojnë në shkallën 4 ose 5 të Shkallës 5-pikëshe të

36 Kursantëve iu kërkua të zgjidhnin nga një listë me 12 faktorë të mundshëm, ku përfshihen infrastruktura, kurrikula, mësimdhënia dhe faktorët që lidhen me karrierën.

lidhje me moshën dhe arritjet e tyre të mëparshme akademike apo me përvojën pune, në krahasim me grupin disi homogjen të nxënësve në arsimin profesional.

Figura 46 tregon renditjen nga mësuesit të sfidave që ata perceptojnë për zbatimin e të mësuarit të përzier në arsimin profesional. Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se mësuesit e perceptojnë shumicën e sfidave në anën e tyre duke u fokusuar në çështjet e njohurive të TIK dhe njohjes së metodave alternative të mësimdhënies, në krahasim me nxënësit e tyre apo infrastrukturën e përgjithshme TIK. Për shembull, gatishmëria e mësuesve për të përdorur TIK (58,94%) besohet të jetë më sfiduese se infrastruktura në shkollat respektive të TIK (52,97%). Në fakt, gatishmëria e mësuesve për të përdorur TIK-un (58,94%), njohuritë dhe aftësitë e mësuesve në TIK (55,31%) dhe gatishmërinë e tyre për të aplikuar metodat alternative të mësimdhënies (57,23%) konsiderohen si “sfiduese ose shumë sfiduese” nga pjesa më e madhe e mësuesve.

Në të njëjtën linjë, shumica e instruktorëve të anketuar (82,82%) besojnë se gatishmëria e mësuesve për të aplikuar metodat alternative të mësimdhënies është “sfiduese ose shumë sfiduese”, ndjekur nga ajo e mësuesve për të përdorur TIK (79,1%) dhe e njohurive dhe aftësive të TIK (74,6%). Por në kundërshtim me perceptimet e mësuesve, instruktorët konsiderojnë edhe njohuritë e gjuhëve të huaja të kursantëve të tyre si tepër sfiduese (63,64%).

Pjesa 7. Mundësitë e punësimit, qëllimet për të

ardhmen dhe pritshmëritë

7.1 Rezultatet e vëzhgimit të nxënësve dhe kursantëve

Në këtë pjesë të raportit analizohet informacioni për mundësitë e punësimit dhe pritshmëritë për punësimin si dhe opinionet për faktorët që ndikojnë në punësimin e të diplomuarve të AFP-së. Informacioni për pjesën më të madhe të pyetjeve është mbledhur nëpërmjet vëzhgimit me nxënësit e shkollave të arsimit profesional dhe kursantëve të qendrave të formimit profesional si dhe me mësuesit dhe instruktorët, kur pyetjet e nevojshme u përshtatën me profilin e të intervistuarit.

Përshtatshmëria e informacionit për mundësitë e punësimit

Në Tabelën 8 jepen përgjigjet e nxënësve dhe kursantëve për pyetjen nëse informacioni i siguruar në nivel shkolle/qendre për mundësitë e punësimit të të diplomuarve të ardhshëm është i mjaftueshëm për ta. Në total, 62% e nxënësve dhe 68% e kursantëve mendojnë se ky informacion është i mjaftueshëm. Rreth 23% e nxënësve dhe 16% e kursantëve nuk janë në gjendje të gjykojnë në lidhje me të, dhe 15% e nxënësve dhe 17% e kursantëve mendojnë se informacioni i dhënë për ta nuk është i mjaftueshëm fare. Megjithatë, ka dallime të dukshme në përgjigjet për këtë pyetje në të katër sektorët nën shqyrtim dhe këto dallime janë statistikisht të rëndësishme. Informacioni i dhënë është më i përshtatshëm në sektorin e turizmit dhe ndërtimit; 79% dhe 67% e atyre që studiojnë në këto fusha përkatësisht pretendojnë se ata kanë informacionin e mjaftueshëm për mundësitë e punësimit pas diplomimit. Megjithatë,

Tabela 8. Dhënia e informacionit në nivel shkolle/qendre për mundësitë e punësimit

	TIK	Ndërtim	Turizmi	Tekstili	Gjithsej nxënës	Gjithsej kursantë
Po	53.7%	67.0%	78.8%	59.0%	61.9%	67.5%
Jo	18.7%	8.0%	13.1%	23.0%	14.8%	16.9%
Nuk e di	27.6%	24.9%	8.1%	17.9%	23.4%	15.7%
	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

ekziston një dallim i konsiderueshëm mes atyre që nuk mund të japin një përgjigje për këtë pyetje tek të dy këta sektorët. Rreth 25% në sektorin e ndërtimit nuk e dinë nëse informacioni i siguruar për ta ishte i mjaftueshëm krahasuar me vetëm 8% në fushën e turizmit. Rreth 19% e nxënësve në profilet e TIK-ut dhe 23% e atyre që studiojnë në profilin e tekstit mendojnë se informacioni nuk është mjaftueshëm i përshtatshëm dhe 28% në profilet e TIK dhe 18% e atyre që studiojnë në sektorin e tekstit janë të paqarta në lidhje me vlefshmërinë e informacioni të dhënë për ta.

Burimet e informacionit për mundësitë e punësimit në të ardhmen

Të anketuarit u pyetën për të zgjedhur burimet e duhura të informacionit për karrierën apo mundësitë e punësimit të tyre në të ardhmen. Nxënësit u pyetën për një gamë më të gjerë, ndërsa kursantët kishin një zgjedhje më të kufizuar për shkak se disa prej burimeve nuk lidhen me qendrat e formimit profesional. Tabela 9 paraqet përqindjet e burimeve të përzgjedhura nga shkolla dhe qendra profesionale si dhe sipas sektorëve vetëm për kampionin e nxënësve. Duke u nisur nga shifrat në nivel shkolle dhe qendre, burimi kryesor i informacionit për mundësitë e punësimit janë mësuesit e praktikës (60.7%) dhe instruktorët në

qendrat profesionale (70.7%). Miq të dhe të afërmit përbëjnë burimin e dytë kryesor të informacionit për kursantët. Rreth 40% e këtyre të fundit pohojnë se miqtë dhe të afërmit janë një burim i rëndësishëm informacioni. Sa për nxënësit, burimi i dytë kryesor i informacionit, i përzgjedhur nga rreth një e treta e tyre, janë drejtuesit e shkollës. Plot 36.6% e nxënësve pohojnë se marrin informacion mbi mundësitë e punësimit nga miqtë dhe të afërmit e tyre. Mësuesi përgjegjës për marrëdhëniet me biznesin është përzgjedhur si burim informacioni për rreth një e katërta e nxënësve, edhe pse pritshmëritë janë dukshëm më të larta. Një shpjegim i mundshëm për shifrën e ulët mund të jetë fakti se një pozicion i tillë nuk gjendet në të gjitha shkollat. Ky pozicion zakonisht mbështetet nga donatorët e huaj që investojnë në shkollat e arsimit dhe formimit profesional. Është po aq e rëndësishme të theksohet se qendra e orientimit të karrierës është burimi i fundit i rëndësishëm i informacionit, një gjetje që thekson nevojën për t'i kthyer ato në qendra funksionale dhe aktive të orientimit të karrierës. Rreth 26% e nxënësve kanë zgjedhur mësuesit e tjerë si burim të rëndësishëm informacioni për punësimin e tyre. Edhe kërkimi në internet përdoret si burim informacioni për rreth 20% të nxënësve dhe 13% të kursantëve.

Në lidhje me këto burime informacioni sipas sektorëve për nxënësit e shkollave të arsimit

profesional në sektorët e turizmit, TIK, ndërtimit dhe tekstilit, tendenca ndjek atë të totalit të shifrave pa devijime të mëdha. Burimi më i zgjedhur i informacionit është mësuesi i praktikës. Miqtë dhe të afërmit përbëjnë një burim të madh informacioni në sektorin TIK (45.3%), ndërsa në sektorin e ndërtimit dhe turizmit rëndësia e tyre është më e ulët, rreth 21%. Në sektorin e tekstilit miqtë dhe të afërmit përbëjnë një burim informacioni për një përqindje edhe më të ulët të nxënësve, 9.6%. Drejtuesit e shkollës si burim informacioni u zgjodhën nga rreth 40% e nxënësve në sektorët e ndërtimit, tekstilit dhe turizmit, ndërsa rëndësia e tyre si burim është më e ulët në sektorin e TIK-ut (24%). Mësuesi përgjegjës për marrëdhëniet me biznesin është konsideruar më shumë në sektorin e tekstilit (42%), ndërsa nuk duket edhe aq mirë në tre sektorët e tjerë. Siç pritej, kërkimi në internet përdoret rreth

4 herë më shumë nga nxënësit e TIK në krahasim me nxënësit e tjerë. Ata në profilin e ndërtimit e përdorin më pak kërkimin në internet se të tjerët.

Planet e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve

Planet që kanë nxënësit dhe kursantët pas përfundimit të studimeve/trajnimeve të arsimit profesional janë të ndryshme. Rreth 60% e kursantëve planifikojnë të kërkojnë punë menjëherë pas mbarimit të kursit, ndërsa vetëm 22% e nxënësve mendojnë kështu. Një në pesë kursantë planifikojnë të emigrojnë pas përfundimit të kursit, ndërkohë që vetëm 3.5% e nxënësve

Tabela 9. Burimet përkatëse të informacionit për mundësitë e punësimit

	TIK	Ndërtim	Turizmi	Tekstili	Gjithsej nxënës	Gjithsej kursantë
Drejtorja e shkollës	24.2%	39.1%	40.9%	41.5%	36.6%	25.6%
Mësuesi përgjegjës për marrëdhëniet me biznesin (PASO)	22.6%	23.7%	26.4%	42.1%	26.2%	NP
Mësuesi i praktikës	73.1%	67.2%	88.3%	58.8%	60.7%	70.7%
Mësuesit e tjerë	18.7%	19.2%	23.0%	23.9%	25.9%	NP
Qendra e orientimit në karrierë	7.0%	7.2%	8.0%	3.1%	8.1%	NP
Miqtë dhe të afërmit	45.3%	21.8%	20.9%	9.6%	25.7%	40.2%
Kërkim në internet	41.3%	8.0%	11.8%	14.3%	20.1%	13.4%

*NP – Nuk u pyetën

kanë plane të tilla. Rreth 10% e kursantëve planifikojnë të vazhdojnë studimet në një nivel më të lartë. Për sa i përket nxënësve, 34% mendojnë të vazhdojnë studimet e arsimit profesional në një nivel më të lartë drejt diplomës universitare. Si për nxënësit ashtu edhe për kursantët, një përqindje e vogël ka në plan të punojnë në biznesin e familjes pas përfundimit të kursit/studimeve.

Në lidhje me të njëjtin informacion për nxënësit sipas sektorit, shifra më interesante është ajo e nxënësve TIK, 51% e të cilëve planifikojnë të vazhdojnë studimet universitare pas mbarimit të shkollës, shifër që është mjaft e lartë krahasuar me atë të sektorëve të tjerë. Dallimi është më i theksuar është po të krahasohet me sektorin e ndërtimit, në të cilin vetëm 6.7% e nxënësve kanë në plan të


vazhdojnë universitetin. Ndjekja e studimeve të larta është në plan për 33% të nxënësve në sektorin e turizmit dhe për 29% të atyre në sektorin e tekstilit. Vazhdimi në nivele të tjera të sistemit të AFP-së është në plan për 23-33% të nxënësve në këta sektorë. Megjithatë, gjetja më e habitshme është se një përqindje shumë e vogël e të diplomuarve të AFP-së kanë për qëllim të kërkojnë një punë pas diplomimit të tyre. Rreth 16% e nxënësve të TIK, 14% e nxënësve të tekstilit, 21% e nxënësve të turizmit kanë ndërmend të kërkojnë punë pas diplomimit. Shifra më e lartë është në sektorin e ndërtimit, 42%. Në përgjithësi, shifrat në tabelë tregojnë se sjellja e pritshme e nxënësve pas diplomimit është e ndryshme në ndërtim dhe disi më e ngjashme mes tre sektorëve të tjerë, me përjashtim të nivelit të lartë të orientimit

Tabela 10. Çfarë keni ndërmend të bëni pas përfundimit të shkollës/kursit?

	TIK	Ndërtim	Turizmi	Tekstili	Gjithsej nxënësit	Gjithsej kursantët
Kërkosh për një punë	15.8%	42.1%	20.6%	14.2%	21.9%	59.8%
Vazhdosh arsimin profesional në një nivel më të lartë	23.3%	33.3%	32.5%	27.8%	34.2%	9.8%
Vazhdosh në universitet	51.0%	6.7%	33.7%	38.1%	31.9%	1.2%
Qëndrosh në shtëpi	0	1.0%	0	4.9%	0.6%	1.2%
Punosh në biznesin e familjes	1.5%	2.4%	2.2%	6.3%	2.1%	4.9%
Shkosh në emigracion	6.6%	6.8%	6.8%	1.0%	3.5%	20.7%
Nuk e di	1.7%	7.6%	4.2%	7.7%	5.2%	NP*
Tjetër, specifiko	0	.2%	0	0	.6%	2.4%

*NP – nuk u pyetën

Figura 47. A mendoni se me mbarimin e studimeve profesionale mundësitë e punësimit janë më të larta?




drejt studimeve universitare në profilin TIK. Nxënësit e këtij profili kanë në përgjithësi një performancë më të mirë akademike në krahasim me profilet e tjera të AFP. Kjo mund të rrisë mundësitë e tyre për të fituar të drejtën për studime universitare.

Pritshmëritë për mundësitë e punësimit

Figura 47 paraqet përqindjet e përgjigjeve të nxënësve mbi pritshmëritë për mundësi më të larta punësimi të të diplomuarve të AFP-së në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga sistemi i arsimit të përgjithshëm. E njëjta pyetje iu bë edhe kursantëve me një ndryshim të vogël. Atyre iu kërkua të vlerësonin nëse ndjekja e kursit do të rriste shanset e tyre për punësim. Në të gjithë sistemin e AFP-së, 80% e nxënësve dhe 85% e kursantëve pohojnë se kanë shanse më të mira. Rreth 11% e nxënësve nuk janë të sigurt nëse pjesëmarrja e tyre në AFP ka më shumë vlerë se në arsimin e përgjithshëm, ndërsa rreth 9% mendojnë se nuk kanë shanse më të mira në krahasim me të diplomuarit e

shkollave të mesme të përgjithshme. Për sa i përket kursantëve, 12.5% nuk janë të sigurt nëse ndjekja e kursit e ka rritur mundësitë e tyre për punësim, ndërsa 3% mendojnë se shanset e tyre për punësim nuk janë rritur pas përfundimit të kursit. Sipas ndarjes në sektorë, shifrat janë më të ulëta se sa në sistemin e përgjithshëm. Siç tregohet edhe në grafikun e mëposhtëm, përqindja e atyre që mendojnë se ndjekja e arsimit profesional rrit mundësitë e punësimit në sektorin e tekstilit është dukshëm më e ulët se ajo e sektorëve të tjerë (51%), dhe mbi 70% në tre sektorët e tjerë. Edhe përqindja e të dekurajuarve, d.m.th., e atyre që mendojnë se nuk kanë shanse më të mira ose që nuk janë të sigurt është më e lartë në sektorin e tekstilit. Sektori TIK ofron shifra më optimiste, duke treguar përqindjen më të ulët të atyre që mendojnë se nuk kanë shanse më të mira, edhe pse rreth 16% e nxënësve të TIK nuk janë të sigurt. Këto shifra të fundit mund të shpjegohet pjesërisht me qëllimet më të larta të nxënësve të TIK për të ndjekur studimet e mëtejshme.

Figura 48. A mendoni se të diplomuarit e AFP kanë mundësi më të mira për hapjen e një biznesi të ri?



Pritshmëritë për vetë-punësim

Për sa i përket mundësive për hapjen e një biznesi me përfundimin e studimeve, situata është paksa më ndryshe (Figura 48). Një përqindje më e lartë e nxënësve AFP, 79%, mendojnë se shanset e tyre për të hapur një biznes janë më të mira se të atyre që kanë mbaruar gjimnazin, ndërsa 69% e kursantëve mendojnë se mundësitë e tyre rriten pas përfundimit të kursit të formimit profesional. Përqindja e pesimistëve, që thonë se shanset e tyre nuk janë më të larta, varion nga 7-8% tek të dy grupet. Në përputhje me konstatimin mbi mundësitë e punësimit, krahasimi sipas sektorit tregon se një përqindje e lartë e nxënësve të TIK mendojnë se kanë shanse më të mira për t'u vetë-punësuar. Kjo përqindje është mjaft e lartë edhe për sektorin e turizmit (81%). Nxënësit në sektorin e ndërtimit i janë përgjigjur sipas një prirjeje të ndryshme, me nivel më të ulët mundësish vetëpunësimi dhe më shumë pasiguri, kur krahasohen me të diplomuarit e shkollave të mesme të përgjithshme.

Pritshmëritë për punëdhënësit e mundshëm

Tabela 11 paraqet pritshmëritë e nxënësve dhe kursantëve të AFP në lidhje me punësimin e tyre. Në përgjithësi, një përqindje më e lartë e kursantëve presin të gjejnë punë në sektorin privat, 56.4%, ndërsa rreth 22% e tyre mendojnë se do të hapin biznesin e tyre. Nxënësit e AFP janë disi të ndarë në mënyrë të barabartë mes alternativës për të punuar në një institucion/ndërmarrje publike, në ndërmarrje private, dhe për të hapur biznesin e tyre.

Ka shumë variacione në pritshmëritë e punësimit tek të katër sektorët e zgjedhur. Rreth 52% e nxënësve në tekstil shpresojnë të hapin biznesin e tyre dhe 52% e nxënësve që ndjekin studimet në turizëm presin të punojnë në një ndërmarrje private. Nxënësit TIK mendojnë se kanë më shumë gjasa për të punuar në një ndërmarrje publike, ndërsa në sektorët e tjerë kjo përqindje varion nga 27 në 31%. Është interesante të theksohet se edhe pse nxënësit e tekstilit kanë më pak të ngjarë të gjejnë punë në një ndërmarrje private, kursantët e të njëjtës fushë kanë më

Tabela 11. Në cilën fushë mendoni se mund të gjeni punësim?

	TIK	Ndërtim	Turizmi	Tekstili	Nxënësit	Kur-santët
Në ndërmarrje publike	37.5%	30.8%	30.3%	27.2%	33.8%	12.8%
Në ndërmarrje private	27.0%	31.7%	51.9%	19.5%	32.3%	56.4%
Vetë-punësim	27.6%	32.9%	16.4%	52.4%	30.1%	21.8%
Tjetër	8.0%	4.6%	1.4%	1.0%	3.8%	9.0%

shumë gjasa ta bëjnë këtë gjë. Nxënësit në ndërtim janë të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë tek të tre grupe e punësimit.

Kohëzgjatja e pritshme e periudhës së gjetjes së punës pas mbarimit të shkollës

Pritshmëritë në periudhën e tranzicionit nga shkolla/kursi në punë paraqiten në Tabela 12. 49% e kursantëve mendojnë se do të gjejnë punë brenda gjashtë muajve, 18% brenda një muaji, 19% brenda një viti dhe rreth 11% e tyre mendojnë se ndoshta kërkimi për punë do

të zgjasë më shumë. Rreth 4% e kursantëve nuk mendojnë se do të kërkojnë punë kur të përfundojnë kursin. Ka një pamje të ndryshme me nxënësit e arsimit profesional. Njëzet e dy për qind e tyre mendojnë se do të gjejnë punë brenda gjashtë muajve, një përqindje më e ulët në krahasim me atë të kursantëve; 23% mendojnë se do të duhet vetëm një muaj për të gjetur një punë; 32% mendojnë se do të marrë rreth një vit dhe 22% mendojnë se do të marrë edhe më shumë kohë për të gjetur punë.

Sipas sektorëve, një përqindje më e lartë e nxënësve në sektorin e turizmit, 40%, mendojnë se do të gjejnë punë brenda një

Tabela 12. Sa kohë mendon se mund të të duhet për të gjetur një punë pas mbarimit të shkollës?

Kohëzgjatja	TIK	Ndërtim	Turizmi	Tekstili	Nxënësit	Kur-santët
Brenda një muaji	22.9%	21.8%	40.4%	23.4%	22.6%	17.5%
Brenda gjashtë muajsh	29.5%	24.8%	35.9%	7.7%	21.6%	48.8%
Brenda një viti	19.9%	28.3%	9.2%	12.5%	31.9%	18.8%
Më gjatë	25.6%	22.6%	13.4%	55.7%	22.2%	11.3%
Nuk do të kërkoj punë	2.1%	2.4%	1.1%	.6%	1.6%	3.8%

muaji, në krahasim me 23% të nxënësve në TIK dhe tekstile dhe 22% e atyre në ndërtim që presin të bëjnë të njëjtën gjë. Përveç kësaj, një përqindje më e lartë e nxënësve të sektorit të turizmit presin të gjejnë punë brenda 6 muajve. Ata që presin një vit apo edhe më shumë kohë për të gjetur punë janë nxënësit e tekstilit (68%), ndërtimit (51%) dhe TIK (46%).

Faktorët që përmirësojnë mundësitë e punësimit

Nxënësve dhe kursantëve iu kërkua të zgjidhnin nga një listë dy faktorët më të rëndësishëm që mund të kenë ndikim në përmirësimin e punësimit të tyre. Rezultatet jepen në Tabelën 13. Në përgjithësi, të dy grupet kanë zgjedhur mjetet dhe pajisjet më të mira të punës si faktori më i rëndësishëm. Kursantët kanë zgjedhur bashkëpunimin më të mirë të qendrave të formimit profesional me zyrën e punësimit dhe të karrierës si faktorin e dytë më të rëndësishëm që ndikojnë në punësimin e tyre, e ndjekur nga praktika më të gjata dhe metodat më të mira të mësimdhënies. Për nxënësit e arsimit profesional faktori i dytë më i rëndësishëm është ai për të pasur më shumë orë praktike. Përveç kësaj, ata pretendojnë se është më rëndësi që të kenë praktika më të gjata në mjedisin e biznesit, më shumë mësues të kualifikuar dhe metoda më të mira të mësimdhënies.

Për sektorët në shqyrtim kemi një panoramë të ndryshme. Nxënësit TIK kanë pohuar se përdorimi i kompjuterëve dhe internetit është faktori më i rëndësishëm, pasuar nga mjetet dhe pajisje më të mira të punës. Ata kanë një rezultat të ngjashëm për sa i përket më shumë orëve të praktikës dhe metodave më të mira të mësimdhënies, 33.6 dhe

33.4% përkatësisht. Nxënësit e ndërtimit nxjerrin në pah rëndësinë e infrastrukturës më të mirë në shkollë (34.6%), më shumë orë praktikë (30%) dhe metoda më të mira të mësimdhënies (28%). Edhe një shumicë e konsiderueshme e nxënësve në fushën e turizmit kanë zgjedhur mjete dhe pajisje më të mira të punës (40%) si faktor të rëndësishëm. Faktori i dytë më i rëndësishëm për punësimin e tyre është përmirësimi i metodave të mësimdhënies që është përzgjedhur nga 36% e nxënësve në profilin e turizmit. Edhe periudha më e gjata e praktikës në biznese, më shumë orë praktikë dhe më shumë mësues dhe instruktorë të kualifikuar kanë marrë një përqindje të lartë. Në ndryshim nga rezultatet e mëparshme, nxënësit e sektorit të tekstilit kanë theksuar rëndësinë e mësuesve më të kualifikuar si faktorin më të rëndësishëm, si dhe përmirësimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës si të një rëndësie të njëjtë. Përdorimi i kompjuterëve dhe internetit renditet i treti në kuadër të faktorëve të zgjedhur nga nxënësit e tekstilit pasuar nga metoda më të mira të mësimdhënies që kanë një rezultat pothuajse të ngjashëm (38.6% përkundër 37.2%). Infrastruktura më e mirë në shkollë dhe më shumë orë praktikë gjithashtu janë zgjedhur nga një përqindje e konsiderueshme e nxënësve.

7.2 Rezultatet e vëzhgimit të mësuesve dhe instruktorëve

Vlerësimi i mjaftueshmërisë së njohurive të nxënësve/kursantëve

Mësuesve/instruktorëve iu kërkua të jepnin opinionin e tyre nëse nxënësit/kursantët që ndjekin studimet/kurset në shkollat/qendrat e tyre kanë njohuritë e mjaftueshme për të nisur punë në profesionin e tyre

Tabela 13. Faktorët më të rëndësishëm për mundësitë e punësimit

	TIK	Ndërtim	Turizmi	Tekstili	Students	Trainees
Infrastruktura më e mirë e shkollës	5.5%	34.6%	11.6%	29.1%	17.9%	7.7%
Metoda mësimi më të mira	33.4%	27.9%	35.9%	37.2%	24.3%	25.6%
Mësues/instruktorë më cilësorë	19.1%	21.0%	27.0%	52.8%	26.2%	7.7%
Mjete dhe pajisje gjatë praktikës	37.7%	30.4%	40.1%	52.2%	35.9%	48.7%
Lëndë të para për zhvillimin e praktikës	9.8%	16.1%	12.7%	9.1%	15.5%	NP
Më shumë orë praktike në programin mësimor	33.6%	29.7%	31.9%	30.2%	32.1%	NP
Program mësimor më të përshtatshëm dhe bashkëkohor	23.2%	7.0%	17.7%	10.9%	16.3%	17.9%
Më shumë mundësi për të punuar me kompjutera dhe internet	40.9%	16.1%	9.2%	38.6%	19.1%	14.1%
Këshillim më të mirë për punësim	19.5%	13.5%	17.1%	25.3%	14.3%	14.1%
Praktika më të gjata pranë ndërmarrjeve	28.0%	27.1%	34.5%	5.9%	27.1%	30.8%
Bashkëpunim më i mirë mes shkollës dhe bizneseve	NP	NP	NP	NP	NP	41.0%
Bashkëpunim më i mirë mes shkollës dhe zyrave të punësimit dhe karrierës	NP	NP	NP	NP	NP	21.8%

*NP – Nuk u pyetën

Tabela 14. A mendoni se nxënësit e diplomuar nga shkolla juaj kanë njohuri të mjaftueshme për të filluar punë?

	Mësuesit		Instruktorët	
	N	%	N	%
Po	181	85.4	66	97.1
Jo	9	4.2	1	1.5
Nuk e di	22	10.4	1	1.5
Total	212	100.0	68	100.0

me përfundimin e shkollës/kursit. Në Tabelën 14 jepet një përqindje më e lartë e instruktorëve që kanë dhënë përgjigje pozitive, 97%, krahasuar me rreth 85% e mësuesve. Rreth 10% e mësuesve nuk mund të gjykojnë nivelin e njohurive të nxënësve të tyre dhe kjo mund të shpjegohet me përfshirjen e mësuesve të lëndëve jo-profesionale në kampion. Katër për qind e mësuesve mendojnë se nxënësit e tyre nuk kanë njohuritë e nevojshme për të filluar punën.

Tabela 15. Vlerësimi i rëndësisë së njohurive dhe performancës së shërbimit të këshillimit dhe orientimit të karrierës

	Rëndësia e njohurive				Këshillimi i orientimit profesional dhe karrierës			
	Mësuesit		Instruktorët		Mësuesit		Instruktorët	
	N	%	N	%	N	%	N	%
Pak	2	.9	1	1.5	6	2.8	2	2.9
Disi	52	24.5	13	19.1	63	29.9	13	18.8
Shumë	143	67.5	45	66.2	123	58.3	41	59.4
Jashtëzakonisht shumë	15	7.1	9	13.2	19	9.0	13	18.8
Gjithsej	212	100.0	68	100.0	211	100.0	69	100.0

Rëndësia e njohurive të dhëna në shkollë për punësim

Po ashtu, mësuesve/instruktorëve iu kërkuar të vlerësonin në një shkallë në rritje nga 1 në 5 rëndësinë e njohurive që ofrohen në shkollë/qendër për profesionin përkatës si dhe për të vlerësuar performancën e këshillimit të orientimit dhe karrierës profesionale në nivel shkolle/qendre. Tabela 14 përmbledh përgjigjet e tyre për këto dy pyetje. Në lidhje me rëndësinë e njohurive, rreth dy të tretat e mësuesve dhe instruktorëve mendojnë se nxënësit/kursantët e tyre janë të pajisura në nivel të lartë me njohuritë përkatëse në shkollë/qendër. Një përqindje e ulët, 7% e mësuesve dhe 13% nga instruktorët, mendon se njohuritë që kanë fituar nxënësit dhe kursantët në shkollë/qendër janë shumë të rëndësishme për profesionin/punën e tyre. Megjithatë, është shqetësuese të theksohet se një përqindje e konsiderueshme e mësuesve dhe instruktorëve (rreth 25% e mësuesve dhe 19% nga instruktorët) mendojnë se njohuritë janë të një rëndësie mesatare. Arsytet e mungesës ose nivelit të ulët të rëndësisë bëjnë të nevojshme

hulumtime të mëtejshme dhe mund të përbëjnë bazën për hartimin e ndërhyrjeve efektive.

Performanca e zyrave të karrierës dhe orientimit profesional ndjek një tendencë të ngjashëm. Pjesa më e madhe e mësuesve dhe instruktorëve, rreth 60% e tyre, e kanë vlerësuar punën e tyre si të një niveli mjaft të mirë (4). Tridhjetë për qind e mësuesve mendojnë se ndihma e dhënë për nxënësit nga shërbimi i këshillimit dhe orientimit në nivel shkolle/qendre është disi e mirë (3). Vetëm 9% e mësuesve dhe 19% e instruktorëve mendojnë se shërbimet e këshillimit të karrierës dhe orientimit profesional janë kryer në një nivel shumë të lartë.

Faktorët që ndikojnë në futjen në tregun e punës

Figura 49 paraqet zgjedhjen nga mësuesit dhe instruktorët dy faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në futjen në tregun e punës së të diplomuarve të kohëve të fundit. Siç mund

Figura 49. Cilët mendoni se janë 2 faktorët kryesorë që përcaktojnë hyrjen në tregun e punës?






Figura 50. Vlerësimi i mësuesve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e programeve të shkollës me nevojat e tregut të punës (%)



të vërehet, 79% e instruktorëve dhe 58% e mësuesve mendojnë se niveli i njohurive profesionale është faktori më i rëndësishëm. Faktori i dytë më i rëndësishëm ishte fusha e specializimit dhe profili, gjë që pritet duke pasur parasysh se disa nga profesionet kanë kërkesë më të lartë se të tjerët, ndoshta për shkak të natyrës së tyre ndërsektoriale në aspektin e punësimit në sektorë të

ndryshëm, si dhe për shkak të mungesës së profesionistëve në profile të caktuara. Është interesante të theksohet se faktori i tretë më i rëndësishëm për mësuesit është niveli i aftësive praktike, por për instruktorët disiplina në punë është zgjedhur me të njëjtën përqindje si për rëndësinë e specializimit ose profilit dhe aftësive praktike që renditen më pas. Instruktorët priren t'i japin rëndësi

Figura 51. Vlerësimi mesatar i mësuesve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e kurrikulës



më të madhe faktorëve të njohurive të përbashkëta, aftësive të komunikimit dhe gjuhëve të huaja në krahasim me rëndësinë që u jepen atyre nga mësuesit.

Efektiviteti i qasjeve për përshtatjen e programeve të shkollës me nevojat e tregut të punës


Mësuesve iu kërkua edhe të vlerësonin në një shkallë nga 1 në 5 efektivitetin e disa metodave të përshtatjes së programit mësimor me nevojat e tregut të punës (Figura 49). Të gjitha qasjet e listuara vlerësohen me notë mesatare në shumë të mirë për efektivitetin e tyre. Diskutimi me bordin e shkollës ka shënuar përqindjen më të lartë në të dy vlerat më të ulëta; rreth një e katërta e të anketuarve mendojnë se kjo nuk është mënyrë efektive për të hartuar programin e kursit që të përshtatet me nevojat e tregut të punës. Ky konstatim mund

të shpjegohet për shkak të një strukture më shumë formale sesa efektive ku dhe bordet e shkollave të arsimit profesional veprojnë si të tilla në shumicën e rasteve. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me biznesin është përzgjedhur si qasja më efektive nga 43% e mësuesve. Edhe përshtatja e kurrikulave që të përputhen me nevojat e tregut rajonal të punës është renditur lart nga një përqindje e konsiderueshme e mësuesve (41%). Edhe pse nuk është paraqitur në tabelën e mëposhtme, rreth 48% e mësuesve japin një vlerësim nga mesatar në të lartë për pretendimin se kurrikulat janë të paracaktuara dhe nuk përdorin asnjë nga këto metodat për t'i përditësuar dhe përmirësuar ato. Ky konstatim i fundit nxjerr në pah një çështje të rëndësishme që mund të ndikojë shumë në punësimin e të diplomuarve. Në shumicën e rasteve, mësuesit përsëritin për vite me radhë të njëjtin program dhe pothuajse gjysma e tyre nuk i përkthejnë dhe përshtatin kurrikulat e reja çdo vit me nevojat e tregut të punës.

Tabela 16. Vlerësimi i instruktorëve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e programeve të shkollës me nevojat e tregut të punës (%)

	Aspak	Pak	Disi	Shumë	Jashtëzakonisht shumë
Diskutimi me bordin e shkollës	6.3	14.3	20.6	22.2	36.5
Diskutimi me përfaqësues të bizneseve të zonës për programet	9.8	4.9	19.7	14.8	50.8
Diskutimi me zyrat rajonale të punësimit	3.2	7.9	19.0	20.6	49.2
Zbërthimi i kurrikulave nga mësuesit bazuar në karakteristikat e tregut rajonal punës	1.6	3.1	10.9	29.7	54.7
Autonomia e qendrës për ofrimin e kurseve	5.1	10.2	8.5	27.1	49.2
Përshtatja e programeve të kursit nga kurset e suksesshme brenda dhe jashtë vendit	4.9	1.6	18.0	23.0	52.5

Figura 52. Vlerësimi mesatar i mësuesve për efektivitetin e qasjeve për përshtatjen e kurrikulës



Për të plotësuar këto shifra, Figura 51 ofron mjetet e vlerësimit të mësuesve për përqasjet e listuara. Aktivitetet e përbashkëta me bizneset kanë rezultuar me mesataren më të lartë, me 4 pikë, ndërkohë që vlerësimi i nevojave rajonale të tregut të punës dhe përmirësimi i kurrikulës në përputhje me to ka shënuar një mesatare prej 3.9 pikësh. Edhe diskutimi i kurrikulave me bizneset lokale është vlerësuar me një mesatare të ngjashme të lartë, me 3.8 pikë.

Instrukturëve iu kërkuar të vlerësonin efektivitetin e një grupi paksa më të ndryshëm faktorësh, të cilët u përshtatën me veçoritë e trajnimeve dhe menaxhimit e qendrave profesionale. Rezultatet paraqiten në Tabelën 16 dhe Figurën 52. Instrukturët kanë vlerësuar efektivitetin e përditësimit të kurrikulës, duke marrë parasysh nevojat e tregut rajonal të punës (55%), me mundësinë për të përshtatur programet e kurseve të suksesshme brenda dhe jashtë vendit (53%), dhe diskutimi me përfaqësues të bizneseve lokale (51%), si tre qasjet më efektive për integrimin e suksesshëm në tregun e punës. Edhe pikët e vlerësimit tregojnë të njëjtën prirje. Të gjitha qasjet

e listuara kanë marrë më shumë pikë se efektiviteti mesatar. Përsëri, edhe pse disa të rëndësishme, diskutimet me bordin e shkollës kanë rezultuar me mesataren më të ulët, duke theksuar nevojën për të përmirësuar performancën e tyre si dhe mbështetjen më të madhe tek qasjet e tjera më efektive. Në ndryshim nga vlerësimi e mësuesve, diskutimi me zyrat rajonale të punësimit ka rezultuar me një mesatare më të lartë që konfirmon gjetjet e mëparshme në këtë pjesë dhe që tërheq vëmendjen për nevojën e forcimit të rrjeteve institucionale dhe bashkëpunimin mes tyre si një mënyrë më efektive në drejtim të përditësimit të kurrikulave.

Niveli i bashkëpunimit me shkollat profesionale për veprimtari që përmirësojnë performancën

Tabela 17 paraqet vlerësimin e mësuesve për nivelin e bashkëpunimit të shkollave profesionale për disa aktivitete, të cilat do të përmirësojnë performancën e tyre. Nuk ka tendencë të qartë në renditjen e secilit

Tabela 17. Si do ta vlerësonit nivelin e bashkëpunimit të institucionit tuaj me bizneset në lidhje me të mëposhtmet?

	Shumë i ulët	I ulët	Disi	I lartë	Shumë i lartë
Ndërtimin e planit strategjik të shkollës	15.3	18.9	27.6	23.0	15.3
Diskutimin, hartimin dhe përshtatjen e programeve të lëndëve profesionale	21.3	13.7	26.4	20.3	18.3
Trajnimin e mësuesve mbi risitë e profesionit	19.5	18.0	17.0	27.5	18.0
Negocimin e praktikave të nxënësve	3.4	13.8	23.6	27.6	31.5
Negocimin për futjen në punë të të diplomuarve	7.0	23.5	27.5	25.5	16.5
Krijimin e lidhjeve të qëndrueshme me bizneset dhe forcimin e tyre	3.5	21.0	21.0	27.5	27.0

aktivitet, gjë që tregon se mësuesit kanë mendime të ndryshme për bashkëpunimin me bizneset për sa i përket aktiviteteve të listuara. Përqindja më e lartë në tabelë është ajo e një niveli shumë të lartë të bashkëpunimit me bizneset për negociatat mbi praktikat e nxënësve. Ky opsion është zgjedhur nga 32% e mësuesve. Rreth 27% e tyre kanë pohuar, po ashtu, se bashkëpunojnë me bizneset për të vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me ta si dhe për të forcuar ato ekzistuese.

Nivelet më të ulëta të bashkëpunimit janë evidentuar në bashkëpunimin me bizneset në lidhje me hartimin dhe përshtatjen e programit mësimor të lëndëve profesionale dhe trajnimin e mësuesve në risitë profesionale. Plot 35% dhe 38% e mësuesve kanë dhënë një vlerësim përkatësisht shumë të ulët apo të ulët për bashkëpunim me bizneset për këto çështje. Ky nivel i ulët bashkëpunimi është në themelin e mospërputhjes së aftësive dhe ndikon negativisht në punësimin e të

diplomuarve. Nga ana tjetër, 38% dhe 45% e mësuesve kanë dhënë një vlerësim të lartë ose shumë të lartë në këto çështje, të cilat mund të shpjegohen nga niveli i lartë i shkollës dhe ndryshimi i profilit në lidhje me marrëdhëniet me bizneset.

Për sa i përket bashkëpunimit me qëllim hartimin e planit strategjik të shkollave, 28% e mësuesve kanë zgjedhur nivelin mesatar, 23% nivelin e lartë të bashkëpunimit, dhe 19% e tyre kanë zgjedhur një nivel të ulët bashkëpunimi. Pjesa e mbetur prej 30% janë ata që mendojnë se niveli i bashkëpunimit është ose shumë i ulët ose shumë i lartë dhe të dy grupet janë të ndarë në mënyrë të barabartë.

Përgjigjet tregojnë se ka një bashkëpunim në lidhje me negocimin e punësimit të të diplomuarve, edhe pse 31% e mësuesve pohojnë se shkolla e tyre nuk është e përfshirë shumë në këto bisedime, dhe 28% mendojnë se ky bashkëpunim është në nivele mesatare. Mesataret e vlerësimeve

Tabela 18. Çfarë do t'iu rekomandonit drejtuesve të shkollës dhe vendimmarrësve në mënyrë që të rritet përputhshmëria e aftësive të marra në shkollë/qendër me ato që kërkon tregu i punës

	Mësuesit		Instruktorët	
	N	%	N	%
Infrastrukturë dhe bazë materiale më e mirë	161	77.4	48	68.6
Programe më të orientuara ndaj profesioneve të veçanta	76	36.5	24	34.3
Studime më të orientuara ndaj teorisë	21	10.1	13	18.6
Më shumë orë praktike në shkollë	48	23.1	28	40.0
Më shumë orë praktikë në biznes	158	76.0	42	60.0
Më shumë korrektesë në zbatimin e programeve	24	11.5	3	4.3
Më shumë kontroll mbi njohuritë e nxënësve (provime, teste)	22	10.6	12	17.1
Më shumë aktivitete të lidhura drejtpërdrejt me biznesin	163	78.4	44	62.9
Të shtohen lëndë mbi sipërmarrjen dhe menaxhimin e bizneseve të vogla e të mesme	41	19.7	18	25.7
Të përmirësohet mënyra e orientimit profesional të nxënësve	74	35.6	NP	NP
Më shumë asistencë në hartimin e programit	NP		14	20.0

*NP - Nuk u pyetën

tregojnë të njëjtën prirje pikëzimi, me negociimin e praktikave të nxënësve që rezultojnë në një mesatare më të lartë (3.7), e ndjekur nga vendosja e marrëdhënieve të qëndrueshme (3.5), ndërsa pohimet e tjera kanë një mesatare pothuajse të barabartë (rreth 3 pikë).

Rekomandime për vendimmarrësit dhe drejtuesit e shkollave për të përmirësuar përshtatjen e aftësive me nevojat e tregut të punës

Mësuesve dhe instruktorëve iu kërkua të zgjidhnin rekomandimet më të rëndësishme për vendimmarrësit dhe drejtuesit e

shkollave/qendrave për përmirësimin e përshtatjes së aftësive me nevojat e tregut të punës. Në Tabelën 18 paraqitet një përmbledhje e përgjigjeve të tyre. Mësuesit kanë përzgjedhur si tre rekomandimet më të rëndësishme organizimin e shumë aktiviteteve në bashkëpunim me bizneset (78.4%), përmirësimin e infrastrukturës së shkollës dhe të lëndëve të para (77.4%) dhe më shumë orë praktikë në mjediset e biznesit (76%). Këto janë edhe rekomandimet më të rëndësishme të ofruara nga instruktorët, edhe pse në një mënyrë të ndryshme dhe me rreth 10 pikë përqindje më pak. Edhe programet më të orientuara drejt profesioneve të veçanta dhe më shumë orë praktikë në

Tabela 19. Sipas mendimit tuaj, sa përmirësim duhet në çështjet e mëposhtme në shkollën tuaj?


	Aspak	Jo shumë	Disi	Shumë	Jashtëzakonisht shumë	Mesatare
Ndërtesa e shkollës	24.9	17.7	17.1	13.3	27.1	3.00
Kushtet në klasa	17.6	10.9	22.3	23.8	25.4	3.28
Kushtet në laboratorë	6.4	7.4	17.6	26.1	42.6	3.91
Mjediset e posaçme për mësuesit	14.5	12.3	25.1	24.6	23.5	3.93
Tekstet dhe materialet	2.6	3.7	29.6	30.2	33.9	3.30
Mjetet dhe pajisjet e punës që përdoren në praktikë	5.5	6.6	19.2	30.2	38.5	3.89
Numri i nxënësve/kursantëve për klasë/kurs	10.3	13.3	20.5	24.1	31.8	3.90
Përputhja e moduleve me teknologjinë e fundit	4.8	8.5	29.8	29.8	27.1	3.69
Mësimdhënie e personalizuar sipas nevojave të nxënësit	6.7	22.2	34.4	19.4	17.2	3.54
Përshtatja e programeve me tregun e punës	2.2	11.4	26.1	30.4	29.9	3.66
Rezultatet e nxënësve/kursantëve	2.2	8.6	34.9	34.9	19.4	3.18
Mundësitë e mësuesve për trajnim të vazhdueshëm	2.0	6.1	25.0	29.6	37.2	3.74
Cilësia e administrimit të shkollës	21.7	21.2	21.7	16.8	18.5	3.61
Shkalla e autonomisë së shkollës	13.7	20.2	26.8	21.3	18.0	3.94
Përdorimi i sistemeve të informatizuara për administrim	8.0	14.8	33.5	23.9	19.9	2.89
Kushtet e bazës prodhuese	8.2	4.3	16.3	28.3	42.9	3.10
Lënda e parë që përdoret në praktikë	8.2	8.8	22.0	28.0	33.0	3.33

shkollë/qendër janë rekomanduar nga një përqindje e konsiderueshme e mësuesve dhe instruktorëve. Rekomandimet më pak të përzgjedhura janë ato që lidhen me më shumë teste dhe provime për të kontrolluar njohuritë e nxënësve/kursantëve dhe më shumë korrektesë në zbatimin e programit. Është po aq e rëndësishme të theksohet se rreth një e pesta e mësuesve dhe një e katërta e instruktorëve mendojnë se nuk ka nevojë të shtohen lëndët/njohuritë për sipërmarrjen, hapjen e një biznesi, dhe për menaxhimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Kur u pyetën në lidhje me përmirësimet që kanë më shumë nevojë shkollat, mësuesit evidentuan se shkollat kanë nevojë për një gamë mjaft të gjerë ndërhyrjesh. Tabela 19 paraqet përqindjet e vlerësimit nga 1 (nuk ka nevojë) deri në 5 (nevojë shumë e madhe) për nivelin e përmirësimit që nevojitet dhe të vlerësimit mesatar për çdo çështje në listë.

Përqindjet në tabelë tregojnë se mësuesit kanë vlerësuar përmirësimin e kushteve të bazës prodhuese dhe të kushteve laboratorike si ato më urgjente. Nevoja shumë e lartë për përmirësimin e kushteve të bazës prodhuese zgjidhet nga rreth 43% e mësuesve. Vlerësimet e kushteve laboratorike ndjekin pothuajse të njëjtën përqindje, me 42.6% të mësuesve që kanë dhënë vlerësimin më të lartë (5) dhe 26% që të kenë pohuar se niveli i ndërhyrjes duhet të jetë i lartë (4). Përmirësimi ose furnizimi me mjete dhe pajisje që përdoren gjatë orëve të praktikës janë vlerësuar shumë nga 39% e mësuesve, dhe një tjetër 30% e tyre mendojnë se përmirësimi i tyre është shumë e shumë i nevojshëm. Mundësitë e mësuesve për trajnime të vazhdueshme duket se janë në nivel të ulët, duke pasur parasysh se 67% e të anketuarve e kanë vlerësuar shumë nevojën për përmirësim (4 dhe 5).

Figura 53. Sipas mendimit tuaj, sa përmirësim duhet në çështjet e mëposhtme në qendrën tuaj?



Më pak përmirësim nevojitet për ndërtesat e shkollës, cilësinë e administrimit të shkollës, shkallën e autonomisë shkollore, kushtet e klasës, dhe personalizimin e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e nxënësve. Bazuar në vlerësimet e mësuesve, ndërhyrjet në fusha të tjera duket se janë të rëndësishme.

Vlerësimet mesatare për faktorët e listuar janë më të larta se 3, me përjashtim të përmirësimeve të nevojshme në përdorimin e sistemeve të informacionit për administrimin e shkollës. Pikët ndryshojnë nga 3 deri në 4, duke evidentuar më shumë nevojën mesatare për ndërhyrje. Autonomia e shkollës, kushte laboratorike, mjetet dhe pajisjet e përdorura në praktikë, numri i nxënësve në çdo klasë, mjediset e posaçme për mësuesit, mundësitë e mësuesve për trajnime të vazhdueshme, përshtatja e moduleve me teknologjinë aktuale, dhe programet që përputhen me nevojat e tregut të punës kanë rezultuar me mesataret më të larta.

Këto çështje dhe disa të tjera u vlerësuan edhe nga instruktorët e qendrave profesionale. Pothuajse të gjithë faktorët kanë rezultuar me mesatare më të larta se 3, dhe devijime të ulëta standarde nga mesatarja (1.1-1.5). Pjesa më e madhe e instruktorëve, 55%, kanë theksuar shumë rëndësinë e trajnimeve të vazhdueshme për ta (Figura 53). Sipas mendimit të 41.5% të instruktorëve, mjetet dhe pajisjet e përdorura në praktikë kanë po aq nevojë për një nivel të lartë përmirësimi. Çuditërisht, dhe në dallim nga gjetjet e mësuesve, niveli i autonomisë së qendrës është zgjedhur si faktori i tretë më i rëndësishëm në drejtim të ndërhyrjeve përmirësuese që sugjerojnë ata. Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm që ka nevojë për përmirësim të lartë është përputhja e programeve me nevojat e tregut të punës, një gjetje që shkon dorë për dorë me përmirësimin e nevojshme në autonominë e

shkollës në lidhje me hartimin e programit dhe të kurrikulës. Edhe përputhshmëria e moduleve me zhvillimet aktuale teknologjike është renditur tek ndërhyrjet shumë të rëndësishme.

Pjesa 8. Punëdhënësit si pjesë e ekosistemit AFP

Pjesa më e madhe e analizës së bërë në sistemin shqiptar të AFP-së evidenton se ekziston një lidhje dhe/ose pjesëmarrjen e dobët e sektorit privat. Ofruesit e AFP i konsiderojnë punëdhënësit si jo të gatshëm për t'u bërë pjesë e zhvillimit të arsimit profesional për shkak të kostos së punës dhe kohës së nevojshme për praktikantët, ndërsa shumica e përfaqësuesve të sektorit privat (duke u bazuar në gjetjet e analizës sektoriale) kanë në përgjithësi një përshtypje të keqe për AFP, por në të njëjtën kohë nuk janë të informuar në lidhje me ofertën e AFP.

Pjesëmarrja e punëdhënësve në hartimin e sistemit AFP

Kuadri aktual ligjor për arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri parashikon përfshirjen e sektorit privat në të gjitha fazat e zhvillimit të aftësive, por në realitet përfaqësimi i punëdhënësve është vetëm formal dhe këta të fundit nuk kontribuojnë në mënyrë aktive në këtë proces. Në hartimin e politikave, si përfaqësues të partnerëve socialë, punëdhënësit marrin pjesë në Këshillin Kombëtar të AFP-së dhe Këshillit Kombëtar të Punësimit.

Këto këshilla, që supozohet se duhet t'u merret mendimi për zhvillimin e politikave të aftësitë dhe punësimit, nuk mbledhen rregullisht dhe nuk ka asnjë provë për kontributin e këtyre organeve në hartimin e politikave. Megjithatë, siç konfirmohet edhe nga intervistat me informatorë kyç, ka raste të pjesëmarrjes aktive të shoqatave të punëdhënësve në hartimin e politikave, si për Strategjinë Kombëtare për Aftësitë dhe Punësim 2015-2020.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit mbledh çdo vit përmes analizës së nevojave informacione për nevojat e punëdhënësve për aftësitë me qëllim që të usheje me informacion hartimin e programeve publike për Arsimin dhe Formimin Profesional. Lista e kualifikimeve profesionale duhet përditësuar në bazë të këtij informacioni. Edhe pse informacioni i marrë me anë të këtij instrumenti është një skanim i plotë i nevojës së sektorëve për aftësi dhe punësim, në kohën kur llogariten të dhënat, nevojat mund të bëhen të vjetëruara në një mjedis dinamik. Kjo është arsyeja pse sistemi është duke u riprojektuar me ndihmën e Projektit të financuar nga SDC "Aftësi për Punësim", duke prezantuar një instrument novator për t'u ofruar vendimmarrësve të dhëna të qarta, të sakta dhe të diferencuar për nevojat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të tregut të punës, të shpallur nga drejtuesit e projektit.

Analiza sektoriale e tekstit sjell ndërmend nevojën e përditësimit të kurrikulave të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional së bashku me sektorin privat dhe sugjeron se ofruesit e AFP duhet të krijojnë ato modalitete që synojnë punonjësit e sektorit, të cilët kanë nevojë për përditësim të aftësive. Punëdhënësit marrin pjesë në hartimin e skelet-kurrikulave duke qenë pjesë e grupeve ad-hoc të krijuara nga AKAFP kur diskutohet komponenti i arsimit profesional. Me asistencën teknike të projektit RISI po prezantohet një nismë e re, Komisionet e

Aftësive të Sektorit si organe të përhershme përgjegjëse për rishikimin e kurrikulave profesionale për kualifikimet profesionale të lidhura me sektorët përkatës. Siç pohojnë drejtuesit e projektit dhe të AKAFP, nisma do të pilotohet në sektorin e turizmit.

Përfshirja e punëdhënësve në zhvillimin e institucioneve të AFP


Siç u tha më sipër, të gjitha institucionet e AFP kanë një bord ku bëjnë pjesë përfaqësues të ndryshëm, për të mbështetur zhvillimin strategjik dhe administrimin e institucionit, por këto organe kanë në përgjithësi një rol pasiv, pohim që konfirmohet nga të dhënat e vëzhgimit.

Përfshira e punëdhënësve në mësimin në vendin e punës (ofrimi i praktikës profesionale)

Në skelet kurrikulën kombëtare sugjerohet që praktika profesionale të mund të zhvillohet në ndërmarrjet vendore. Edhe pse është mjaft e dëshirueshme, kjo praktikë nuk është e zakonshme. Zyrtarët e MMSR deklarojnë se, në mënyrë ideale, bashkëpunimi trepalësh do të funksiononte nëse MMSR bëhej zyrtarisht pjesë e vendimmarrjes, por është e vështirë për shkak të mentalitetit të punëdhënësve (sidomos atyre privatë); fazës së tyre të zhvillimit dhe pasigurisë në lidhje me planet e tyre të ardhshme; vullnetit të ndërmarrjeve, gatishmërisë dhe dëshirës për të investuar në trajnimin dhe zhvillimin e stafit. Kuadri ligjor³⁷ në fuqi rregullon marrëveshjen e stazhit dhe ofron stimuj për organizatat që marrin nxënës të AFP, por zbatimi i kësaj VKM-je është ende në nivel

37 Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 500, datë 22.05.2013 <http://www.vet.al/files/ligje%20etj/VKM%20500%20dt%2022%205%202013%20Per%20praktikat0001.pdf>

Figura 54: Karakteristikat e praktikës profesionale në mjedisin e biznesit




tepër të ulët.

Analiza më e fundit e praktikave mësimore në vendin e punës në sistemin e AFP në Shqipëri (Aliko, 2015) zbuloi se ka disa anomali në këtë proces dhe se cilësia apo rezultatet e mësimit janë të diskutueshme. Më konkretisht, (i) ngarkesa mësimore përcaktuar për modulet praktike është e

kufizuar; (ii) shpesh ajo bëjnë/përfshihen nxënësit në mjediset e biznesit nuk përkon me përmbajtjen e modulit të praktikës dhe objektivat e të mësuarit; (iii) punëdhënësit nuk kanë stafin e nevojshëm të trajnuar për të kryer detyrën e mbikëqyrësve dhe këshilluesve dhe shumë shpesh "imponojnë" strategjinë e tyre të trajnimit; (iv) praktika profesionale organizohet kryesisht e

Figura 55: Përgjegjësia për praktikën profesionale në shkollat e arsimit profesional



shpërndarë në 1-2 ditë në javë dhe nuk lejon përfshirjen progresive të nxënësit. Organizimi i praktikës tek bizneset në një bllok prej rreth 4-5 javësh do të ishte më efektive, por shkollat kanë vështirësi në arritjen e një marrëveshjeje të tillë me pjesën tjetër të moduleve dhe lëndëve; (v) vlerësimi i nxënësve për modulet e praktikës duhet të bëhet nga biznesi, por nuk janë hartuar dhe vendosur procedura formale për këtë gjë; (vi) ka diskriminim mes nxënësve – më të mirët dërgohen në bizneset më të mira, ka edhe raste të nxënësve me rezultate të dobëta që nuk dërgohen fare për praktikë në biznese, por e kryejnë modulën e praktikës në shkollë; (vii) ka një dallim mes ofruesve për mënyrën e realizimit të modulit të praktikës, edhe pse certifikata e nxënësve që jepet është e njëjtë; (viii) ka raste që nxënësit shfrytëzohen për punë informale; dhe (ix) rritja me shpejtësi e regjistrimit në AFP ka penguar mundësinë dhe cilësinë e të mësuarit në vendin e punës.


Sipas mendimit të nxënësve që morën pjesë në këtë vëzhgim, modulet e praktikës profesionale zhvillohen kryesisht në shkollë, e njëjtën gjë është edhe për kursantët. Edhe pse mësuesit dhe instruktorët japin një pamje

më optimiste të realitetit, 50% e mësuesve dhe 45% e instruktorëve deklarojnë se modulet e praktikës bëhen tek biznese dhe në shkollë/qendër. Analizat sipas sektorit tregojnë se profilet TIK dhe të tekstilit i zhvillojnë modulet e praktikës përgjithësisht në shkollë, ndërsa profilet e turizmit dhe ndërtimit duket se kanë një ekuilibër më të mirë të praktikës mes biznesit dhe shkollës.

Shkollat dhe qendrat bashkëpunojnë kryesisht me firmat private për praktikën profesionale. Shkolla profesionale bashkëpunojnë edhe me ndërmarrjet publike. Gjatë vitit të kaluar, MMSR nënshkroi marrëveshje për praktikat dhe stazhin e nxënësve me Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, Ministrinë e Mbrojtjes, Departamentin e Administratës Publike (për kursantët në bashki), me ndërmarrjet e kanalizimeve dhe menaxhimit të mbetjeve, Bankën e Shqipërisë, etj., edhe pse, siç artikullohet nga zyrtarët e MMSR të intervistuar, pas grupit të parë të nxënësve, gatishmëria e ndërmarrjeve publike për bashkëpunim ka rënë.

Përgjegjësia për marrëveshjet me biznesin

Figura 56. Sa të kënaqur janë nxënësit me praktikën profesionale?



Burimi: Pyetësori i nxënësve


në lidhje me modulet praktike që ofrohen në formën e të mësuarit në vendin e punës ndryshon sipas institucioneve të ndryshme. Opsionet më të shpeshta në shkollat profesionale janë që mësuesit e praktikës profesionale (36,53%), ose një instruktor i caktuar për këtë gjë (28,31%) të jenë përgjegjës për të mësuarit në vendin e punës. Në vetëm 16% të rasteve, mësuesit deklarojnë se ekziston një strukturë përgjegjëse ose një pozicion në shkollë për këto marrëveshje, ndërsa në qendrat e formimit profesional pothuajse 68% e instruktorëve thonë se kjo strukturë është e ngritur në qendrën e tyre. Në përgjithësi, qendrat e formimit profesional janë më të lidhura me bizneset, sepse ato punojnë ngushtë me zyrat e punësimit dhe kanë mundësinë të lidhen me punëdhënësit lokalë.

Nxënësit/kursantët dhe mësuesit/instruktorët u pyetën për aspekte të ndryshme të mësimit në vendin e punës dhe më poshtë jepen të analizuarat perspektivat e tyre të ndryshme si dhe larmia mes profileve dhe modalitetet.

Aspekti i të mësuarit në vendin e punës me të cilin nxënësit janë më shumë të kënaqur është mbikëqyrja e instruktorëve dhe mundësia për t'u përfshirë në aktivitete praktike në mjedisin e biznesit. Profili i TIK-ut vlerëson më ulët të gjitha aspektet e të mësuarit në vendin e punës. Ky profil u zbatua në nivel kombëtar në vitin 2010 në 12 shkolla profesionale dhe marrëdhëniet me bizneset kanë ende rrugë përpara për t'u zhvilluar, veçanërisht në qarqet jashtë Tiranës, ku sektori nuk është shumë i zhvilluar. Profili i tekstilit vlerësohet më shumë në pjesën më të madhe të dimensioneve, ndjekur nga turizmi dhe ndërtimi.

Nxënësit e tekstilit janë më të kënaqur me rolin e instruktorëve si mbikëqyrës dhe mentor në mjedisin e biznesit dhe me atë që bën shkolla për të gjetur një vend praktike për ta. Kjo mund të jetë si rezultat i numrit të vogël të nxënësve në krahasim me profilet e tjera dhe gatishmërinë që kanë firmat e sektorit privat për të marrë nxënës për praktikë. Si profili i tekstilit ashtu edhe ai i turizmit ofrohen kryesisht në shkollat e asistuar nga Projekti AlBiz që ka futur pozicionin e PASO-s, i cili mbulon lidhjet me bizneset.

Figura 57. Fakte për praktikën profesionale në AFP



Burimi: Pyetësori i mësuesve dhe instruktorëve

Analiza sipas sektorit zbulon se ekziston një bashkëpunim i lartë mes ofruesve të AFP dhe ndërmarrjeve në tekstile dhe veshje, të cilat caktojnë stafin përgjegjës për praktikantët apo nxënësit gjatë praktikës. Kjo mund të shpjegojë kënaqësinë e lartë të nxënësve me këshillimin në mjedisin e biznesit. Mes shembujve të mirë për nxitjen e të mësuarit në vendin e punës në sektor është edhe firma NABER. Kjo firmë është e përfshirë në të gjitha nivelet e zhvillimit të arsimit profesional, duke filluar që nga hartimi i kurrikulave, ofrimi i AFP-së duke marrë nxënës për punë praktike, duke ndihmuar institucionet me materialet e konsumit dhe së fundi duke treguar gatishmërinë për të punësuar të diplomuarit.

Në sektorin e turizmit, kapacitetet e institucioneve për futjen e të mësuarit në vendin e punës po rriten në kuadër të Projektit Erasmus+ "Skemat e Praktikës për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri" që synon të fusë sistemin e dyfishtë në sektorin e turizmit me anë të pilotimit të nismës në shkollën Hoteleri-Turizëm në Tiranë dhe në QMF të Kamzës. Siç deklarojnë drejtuesit e projektit në intervistat me informatorët kyçë, sektori ka treguar një rritje interesi, veçanërisht ndërmarrjet e mëdha në hoteleri.

Opinionin e mësuesve dhe instruktorëve për praktikën profesionale mund të jetë i dobishëm për të identifikuar pikat më të rëndësishme të zhvillimit të praktikës profesionale si një aktivitet i rëndësishëm për zhvillimin e aftësive të nxënësit dhe kursantëve në arsimin dhe formimin profesional. Për të dy kategoritë, institucionit i AFP nuk i mbulon shpenzimet e sigurimit të nxënësve apo kursantëve. Ky sigurim është i detyrueshëm dhe kërkohet nga autoritetet shtetërore sipas kuadrit ligjor për sigurinë në punë dhe paguhet në të shumtën e rasteve nga vetë nxënësit, duke rritur kështu koston e edukimit/trajnimit të tyre. Për më tepër, rregullorja e fundit për marrëdhëniet e punës

kërkon që edhe kursantët apo nxënësit gjatë praktikës profesionale të deklarohen në zyrën e taksave dhe sistemin e sigurimeve shoqërore dhe ndërmarrja duhet të paguajë për sigurimet shoqërore. Kjo ka ndikuar në rënien në mënyrë dramatike të numrit të nxënësve që bëjnë praktikë tek bizneset.³⁸


Ndërgjegjësimi i biznesit evidentohet si problematik në arsimin profesional, ndërsa në QFP duket se situata është më optimiste. Pothuajse 82% e instruktorëve deklarojnë se bizneset i mirëpresin kursantët për praktikat e biznesit. Në qendrat e formimit profesional, siç u tha më parë, institucioni është përgjegjës për koordinimin e praktikës profesionale, ndërsa në shkollat kjo mbulohet nga mësuesit të praktikës profesionale. Si mësuesit ashtu edhe instruktorët deklarojnë se niveli i frekuentimit është i lartë dhe kjo mund të jetë edhe si rezultat i faktit se praktika profesionale është e detyrueshme.

Mendime të nxënësve dhe kursantëve për zgjedhjen e AFP

Nxënësit dhe kursantët u pyetën nëse do të bënin përsëri të njëjtën zgjedhje nëse u ofrohej mundësia për një fillim të ri. Shumica absolute e pjesëmarrësve në vëzhgim rikonfirmuan zgjedhjen e tyre në sistemin e AFP-së, ku kursantët janë më në avantazh. Bie në sy fakti se nxënësit, edhe pse me një predispozicionin të madh për t'u orientuar drejt AFP-së, nuk do të bënin gjithmonë të njëjtin zgjedhje për sa i përket institucionit apo të njëjtit profil. Rreth 13% e nxënësve "pro AFP-së" nuk janë të kënaqur me atë që është duke bërë institucioni për zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe rreth 8% nxënësve janë të gatshëm të zgjedhin një

38 Gjetjet u prezantuan në seminarin "Për Konsultimin e Udhërrëfyesit për Zbatimin e Skemës së Praktikës në arsimin e mesëm profesional në Shqipëri", Ministria e Arsimit dhe Sportit, 16 dhjetor 2015

Figura 58. Nëse do të mund të filloje nga e para a do të kishe bërë të njëjtën zgjedhje?



tjetër profil. Nxënësit e profilit të ndërtimit kanë më pak gjasa për të zgjedhur përsëri rrugën e AFP, ndërsa nxënësit e tekstilit janë më të gatshëm për të konfirmuar zgjedhjen e tyre për një formim profesional. Kursantët mendohet se janë shumë më të kënaqur me QFP në krahasim me nxënësit, pasi 91% e tyre do të zgjidhnin përsëri të njëjtin ofrues në krahasim me 69% të nxënësve. Nxënësit e profilit TIK janë më pak të kënaqur me institucionin e tyre krahasuar me kategoritë e tjera të nxënësve. Mes nxënësve, ata të degës së turizmit mendohet të jenë më të kënaqur me shkollën e tyre dhe shumë më të kënaqur me profilin që kanë zgjedhur. Edhe pse kanë një predispozicion të lartë për AFP, nxënësit e tekstilit janë më pak të kënaqurit me profilin e zgjedhur. Rreth 40% e tyre do të zgjidhni një tjetër profil të AFP-së, nëse u ofrohej mundësia.

Pjesa 9. Përfundime

Arsimi dhe formimi profesional është prioritet kombëtar në Shqipëri dhe sistemi është në reformim që nga viti 2012, me qëllimin përfundimtar që t'i shërbejë tregut të punës dhe nevojave sociale. MMSR me institucionet e saj vartëse dhe partnerët udhëhiqen nga Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, duke bashkërenduar politikat për arsimin profesional, formimin profesional dhe punësimin. Po hartohet një ligj i ri për AFP, i cili do të parashikojë vizionin për këtë sistem gjithëpërfshirës.

Me përmirësimin e sistemit të AFP po trajtohet efikasiteti i brendshëm dhe elementët e jashtëm të efektivitetit që ndikojnë në cilësinë e AFP. Sektori privat në këtë reformë konsiderohet si partner strategjik dhe po nxitet që të ketë një rol më aktiv në të gjitha fazat e zhvillimit të aftësive profesionale, që nga hartimi i politikave të AFP-së në ofrimin e arsimit dhe formimit profesional me qëllim që t'u sigurojë punësim të diplomuarve.

Aktualisht, kualifikimet profesionale në Shqipëri mund të përfitohen zakonisht duke ndjekur programet e arsimit profesional apo kurse të formimit profesional, dhe në raste të rralla duke aplikuar për njohjen e diplomave të fituara jashtë vendit. Njohja e të nxënësve informal dhe joformal të mëparshëm nuk është realizuar ende. Plani afatmesëm i MMSR është të racionalizojë rrjetin e institucioneve ofruese të AFP nga 52 në rreth 13 të quajtura si "shkolla të ekselencës", që do të jenë institucione me një status autonomie më të madhe, duke ofruar një larmi më të mirë programesh dhe kursesh afatshkurtra të arsimit profesional.

Në total ka 12 drejtime profesionale, 29 profile dhe 20 kurse afatshkurtra që përgatitin punonjës të kualifikuar për profilet profesionale në sektorët e teknologjisë së

informacionit dhe komunikimit, ndërtimit, turizmit dhe tekstilit. Për shkak të numrit të vogël të nxënësve të regjistruar në çdo drejtim dhe burimeve të kufizuara njerëzore dhe infrastrukturore, janë zgjedhur vetëm 20 nga 29 profile, disa prej tyre më të kërkuar nga sektorët ekonomikë përkatës.

Kurrikula e AFP përbëhet nga arsimi i përgjithshëm dhe profesional me pjesën e fundit të organizuar në një strukturë modulare dhe në bazë të rezultateve të të nxënësve. Duke siguruar zhvillimin e aftësive profesionale nëpërmjet kurseve afatshkurtra dhe duke pasur parasysh një kurrikulë më pak komplekse dhe më të decentralizuar, qendrat e formimit profesional përballen me më pak sfida krahasuar me arsimin profesional. Kurrikula e shkollave profesionale thuhet se ka nevojë për ndërhyrje në përmbajtjen dhe formën e saj, në mënyrë ajo të bëhet më e absorbueshme për nxënësit e arsimit profesional. Pjesëmarrësit presin një rritje të orëve të praktikës profesionale (sidomos nxënësit e TIK), të cilat të realizohen pranë mjediseve të biznesit (opinionit i mësuesve).

Ka një larmi të madhe mes personelit akademik të përfshirë në AFP. Trajnimi dhe kualifikimi bien dhe përvoja në industri rritet, kur kalojnë nga mësues i arsimit të përgjithshëm tek ai i teorisë profesionale, praktikës profesionale dhe instruktorë në fund. Mësuesit/instruktorët me përvojë industriale, të kualifikuar dhe më të përgatitur perceptohen nga nxënësit se e kryejnë më mirë punën. Sipas sektorëve, nxënësit e TIK janë më pak të kënaqurit dhe ata të tekstileve janë më të kënaqurit. Mësuesit mbulojnë nga 1 deri 4 lëndë dhe nuk ka asnjë ndarje të qartë për llojin e lëndëve që japin mësim. Si rezultat i shfrytëzimit të efektshëm (ndonëse jo gjithmonë efikas) të burimeve njerëzore janë raportuar raste të mësuesve që mbulojnë lëndë nuk kanë të bëjnë me kualifikimin e tyre. Pjesa më e madhe e mësuesve të arsimit profesional

deklarojnë nevojën për një përditësim të trajnimit pranë biznesit.

Është rritur niveli i përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të kontrollit të njohurive në arsimin profesional krahasuar me formimin profesional, por raportohet në përgjithësi edhe aplikimi në masë të madhe i metodave tradicionale. Folësit e ftuar nga sektori privat përdoren më pak duke u kufizuar nxënësve mundësitë për zgjerimin dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre dhe duke evidentuar faktin se institucionet ofruese të AFP janë disi të izoluara dhe kanë nivel të ulët të rrjetëzimit. Detyra e projektit përdoren kryesisht në profilin e turizmit dhe ndërtimit; e njëjta gjë vlen për demonstrimet, shembujt praktik dhe punën në grupe. Mësuesit dhe instruktorët i konsiderojnë të mësuarit në grupe të vogla dhe detyrat e projektit si disa nga metodat më efektive të mësimdhënies.

Mësuesit dhe instruktorët raportuan se përdorin një shumëllojshmëri burimesh për marrjen e materialeve mësimore, veçanërisht mësuesit e teorisë profesionale. Mësuesit e arsimit profesional përdorin më shumë materiale nga AKAFP, ata të arsimit të përgjithshëm përdorin tekstet shkollore, ndërsa instruktorët japin si mësim shënime që kanë përgatitur vetë për mësimin dhe përdorin materiale nga interneti. Mësuesit e praktikës profesionale përdorin kryesisht materiale mësimore të vetë-përgatitura, por duke pasur parasysh nivelin e tyre të kualifikimit (më e ulëta mes mësuesve të arsimit profesional), ngritja e kapaciteteve dhe prezantimi i burimeve alternative të informacionit kanë rëndësi tepër të madhe.

Literatura e huaj dhe materialet mësimore nga kolegët raportohen si burimet më pak të përdorura. Nxënësit dhe kursantët raportojnë shënime të mësimi dhe tekstet shkollore si materialet më të përdorura për mësim. Nxënësit e profilit të TIK kanë një normë

më të lartë të përdorimit të materialeve nga interneti. Nxënësit e ndërtimit dhe tekstilit përdorin tekstet shkollore. Ata të turizmit përdorin kryesisht shënime që marrin gjatë orës së mësimi.

Pajisjet dhe mjetet e përdorura për praktikën profesionale u evidentuan nga të gjithë të anketuarit se kanë nevojën më të madhe për ndërhyrje mes një sërë faktorësh që lidhen me ofrimin e arsimit dhe formimit profesional. Nevojat e tjera për përmirësim që lidhen me infrastrukturën ishin baza e punës prodhuese dhe kushtet laboratorike (opinion i mësuesve) dhe klasat (opinion i nxënësve). Kushtet infrastrukturore janë më problematike në profilin e tekstilit, për sa i përket të gjitha dimensioneve përkatëse, ndjekur nga hoteleri-turizmi, ku kjo e fundit evidenton mangësitë në bazën materiale të mësimi, numrin e nxënësve për klasë dhe laboratorët si çështjet më problematike. Profili i ndërtimit është më në avantazh në lidhje me infrastrukturën.

Niveli i burimeve financiare dhe njerëzore si dhe i autonomisë akademike i institucioneve ofruese të AFP është kryesisht i ulët, por ndryshon mes shkollave dhe QFP-ve, ku këto të fundit duket se janë në avantazh. Ofruesit e AFP, sidomos shkollat e arsimit profesional, funksionojnë në përgjithësi si institucione të izoluara dhe rrjetëzimi i tyre me aktorët lokalë apo ofruesit e tjerë është mjaft i ulët. Bordet e administrimit të shkollave janë kryesisht formalë dhe vetëm në disa shkolla të përzgjedhura është caktuar një mësues përgjegjës për marrëdhënie me bizneset, edhe pse rrallëherë ka ndonjë reduktim të ngarkesës mësimore që këta mësues të kryejnë këtë detyrë specifike.

Modulët e praktikës profesionale zhvillohen kryesisht në mjediset e institucionit ofrues të AFP-së. Këta të fundit zakonisht bashkëpunojnë me firmat private edhe pse ka nisma dhe raste të marrëveshjeve të

nënshkruara edhe me ndërmarrje të mëdha publike. Në përgjithësi, QFP, duke punuar ngushtë me zyrat e punësimit, janë më të lidhura me bizneset. Nxënësit janë më të kënaqur me mbikëqyrjen nga mësuesit/instruktorët dhe me mundësinë për t'u përfshirë në aktivitete praktike në mjedisin e biznesit. Profili i TIK renditet më i ulëti në të gjitha aspektet e të mësuarit në vendin e punës, ndërsa nxënësit e tekstitil janë përgjithësisht më të kënaqur në këtë drejtim. Mësuesit dhe instruktorët raportojnë se institucioni i tyre nuk i mbulon shpenzimet e praktikës profesionale. Ndërgjegjësimi i biznesit evidentohet si problematik në arsimin profesional, ndërsa në QFP situata se duket është më optimiste.

Edhe pse kanë prirjen për t'u orientuar drejt AFP-së, nxënësit e arsimit profesional nuk do të zgjidhnin gjithmonë të njëjtin institucion ofrues apo të njëjtin profil. Nxënësit e ndërtimit janë më pak të prirur të zgjedhin rrugën e AFP-së përsëri, ndërsa ata të tekstitil janë më të gatshëm të rikonfirmojnë zgjedhjen e tyre për kualifikimin profesional, por jo për profilin. Kursantët mendohet të jenë më shumë të kënaqur me QFP krahasuar me nxënësit. Nxënësit e turizmi janë më të kënaqur me ofruesin dhe shumë më të kënaqur me profilin që kanë zgjedhur. Nxënësit e profilin TIK në përgjithësi janë nxënësit më pak të kënaqur me atë që ofron institucioni i tyre arsimor. Duke qenë me rezultate të larta, ata kanë pritshmëri më të mëdha për sa i përket cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave dhe infrastrukturës.

Rritja e numri të regjistrimeve në AFP ka qenë një nga objektivat kryesore të të gjitha strategjive për arsimin dhe formimin profesional. Gjithsesi, AFP mbetet një mundësi jo-tërheqëse arsimimi në Shqipëri. Për këtë, duhet marrë parasysh bashkëveprimi i disa faktorëve duke filluar nga faktet dhe shifrat dekurajuese,

paragjykimet dhe stereotipet në AFP, deri tek publiciteti (ndonjëherë) kundër-produktiv për ofertën e AFP-së. Ekziston një stereotip i fortë për të gjithë gjinitë dhe grupmoshat, qarqet dhe sektorët se AFP është arsimim i "dorës së dytë"; i përshtatshëm për nxënësit e dobët dhe 'problematike'; me kurrikulë të ngushtë dhe të varfër; që ofron pak mundësi për punë të mirë; dhe që ofron pak ose aspak jetë social-kulturore për nxënësit për shkak të ndarjes së thellë gjinore. Si rezultat nxënësi tipik i AFP-së në Shqipëri vjen nga bota e zakonshme fshatare dhe mashkullore. AFP nuk rezulton të ketë përfshirë minoritete, edhe pse shumica e nxënësve të arsimit dhe formimit profesional vijnë nga familje të varfra, që kanë pasur pak mundësi për arsim cilësor në vitet e para të jetës.

Zgjedhja e arsimit profesional si alternativë arsimimi është e vështirë duke pasur parasysh edhe faktin se vendimi lidhet menjëherë me zgjedhjen e një orientimi dhe një profesioni në moshë fare të re në jetë (kur nxënësi sapo ka mbushur 15 vjeç). Vështirësitë apo paqartësitë në këtë aspekt kanë të bëjnë me dobësinë/mungesën e programeve dhe/ose shërbimeve të orientimit të profesionit që të mbulojnë pikërisht këto kategori të rinjsh. Në përgjithësi, burimi i parë i informacionit mes nxënësve të AFP-së është lënda e orientimit të karrierës, ndërsa për kursantët burimi më dominues janë miqtë dhe të afërmit. Burimi i dytë më i rëndësishëm mes pjesëmarrësve raportohet të jenë zyrat e punësimit, një faktor që lidhet vetëm me kursantët e formimit profesional dhe që nuk ka të bëjë me nxënësit e arsimit profesional. Nga ana tjetër, zgjedhja e profilin udhëhiqet kryesisht nga "mundësitë për të fituar më shumë të ardhura" (veçanërisht në ndërtim). Turizmi është më tërheqës, për shkak se programi i tij perceptohet nga nxënësit si interesant. Ndërsa për profilet e TIK dhe tekstitil, është talenti/interesi ai që mbizotëron mes të gjithë faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen

e tyre. Është me interes të evidentohet se për kursantët faktori me më shumë ndikim në zgjedhjen e profilit/kursit konsiston në përmbajtjen e moduleve të kursit dhe mundësisë për të ushtruar profesionin, gjë që pretendohet të jetë më i larmishëm në programet qendrave të formimit profesional.

Çështjet e mundësive të barabarta shqyrtohen edhe nga perspektiva e nxënësve dhe mësuesve. Përtej ndarjes së thellë gjinore sipas sektorëve dhe profileve, sistemi mendohet se ofron mundësi të barabarta të kufizuara për pranimin dhe përparimin brenda tij. Mundësitë e barabarta vështirësohen nga një sërë treguesish socialë. Paaftësia dhe qarku perceptohen si baza kryesore për pabarazinë e mundësive. Ndërtimi ka një incidencë më të lartë duke iu referuar të gjithë treguesve. Në veçanti, në ndërtim, pengesat më të mëdha për pranimin dhe përparimin raportohen të jenë paaftësia dhe gjendja ekonomike e familjes. Përkatësia fetare zë vendin e parë si bazë për pabarazi ndaj mundësive për përparim në ndërtim. Në profilin e TIK mbizotërojnë gjendja ekonomike dhe përkatësia fetare si në pikën e pranimin ashtu edhe në aspektin e përparimit pas regjistrimit në shkollë. Gjinia bëhet e një rëndësie parësore vetëm kur marrim parasysh tekstilin dhe turizmin. Në të dy këto profile, gjinia është faktor i rëndësishëm si bazë e pabarazisë për t'u pranuar në shkollë dhe për të përparuar në të. Është interesant konstatimi se përkatësia fetare vazhdon të jetë faktori i dytë më i rëndësishëm për profilin e tekstilit dhe atë të turizmit. Edhe pse hulumtimet e mëparshme kanë studiuar pabarazitë e bazuara tek përkatësia gjinore, paaftësia dhe gjendja ekonomike, përkatësia fetare evidentohet për herë të parë si faktor i rëndësishëm që duhet të trajtohet.

Për sa i përket aksesit të përgjithshëm në teknologji, është evidentuar një tendencë e aksesit të pabarabartë të teknologjisë mes

shkollës dhe mjedisit të familjes. Tek të gjithë sektorët, kjo mospërputhje e aksesit është më e theksuar tek nxënësit e sektorit të ndërtimit. Megjithatë, në përgjithësi, nxënësit janë jashtëzakonisht të lidhur me teknologjinë duke përdorur rregullisht telefonat e tyre inteligjentë, internetin, rrjetet sociale dhe aplikacionet e komunikimit.

Në lidhje me përdorimin specifik të teknologjisë për qëllime mësimnxënije/ mësimdhënieje, në përgjithësi, institucionet ofruese të AFP janë institucione me përdorim mesatar në të ulët të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe interneti përdoret shumë pak për qëllime mësimore në klasë apo laboratorët përkatëse. Pjesa më e madhe e nxënësve e përdorin internetin për të bërë detyrat e tyre dhe për të komunikuar në mënyrë elektronike me mësuesit apo nxënësit e tjerë. Variacioni në të gjithë sektorët tregon se nxënësit në TIK kanë më shumë gjasa të përdorin internetin për studim, ndjekur nga nxënësit në sektorin e turizmit. Për më tepër, përdorimi i programeve të veçantë kompjuterike të lidhura me profilin e tyre profesional mbetet i kufizuar. Në klasa, shumica e mësuesve raportojnë se kompjuterët, laptopët, dhe video-projektorët përdoren më shpesh, në krahasim me teknologjitë e reja të tilla si tableta, smartboards dhe telefonat smart që kanë përdorim relativisht të ulët për mësimdhënie dhe që do të duhet ende kohë që ato të përdoren në mënyrë masive.

Megjithatë ekziston një interes në rritje për të mësuarit të përzier mes mësuesve e instruktorëve të AFP. Pjesa më e madhe e mësuesve të anketuar janë shumë optimistë për ndikimin pozitiv të teknologjisë në punën e tyre dhe në rezultatet profesionale të nxënësve të tyre. Në lidhje me efektivitetin e perceptuar të metodave të ndryshme të mësimdhënies, mësuesit duket se i konsiderojnë metodat e reja të mësimdhënies si më efektive sesa ato tradicionale. Pjesa

më e madhe e mësuesve e perceptojnë mësimdhënien në grupe të vogla dhe punën me projekt si shumë efektive. Për më tepër, kombinimi i të mësuarit tradicional në klasë me mësimdhënien dixhitale pritet të jetë efektive. Gjithsesi, instruktorët duket se janë më rezistente ndaj metodave të reja të mësimdhënies në krahasim me mësuesit. Ata priren të argumentojnë se media dixhitale mund të jetë më efektive nëse përdoret si material mbështetës mësimor ose për qëllime ilustrimi dhe se janë më të gatshëm të pranojnë metodat e personalizuar të mësimdhënies të përshtatur me aftësitë e kursantëve. Mësimi në distancë, nga ana tjetër, si një tjetër metodë mësimdhënieje e bazuar në teknologjinë e informacionit, perceptohet si metodë më efektive e mësimdhënies nga mësuesit dhe instruktorët.

Gjetjet në lidhje me hyrjen në tregun e punës dhe punësimin e të diplomuarve janë shumë të ngjashme mes nxënësve dhe kursantëve. Dallimi kryesor qëndron në synimet për të kërkuar punë pas diplomimit. Ndërkohë që kursantët kanë më shumë gjasa të kërkojnë punë pas mbarimit të kursit, nxënësit e arsimit profesional priren më shumë të planifikojnë vazhdimin e studimeve në nivele më të larta të arsimit profesional apo në universitet. Grupi që synon të vazhdojë studimet është më i lartë tek nxënësit e TIK, ndërsa ata që planifikojnë të kërkojnë punë janë nxënësit e sektorit të ndërtimit. Mësuesit/instruktorët mendojnë se nxënësit/kursantët që ndjekin studimet/kurset në shkollat/qendrat e tyre të kenë njohuri të mjaftueshme për të filluar punë në profesionin e tyre pas përfundimit të AFP-së, dhe një pjesë edhe më e madhe e tyre thonë se të diplomuarit janë të pajisur me njohuritë përkatëse në nivel shkolle/qendre e arsimit profesional. Sipas mendimit të mësuesve dhe instruktorëve, niveli i njohurive profesionale, fusha e specializimit dhe profili, niveli i aftësive praktike si dhe disiplina në punë janë zgjedhur si faktorët

më të rëndësishëm për mundësi më të mira për të hyrë në tregun e punës. Instruktorët theksojnë edhe rëndësinë e njohurive të përgjithshme, aftësive të komunikimit dhe të gjuhëve të huaja.

Të diplomuarit e arsimit profesional kanë pritshmëri për mundësi më të mira punësimi dhe vetëpunësimi në krahasim me shokët e tyre të arsimit të përgjithshëm. Mundësia është më e lartë në sektorët e TIK dhe turizmit, ndërsa nxënësit në sektorin e tekstilit kanë rezultatin më të ulët. Periudha e tranzicionit nga shkolla në punë pritet, në përgjithësi, të jetë e gjatë. Nxënësit mendojnë se duhet të presin një vit ose më shumë si periudhë tranzicioni janë ata të tekstilit, ndërtimit dhe TIK-ut.

Nxënësit e AFP ndahen pothuajse në mënyrë të barabartë mes alternativave për të punuar në një institucion/ndërmarrje publike, në ndërmarrje private, apo për të hapur biznesin e tyre, ndërkohë që pjesa më e madhe e kursantëve shpresojnë të punësohen në sektorin privat. Për nga pritshmëritë sipas profilit, të diplomuarit e tekstilit kanë më shumë gjasa të nisin biznesin e tyre, nxënësit në turizëm shpresojnë të punojnë në ndërmarrjet private dhe nxënësit e TIK mendojnë se kanë më shumë gjasa të punësohen në ndërmarrje publike.

Burimet kryesore të informacionit mbi mundësitë e punësimi janë mësuesit e praktikës dhe instruktorët në qendrat profesionale, miqtë dhe të afërmit dhe drejtuesit e shkollës/qendrës së formimit profesional. Zyrat e karrierës nuk konsiderohen si burim efektiv informacioni. Informacioni i dhënë në nivel shkolle/qendre për mundësitë e punësimi të të diplomuarve të ardhshëm perceptohet si i mjaftueshme për nxënësit dhe kursantët dhe si më i përshtatshëm në sektorin e turizmit dhe ndërtimit.

Sipas mendimit të mësuesve dhe instruktorëve, niveli i njohurive profesionale, fusha e specializimit dhe profili, niveli i aftësive praktike si dhe disiplina në punë janë zgjedhur si faktorët më të rëndësishëm për mundësi më të mira për të hyrë në tregun e punës. Instruktorët priren t'i më shumë rëndësi njohurive të përgjithshme, aftësive të komunikimit dhe të gjuhëve të huaja në krahasim me rëndësinë që u japin atyre mësuesit.

Nxënësit dhe kursantët kanë zgjedhur si faktor më të rëndësishëm për përmirësimin e punësimit të tyre mjetet dhe pajisjet më të mira të punës. Ndër faktorët tjerë janë më shumë orë praktike, praktika më të gjata në mjedisin e biznesit, më shumë mësues të kualifikuar dhe metodat më të mira të mësimdhënies. Kursantët kanë rekomanduar edhe një bashkëpunim më të mirë të qendrave profesionale me zyrat e punësimit dhe karrierës, ndërsa nxënësit e TIK dhe tekstitil kanë evidentuar edhe përdorimin e kompjuterëve dhe teknologjisë. Mësuesit dhe instruktorët i konfirmojnë këto rekomandime dhe shtojnë se organizimi i më shumë aktiviteteve në bashkëpunim me bizneset, përmirësimi i infrastrukturës së shkollës dhe i bazës materiale dhe më shumë orë praktikë në mjedisin e biznesit do të përmirësonin më shumë mundësitë e punësimit. Ata rekomandojmë edhe programe më të orientuara drejt profesione të veçanta. Një rekomandim interesante është shtimi i lëndëve/njohurive për sipërmarrjen, hapja e bizneseve dhe administrimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Për të përputhur kurrikulën shkollore me nevojat e tregut të punës, mësuesit kanë evidentuar organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me bizneset si metodën më efektive. Përshtatja e kurrikulave për t'u përputhur me nevojat e tregut rajonal të punës dhe shqyrtimi i tyre me bizneset

lokale u përzgjedhën si mënyra të tjera mjaft efektive. Instruktorët konsiderojnë efektive edhe mundësinë për të përshtatur programet e trajnimit nga kurse të suksesshme brenda dhe jashtë vendit. Mësuesit dhe instruktorët i konsiderojnë si të paefektshme vendimet që merren nga bordet e shkollës/qendrës për programin mësimor.

Sa i përket infrastrukturës, përmirësimi i kushteve të bazës prodhuese dhe atyre laboratorike konsiderohet për ndërhyrje më urgjente. Edhe trajnimet e vazhdueshme të mësuesve janë zgjedhur si ndër më të rëndësishmet. Autonomia e shkollës, kushte laboratorike, mjetet dhe pajisjet e përdorura në praktikë, numri i nxënësve për klasë, kushtet e punës të mësuesve, mundësitë e mësuesve për trajnime të vazhdueshme, përputhshmëria e moduleve me teknologjinë aktuale, dhe përputhja e programeve me nevojat e tregut të punës kanë rezultuar si fusha që kanë shumë nevojë të përmirësohen. Më pak përmirësim nevojitet për ndërtesat e shkollës, kushtet e klasës, dhe për personalizimin e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e nxënësve. Edhe përputhja e moduleve me zhvillimet aktuale teknologjike është evidentuar tek ndërhyrjet shumë të rëndësishme, sidomos për qendrat multifunksionale.

Referencat

- Aliko, I., (2015), "Evaluation of work based learning existing models in secondary and post-secondary VET in Albania", Tirana, National Agency for VET and Qualifications
- CEDEFOP (2012), "From education to working life - The labor market outcomes of vocational education and training", Luxembourg, Publications Office of the European Union
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) (2016), "Road Map to Human Resources (HR) Management of public VET Providers in Albania 2015 – 2020", unpublished report
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) and European Training Foundation (2014), "Baseline Survey of Public VET Providers in Albania", accessed in January 2016 at: http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/ALB-Report-Survey-Public-VET-Provider_20_06_14_FINAL.pdf
- Dibra S. (2015), "Albanian public VET providers' Managerial Capacity Assessment", Tirana, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
- Dibra, S (2015), "Financing Albanian Public VET System - Current status, challenges and solutions", European Training Foundation, accessed March 2016 at: [http://www.etf.europa.eu/webatt.nsf/0/E7D1021B356DA576C1257E9D00334D27/\\$file/Financing%20the%20public%20VET%20system%20in%20Albania.pdf](http://www.etf.europa.eu/webatt.nsf/0/E7D1021B356DA576C1257E9D00334D27/$file/Financing%20the%20public%20VET%20system%20in%20Albania.pdf)
- European Albania Alliance (2013), "Albanian Government Program 2013-2017", Council of Ministers of Albania, accessed in January 2016 at: http://www.akti.gov.al/dokumenta/programi_qeverise_2013_2017.pdf
- MMSR, (2014), "National Employment and Skills Strategy 2014-2020", Tirana, Ministry of Social Welfare and Youth, accessed in January 2016 at: http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Strategjia_per_Punesim_dhe_Aftesim_2014-2020.pdf
- Nano, D., (2015), "Compendium of the National Vocational Skills Development, ZHAP Puzzle", Tirana, Swiss Development Cooperation
- National Employment Service (2015), "Statistics 1998-2014", accessed in January 2016 at: <http://www.kerkojpune.gov.al/www.kerkojpune.gov.al/publikime-shkp/>

Shtojcat

Shtojca I: TIK dhe Mjetet/ Media e Lëvizshme në AFP

Në përgjithësi, ofruesit e AFP janë institucione që përdorin mesatarisht ose pak teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për administrimin e institucionit dhe për qëllime të mësimdhënies e mësimnxënies. Në shqyrtimin e literaturës nuk evidentohen raste të shkollave/qendrave që përdorin pajisjet e lëvizshme apo median sociale për qëllime të të mësuarit.

Infrastrukturë TIK

Kushtet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit e ofruesve të AFP ndryshojnë, sidomos në shkollat profesionale, ku ofrohet drejtimi profesional TIK. Në këto shkolla ka laboratorë të rinj kompjuterësh (2-3 vite) me server, kontroll qendror, etj. Të paktën për 5 shkolla profesionale (Shkodër, Tiranë, Kamzë, Elbasan) u siguruan në vitin 2012 në total 10 laboratorë TIK, 10 klasa të pajisura me dërrasa të bardha interaktive, aplikacione për materiale mësimore interaktive, sistemi i menaxhimit të klasës për e-mësim, rrjete dhe infrastrukturë kompjuterike (me Teknologjinë Zero Client, energji të pandërprere me UPS, laptopë, rrjetëzim me USB, shërbimet e fotokopjes dhe printimit). U ofrua trajnim edhe për mësuesit (CP, 2015). Shumë institucione kanë video projektor që përdoret për mësimdhënie dhe studim. Të gjithë ofruesit duhet të jenë të lidhur me internetin, por kjo nuk ndodh gjithmonë kështu. (GIZ / ETF,

2014) Në secilën nga 11 shkolla, ku ofrohet drejtimi profesional i ekonomisë, si pjesë e programit ALBIZ (2009-2013), u instalua një laborator (kompjuterë dhe pajisje zyre) dhe përdoret tashmë për modulën e trajnimit të biznesit - simulimi i aktivitetit ekonomik (Dokumenti i vlerësimit të Albiz, 2014).

Informacioni i dixhitalizuar, Materiali i kursit dhe mësimnxënia

Në nivel kombëtar, MMSR administron Portalin e arsimit dhe formimit profesional (www.vet.al) ku jepen informacione për ofertën AFP, materiale mësimore të hartuara nga AKAFP (që ofron informacione për kurrikulën dhe materiale mësimore në: <http://www.akafp.gov.al>), por që siguron edhe një numër të kufizuar librash elektronikë të prodhuar kryesisht me nisma të projekteve (GIZ në përgjithësi nëpërmjet projektit AFP për verilindjen në 2010) dhe materiale multimedia veçanërisht për elektroteknikën. Ky portal përdoret edhe për regjistrimin e problemeve. Çdo shkollë është përdorues dhe duhet të raportojë rregullisht numrin e nxënësve, braktisjet, numrin e mbetësve, notën mesatare për çdo profil dhe viti studimi, sipas gjinisë.

Në nivel ofruesi, GIZ/ETF (2014) analizoi institucionet publike ofruese, të dhënat e administratës së tyre, veçanërisht ato të dixhitalizuara, në kuadër të vlerësimit institucional. Të dhënat cilësore të mbledhura nëpërmjet intervistave evidentuan se përdorimi i mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave elektronike është ende në nivele të ulëta. Dokumentet e shkollës mbahen ende në formë letre kryesisht për

të dhënat që kërkohet sipas udhëzimeve administrative dhe ligjit, të tilla si pranimi i nxënësve, frekuentimi dhe përparimi i tyre, dosje e çdo anëtari të stafit. Shkollat e vogla, që dikur kanë pasur status vendor (në varësi të plotë të Ministrisë dhe nuk kishin asnjë lloj autonomie) nuk mbajnë fare të dhënat. Po ashtu, Sistemi i Informacionit për Menaxhimin, që do të bënte të mundur planifikim më të mirë, administrimin dhe vlerësimin e përditshëm të performancës së ofruesve, si përqindja e punësimit të të diplomuarve, nëpërmjet vëzhgimeve të të diplomuarve, mungon pothuajse në të gjitha institucionet e kontrolluara të ofruesve të AFP. Mungojnë plotësisht treguesit e kontabilitetit administrativ, si kostoja për nxënës/kursant/maturant sipas çdo kualifikimi të ofruar.

Gjithsesi, ka nisma të mira nga ofrues që po marrin masa paraprake për dixhitalizimin e informacionit për qëllime administrimi. Drejtuesit e Shkollës Industriale kanë filluar të krijojnë sistemin e tyre të informacionit të menaxhimit duke krijuar disa baza të dhënash elektronike për nxënësit, notat, matrikulimin e stafit, etj. Baza e të dhënave u programua nga stafi i shkollës. E njëjta gjë vlen edhe për Shkollën TIK në Korçë dhe Herman Gmeiner në Tiranë.

Mësuesit dhe TIK

Nga analiza e AKAFP (qershor 2015) u evidentua se si mësuesit ashtu edhe instruktorët kanë mangësi në përdorimin e mediave dixhitale në mësimdhënie. Në bazë të vëzhgimit të fundit nga ETF, vetëm 51% e mësuesve të intervistuar të AFP-së kanë marrë pjesë në trajnimin e TIK për mësimdhënie dhe vetëm 76% e tyre besojnë se ky trajnim kishte një efekt të moderuar ose pozitiv. I njëjti vëzhgim zbuloi se 77% e mësuesve deklarojnë se

kanë nevojë për këtë lloj trajnimi (Konini, 2015). Ofruesit e AFP nuk kanë fonde për trajnimin e mësuesve dhe kjo kufizon mundësinë e zhvillimit të vazhdueshëm. Aktorët ndërkombëtarë kanë kontribuar në këtë drejtim. Veçanërisht në TIK për mësimdhënie, GIZ po mbështet aktualisht mësuesit TIK në Shkollën e Kamzës duke mundësuar për ta Cisco Academy. Projekti Albiz ka një komponent të rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve në prezantimin e firmave të trajnimit si një modul, por raporti i vlerësimit tregon se në përgjithësi, aftësitë teknologjike të mësuesve të caktuar për të duket se janë shumë të kufizuara dhe të pamjaftueshme për të operuar pajisjet për përdorimin e synuar dhe kapaciteteve përkatëse të tyre. Në përgjithësi, mësuesit e caktuar për sallat e firmave të trajnimit nuk kanë nivelin e nevojshëm të TIK dhe ekspertizën për rrjetit me qëllim operimin e sistemit.

Vështrim në të mësuarit e përzier në AFP

Modulet e trajnimit të firmave të prezantuara në drejtimet profesionale të ekonomisë dhe biznesit mund të konsiderohen si shembull i mirë i përdorimit të teknologjisë, të mësuarit në distancë dhe rrjetëzimit në të mësuarit. Studentët e marrin këtë modul në klasat e sistemuara si zyra dhe përdorin simulatorë në lidhje me vendimet e biznesit dhe dinamikën e tregut. Çdo firmë trajnimi e krijuar në shkollë mund të marrë pjesë në panairin kombëtar dhe ndërkombëtar të firmave të trajnimit.³⁹ Mësuesit përdorin platformën në Internet www.al-biz.al për të komunikuar dhe për të shkëmbyer materiale. Në 10 shkolla u realizuan trajnime të mëtejshme për të përmirësuar përdorimin e platformës, në mënyrë që vetë mësuesit të mund të krijojnë

39 <http://www.alct-edu.com/index.php?l=e>

kurse dhe të mësojnë si të ndajnë materialet mësimore dhe të komunikojnë mes tyre. Probleme teknike po e kufizojnë efektivitetin e kësaj qasjeje. Dokumenti i vlerësimit të projektit thotë se lidhja me internetin në të gjitha zyrat e TF është shumë e dobët dhe kufizon punën efektive dhe përdorimin e pajisjeve. Mësuesit pranojnë se përdorin kompjuterin e tyre të shtëpisë, kur duan të shkarkojnë materiale mësimore ose kur kanë për të bashkëvepruar me qendra të tjera mësimore. Janë regjistruar vështirësi në shfrytëzimin e rrjetit kombëtar dhe ndërkombëtar të qendrave të kurseve dhe/ose platformave të instaluar; serverët, PC dhe konfigurimi i rrjetit duket se bëhen pre e manipulimit dhe keqpërdorimit sepse nuk kanë të programuar grupe përdoruesish me mbrojtje me fjalëkalime. Në shkolla mungon

një sistem i besueshëm për mbrojtjen e pajisjeve dhe programeve, një ditar elektronik me të dhëna për përdorimin e tyre, një sistem për mirëmbajtjen e thjeshtë dhe ndreqjen e problemeve të zakonshme, si dhe një ose dy mësuesit IT të angazhuar si administratorë sistemi për pajisjet e shkollës. Për më tepër, për pajisjet IT në shkolla shpesh mungon mirëmbajtja e rregullt, e cila mund të pengojë përdorimin e tyre të plotë për qëllimin e synuar. Shkolla Beqir Çela School kohët e fundit ka qenë e përfshirë në nismën iClubs Shqipëri.⁴⁰ Fondacioni Vodafone Albania dhe Këshilli Britanik e përkrahën iniciativën duke mbështetur përdorimin e inovacionit dhe teknologjisë në shkolla. Një grup i zgjedhur nxënësish dhe mësuesish TIK kanë zhvilluar projekte TIK që janë pjesë e një rrjeti online dhe marrin pjesë në konkurse

40 <http://www.britishcouncil.al/en/programmes/education/i-clubs>

Shtojca II: Aktorët Ndërkombëtarë në AFP dhe Punësimi në Shqipëri

Sistemi i Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri është keqfinancuar për shumë vite (buxheti AFP është rreth 14 milionë euro), pa autonomi financiare në nivel institucioni ofrues i AFP që do të mundësonte aktivitete fitimprurëse, një bashkëpunim minimal dhe kapacitete për rrjetëzimin me punëdhënësit dhe ofruesit e tjerë, gjë që do të bënte të mundur ndarjen e burimeve dhe përdorimin më efikas të inputeve. Në këtë mjedis, donatorët ndërkombëtarë luajtën një rol vendimtar në hartimin e politikave, me asistencë teknike, mbështetje për shërbimet e punësimit, futjen në tregun e punës, mundësimin e dialogut mes partnerëve socialë dhe ofrimin e AFP nëpërmjet investimeve në infrastrukturë, pajisje, mjete, trajnim të mësuesve, materiale mësimore, etj.

Shqipëria ka nënshkruar Deklaratën e Parisit për Koordinimin e Donatorëve dhe ka bërë progres në përvetësimin, menaxhimin e rezultateve, dhe llogaridhënien e ndërsjellë (rezultatet e 2008_. Departamenti i Strategjisë dhe Koordinimit të Donatorëve në Kryeministri është përgjegjëse për koordinimin e donatorëve ndaj prioritetëve të Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë siguron harmonizimin e mbështetjes së donatorëve me strategjitë kombëtare.

Donatorët në sektorin e AFP në mënyrë të veçantë koordinohen në mënyrë vullnetare në grupin DACH+ me pjesëmarrjen e projekteve të financuara nga qeveritë/agjencitë gjermanisht-folëse dhe të BE-së. Takimet e rregullta për vite me radhë i kanë ndihmuar aktorët ndërkombëtarë dhe kombëtare të shmangin mbivendosjet dhe

të koordinojnë ndërhyrjet e tyre në AFP dhe në sistemin e punësimit. Në kuadër të mbështetjes buxhetore IPA 2 (2015), Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave u krijua si qasje të re për të orientuar dhe monitoruar hartimin e politikave, zbatimin e strategjisë dhe vlerësimin dhe për të forcuar sektorin dhe koordinimin e donatorëve. Ky grup drejtohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ka si në anëtarësimi donatorët më të rëndësishëm (për sa i përket fondeve: KE, SDC, GIZ, ADA, ILO, etj.), si dhe ministritë e tjera. Dikur, ky funksion mbulohej nga Grupi i Punës i Sektorit (AFP), të kryesuar nga SDC. Në veçanti, SDC përmes takimeve të rregullta koordinon projektet e financuara nga qeveria zvicerane për të nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë, për të krijuar sinergji, dhe për të shmangur mbivendosjet.

Bashkimi Evropian mbetet donatori më i rëndësishëm në sektor përmes serisë së projekteve të IPA-s, CARDS, mbështetjes teknike ETF, dhe programit Erasmus+. Fondi më i fundit IPA 2 (2015) do të jetë në mbështetje të buxhetit për këtë sektor dhe do të kontribuojë financiarisht për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020. Ky fond është i konsiderueshëm (30 milionë euro) dhe do të shpërndahet në tre vjet. Ai do të rrisë me pothuajse 80% buxhetin vjetor për AFP (në varësi të aftësisë së MMSR për të planifikuar dhe shpërndarë planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive).

SDC është një tjetër donator i rëndësishëm në AFP. Aktualisht katër projekte plotësuese po vihen në zbatim dhe i katërti është ende në fazën fillestare. Projekti Risi Albania, zbatuar nga Helvetas dhe partnerët e tjerë vendorë, është përqendruar në tre sektorë ekonomikë (turizmi, TIK, agro-përpunimi) duke lehtësuar dhe rritur kërkesën dhe duke krijuar vende të reja pune për të rinjtë dhe gratë. Zbatuar nga UNDP, Aftësitë për Punësim (TEP 2) po asiston MMSR dhe institucionet në varësi të saj për të përmirësuar proceset ekzistuese dhe për të ofruar zgjidhje të reja që do të sjellin ndryshime në sistem dhe në nivel politikash. Programi i Sipërmarrjes, i zbatuar nga SECO, ka për qëllim t'u ofrojë sipërmarrësit aftësitë e nevojshme dhe mbështetjen për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve për të krijuar vende pune. Këshillimi për punësim, zbatuar nga Swisscontact, synon futjen në tregut të punës dhe integrimin e individëve në nevojë nga grupet e marginalizuara. Projekti i ri, Aftësi për Punë, që do të zbatohet nga Swisscontact, do të mundësojë një qasje novatore në ofrimin e AFP duke përdorur teknologjinë dhe rrjetëzimin si mekanizma për të krijuar institucione të qëndrueshme që ofrojnë AFP dhe rrisin punësimin e nxënësve.

Aktiviteti i donatorëve kryesorë në sektorin e AFP përmbledhet në tabelën e mëposhtme. Projekte të tjera të financuara nga donatorët përdorin zhvillimin e kapaciteteve si mekanizëm për të rritur sipërmarrjen dhe punësimin, kryesisht përmes zhvillimit jo-formal të aftësive, jo gjithmonë në bashkëpunim me ofruesit e AFP-së (p.sh., ndërmarrjetëvoglë të mesme që mbështesin e projekte nën koordinimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Sipërmarrjes, Tregtisë dhe Turizmi, programe të zhvillimit bujqësor të koordinuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave). Disa nga këto projekte janë të listuara në tabelën e mëposhtme. Për një listë më të

plotë, referojuni “Përmbledhje e Zhvillimit Kombëtar të Aftësive Profesionale – Kuadri i Zhvillimit të Arsimit Profesional”, përgatitur për SDC nga Delina Nano në maj 2015. Ka projekte të tjera të vogla dhe ndërhyrje në nivel ofruesi të AFP nga OJQ-të vendore dhe OJQ ndërkombëtare (p.sh., mbështetja DORCAS në rajonin e Korçës).

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
IPA 2015	Mbështetje buxhetore për sektorin social (30 M euro për 3 vjet; pritej të niste në 2016)	Mbështetje financiare për MMRS për arritjen e këtyre objektivave: - të rrisë pjesëmarrjen në tregun e punës dhe të sigurojë mundësi punësimi për të gjithë (gratë, të rinjtë, grupet e marginalizuara) - të përmirësojë cilësinë dhe të rrisë përpapjen e AFP (Kompetencat e mësuesve të AFP-së dhe trajnerëve mësues; të shtrijë ofertën AFP në zonat rurale dhe për grupet më të marginalizuara, përshtatje më e mirë e ofertave të AFP-së dhe mundësitë e punësimit, të zhvillojë dhe zbatojë Korniza Shqiptare e Kualifikimeve KSHK) - të përmirësojë cilësinë dhe efektivitetin e institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës, dhe e organeve përgjegjëse për zbatimin e SKPA 2014-2020	Politika Ofrim formal AFP	NP	NP	NP		*	*	
IPA 2013	Mbështetje për arsimin dhe formimin profesional të orientuar nga punësimi (3.45 M euro; pritej të niste në 2015)	Projekti do të përmirësojë efikasitetin e brendshëm të sistemit të AFP-së përmes përmirësimit të infrastrukturës së butë (menaxhimit efikas dhe efektiv të institucioneve të tregut të punës dhe ofruesve të AFP-së), si dhe personelit të mirë kualifikuar. Projekti do të prezantojë qendra multifunkionale të AFP-së, si ofrues më të mëdhenj dhe efikas duke ofruar kurse të reja afatshkurtra dhe praktike, shumë të përgjegjshëm ndaj nevojave të tregut të punës.	Ofrim formal AFP	ND; EN; TR	Shkodra	A. Broci (+K. Margjini, QFP Shkodra)		*		*
				Të gjitha	Elbasan	A. Myftiu (+ S. Ceka, Elbasan QFP)				
				TR; EN; TIK; Industria kimike	Fier	QFP Fier (+P. Sota)				

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
IPA 2011	Mbështetje për përshirjen sociale të komunitetit rom egjiptian (1.695 M euro përfunduar kohët e fundit)	Projekti mbështet përshirjen sociale të komuniteteve rom dhe egjiptian në Berat, Korçë dhe Vlorë, duke ofruar, ndër të tjerash, ndërhyrje për zhvillimin e aftësive.	Ofrim jo-formal AFP vendor; LMI	AG; TO; TIK; TX	Berati, Korça, Vlorë	Në vendin e punës		*	*	
ETF	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe instruktorëve të AFP-së (në rajonin e Ballkanit dhe Turqijë)	Qëllimi i projektit është të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm për mësuesit dhe trajnuesit në AFP në rajonin e Ballkanit dhe Turqijë me anë të: përmirësimit të cilësisë dhe orientimit sipas kërkesës; përmirësimit të bashkëpunimit dhe aftësive të palëve të interesuara; mbështetjes për hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre; zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve praktike dhe novatore. Është realizuar një studim rajonal dhe zhvillimi i aftësive profesionale do të pilotohet në 1 ose 2 institucione ofruese	Ofrim formal AFP	Të gjitha	Elbasan Tiranë Durrës?	A. Myftiu QMF Kamez Beqir Cela?	*	*	*	
	Mbështetje për hartimin dhe zbatimin e Kuadrit Shqiptar të Kualifikimeve	Ligji KSHK dhe manuali KSHK do të hartohen me lehtësimin nga ETF, duke i dhënë përgjigje pyetjeve të rëndësishme të tilla si hartimi i kurrikulave, reforma për profesionet, komitetet sektoriale, etj.	Politika					*		*

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
BE/ Erasmus+	Skema e praktikës për punësimin e të rinjve në Shqipëri (250,000 euro; 2015- 2017)	Synon të identifikojë një mënyrë të qëndrueshme për zbatimin e praktikës si skemë sistematike dhe rigoroze të skemës së të mësuarit në vendin e punës në AFP. Projekti po zbatohet në bashkëpunim mes AFP-së dhe Hamburger Institut für Berufliche Bildung (HIBB), në sektorin e turizmit, me mbështetjen e Shoqatës Shqiptare të Turizmit.	Politika Ofrim formal AFP	TR	Tirana	Hoteleri-Turizmi QMF Kamza		*		*
SDC/ Helvetas	RISI Albania (4.5M franga zvicerane; 2013-2016)	Projekti ka për qëllim rritjen e punësimit të të rinjve me anë të (i) rritjes së kërkesës (për punë); (ii) ndërmjetësimit për punë; dhe (iii) përmirësimit të furnizimit (aftësitë e fuqisë punëtore). Në sektorin e IT, projekti lehtëson procesin	Sipas kërkesës	TO; TIK; AP			*			*
		Sektori i turizmi: (rritja e kërkesës (për punë) - lehtëson zhvillimin e produkteve të reja (të turizmit natyror) - trajnime -të organizuara për guida turistike - mbështetje për një kuadër ligjor të turizmit të shëndoshë (së shpejti)	Formim profesional (jo) formal	TO				*		*
		Agropërpunimi (rritja e kërkesës (për punë) --8 ofrues shërbimesh u trajnuan për 'diagnostik' (instrumente specifike jo të nxitur nga donatorët) - mbështetje për paketa certifikimi për bizneset (partneriteti me Albinspect) - bashkëpunim me bankat për të hartuar një sistem kreditimi përshtatur për bizneset bujqësore duke përdorur zgjidhje krijuese të biznesit, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Marketingut	Formim profesional (jo) formal	AP						

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J				
							TIK/BL	AFP	LMI	BR	
SDC/ Helvetas	RISI Albania (4.5M franga zvicrane; 2013- 2016)	Sektori TIK (ritija e kërkesës (për punë)	Platformat TIK	TIK			*			*	
		Në zhvillimin e programeve, projekti lehtësoi / promovoi									
		- Përdorimin e platformën e të mësuarit online ALMOOC për nxënësit TIK (nxënësit më të mirë punësohen nga themeluesi) - përdorimi i akademi Microsoft IT për nxënësit TIK (në pritje të MMSR për të blerë 1 licencë) Në proceset e biznesit, krijohet Shoqata Shqiptare e Outsourcing kryesisht me call center si gjeneratorë të punësimit, sidomos për të rinjtë.									
		Në komponentin e ndërmjetësimit për punë: - bashkëpunim me agjencitë e punësimit, si www.duapune.com ; - informacion për tregun e punës në mediat kryesore: tre organizata të mediave kryesore me mbështetjen e vazhdueshme të RISI-s po përhapin aktivisht informacione për tregun e punës për punëkërkuarët e rinj dhe prindërit e tyre, duke përmirësuar kështu arsimin dhe mundësitë e tyre për punë dhe karrierë	rrjetëzim & marketing				*			*	
		Në komponentin e Zhvillimit të aftësive: - të propozojë strukturë për komitete të aftësive të sektorit komitetet për të përmirësuar programet, duke filluar me sektorin e Turizmi. Këto struktura janë përfshirë edhe në projektligjin për AFP-në; që mendohet të punojnë me AKAFP					*			*	

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
SDC/UNDP	afësi për punësim (3.171 M franga zvicerane; 2014-2018)	Oëllimi i projektit: "Më shumë të rinj e të reja në zonat urbane dhe rurale në Shqipëri janë të punësuar apo të vetëpunësuar". Ndërhyrjet e përzgjedhur do të mbështesin me ndryshime në nivel sistemi dhe politikash, duke përmirësuar procesin ekzistues ose krijimin e atyre të reja. Komponentët e tij dhe statusi i zhvillimit (28/10/2015) janë: 1.Qeverisja e sistemit AFP - Programet e punësimit shqyrtohen dhe më pas sugjerohen programe të reja - po hartohet një sistem i ri për hartimin dhe zbatimin e programeve të arsimit (për të shmangur thjesht formalizimin e punësimit dhe për të përmirësuar procedurat/thirrjet/proceset e aplikimit) - po ndërmerret një studim si të përhapet SKPA në zonat rurale - u përgatit udhërrëfyesi për kalimin e shkollave të arsimit profesional tek MMSR; u bënë rekomandime për qeverisjen e sistemit AFP dhe ofertën e AFP-së 2.Të mësuarit në vendin e punës - studim për gjendjen e të mësuarit në vendin e punës është tashmë në rrugë e sipër - një platformë për ofertën e formimit profesional po hartohet për të siguruar informacione online për publikun dhe ofruesit privatë 3.Sigurimi i cilësisë (pa nisur ende, por do të hartohet dhe pilotohet një sistem për sigurimin e cilësisë) 4.Parashikimi i aftësive - po krijohen instrumente informacione afatshkurtra dhe afatmesme për nevojat e tregut të punës; - po shqyrtohen listat e profesioneve me asistencë nga sektori privat (Biznes Albania)	Politika				*	*	*	*

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
SDC/ Swisscon- tact	Këshillim për punësim	Zbatuar në partneritet me SHKP dhe MMSR dhe ka për qëllim futjen në tregun e punës dhe integrimin e individëve në nevojë nga grupet e marginalizuara, nëpërmjet punësimit ose vetëpunësimit.	LMI						*	*
	AlbVET	I konsideruar si një nga projektet më të suksesshme të AFP-së në Shqipëri, disa nga zgjidhjet dhe mekanizmat e tij mund të zbatohet edhe në zona të tjera. Projekti: (i) rinovoi profilin termohidraulik në të gjitha shkollat profesionale, bazuar në qasjen e të mësuarit bazuar në projekte; (ii) pilotoi një kurs pas shkollës së mesme për praktikantët IT; (iii) trajnoi mësuesit IT nga 17 shkollat e AFP; (iv) nxiti pjesëmarrjen e sektorit privat në AFP nëpërmjet të mësuarit në vendin e punës; (v) zhvilloi trajnime pastičeri dhe parukeri si partneritet për të mësuar mes qendrave private të trajnimit dhe bizneseve. (vi) mbrojti AFP si çështje me interes publik në Shqipëri dhe kontribuoi në reformën e politikave në AFP	AFP formal	TIK; ND; etj.				*	*	*
SDC/ SECO	SECO Program i sipërmarrjes (2015-2019)	Programi i Sipërmarrjes ka për qëllim t'u ofrojë sipërmarrësve aftësitë e nevojshme dhe mbështetjen për hapjen dhe rritjen e bizneseve për të krijuar vende pune nëpërmjet përmirësimit të arsimit për sipërmarrjen duke mbështetur bizneset e reja, duke lehtësuar aksesin tek financimet dhe duke nxitur aktorë të ndryshëm që janë të përfshirë në sipërmarrje.	Ofrim jo-formal i AFP; LMI	NP					*	*

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
GIZ	Programi i arsimit dhe formimit profesional, Shqipëri (EUR 8.02M; 2010-2016)	Mbështetje për Qendrën Multifunkionale të AFP-së në Kamëz që të bëhet një ofrues kryesor i AFP-së, që i përgjigjet nevojave të tregut të punës, duke ofruar arsim dhe kurse afatshkurtra. Ai mbështet sektorin e TIK, turizmit dhe shërbimeve shëndetësore. U rishikua kurrikulat TIK dhe u sigurua për mësuesit trajnimi në internet (Cisco akadem) dhe për nxënësit (ALMOOC). Mentorët në bizneset janë të trajnuar për të mësuarit në vendin e punës (në shërbim e kujdesit shëndetësor).	Provision	TO; TIK; Health Services;	Tirana	QMF Kamza	*	*	*	*
		Të hartojë së bashku me AKAFP një Strategji për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore dhe mbështetjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për stafin administrativ dhe mësimdhënës në sektorët e zgjedhur. Do të zhvillohet një rrjet trajnerësh të trajnuar si politika dhe mjete për përfaqëse për të gjithë sistemin (nga AKAFP)	politika; ofrim	CN; TO; TX; AP	TBD	TBD		*		*
		Prezantimi i një sistemi gjurmimi për të rritur efikasitetin e Sistemit të Informacionit të Tregut të Punës. Është krijuar një mekanizëm gjurmimi dhe është pilotuar për 3 vjet në QMF Kamëz. Në këtë fazë po zgjerohet tek ofruesit në qarkun e Tiranës, si hap i ndërmjetëm për nivelin kombëtar.	politika; ofrim	Të gjitha	Tirana	Të gjitha		*	*	
		Rishikimi i kuadrit ligjor për AFP; reforma në sektorin AFP - proces i vazhdueshëm; GIZ është partner strategjik	Politika	NP						

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
GIZ	Rritja e konkurrenshëmërisë së NVM duke nxitur novacionin dhe sipërmarrjen (ProSME)	Objektivi kryesor është rritja e konkurrenshëmërisë së NVM-ve në sektorët kyç me promovimin e novacionit dhe sipërmarrjes. Projekti është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Investimeve dhe Biznesit 2014-2020 dhe me shtyllën e saj 2 për Rritjen e Zgjuar. Qëllimi i projektit: 100 themeluesit e bizneseve të reja (të këtyre të paktën 50% femra) kanë marrë pjesë në masat e zhvillimit të sipërmarrjes (trajnime të orientuar drejt veprimit të sipërmarrjes, mbështetje teknike, mbështetje me financim, krijimin e rrjeteve).	Trajnim jo formal	NP	Tirana, Korça, Shkodra (për t'u vendosur)			*		*
ADA	Forcimi i trajnimit të dyfishtë në industrinë e veshjeve në Shqipëri	Mbështetja për hartimin e kurrikulës dhe mësim dyfishtë në industrinë e veshjeve, nëpërmjet mbështetjes së partneritetit të biznesit. NABOUR është një kompani private që po bashkëpunon me sukses me ofruesit e AAP në tekstil.	Orfrimi i formimit profesional	TX	Durrës	Hysen Cela		*	*	*
	Mbështetje për arsimin profesional në fushën e saldimit	Mbështetje në trajnimin për saldator në qendra të ndryshme nëpërmjet mbështetjes së partneritetit me biznesit; Firma WiFi, e licencuar për kurse saldimit po bashkëpunon me QPF për të ofruar kurse afatshkurtra	Ofrimi i formimit profesional	CN; EN; TR	Tirana, Elbasan, Durrës	QPF e Tiranës 4, Elbasan, Durrës		*	*	*

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
ADA	SEED – Arsime dhe punësim për të rinjtë dhe gratë (2014 –2016)	Hartimi i mekanizmeve për bashkëpunim dhe pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve që janë aktivë në fuqizimin e të rinjve dhe grave; Sistemi publik i AFP do të përfshihet në ofrimin e trajnimit për përfutjesit e projektit. Ndërmjetësimi për punësimin e grave dhe të rinjve do të nxitet nga veprimet që kanë për qëllim punësimin e qëndrueshëm në bashkëpunim dhe rrjetëzim me qeverisjen vendore, institucionet publike, OJQ-të e tjera, sektorin privat dhe grupimet përkatëse.	Hartim politikash	NP	NP	NP			*	*
ADA/KulturaturKontakt	Mbështetje për Shkollën TIK ‘Herman Gmeiner’	Shkolla TIK ‘Herman Gmeiner’ është krijuar dhe po mbështetet vazhdimisht me infrastrukturë, trajnim mësimor, hartim kurrikulash, etj.		TIK	Tirana	H. Gmeiner		*	*	*
	Mësimi i sipërmarrjes	Nëpërmjet këtij projekti, shkollat hoteleri-turizëm mund të bashkëpunojnë me konviktet e nxënësve për të kryer modulet e praktikës dhe rritjen e aftësive për sipërmarrje (për t'u konfirmuar)	Ofrim	TO	Shkodër	H. Bushati		*		
	Menaxhim i qëndrueshëm i arsimit në Shqipëri	Mbështetje e sistemit të menaxhimit të informacionit nëpërmjet partneritetit të biznesit me BIT Shqipëri duke prezantuar Sokrates Web (sistem administrimi shkolle dhe ITS (e-Testing), Përmbytja eLearning Përmbytja, SITOS (mësimi i sistemit të menaxhimit). Po mbështetet klasën virtuale. U hap në 60 gjimnaze dhe janë marrë mendimet e para. Projekti do të zgjerohet.	Arsim i përgjithshëm				*			*

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
							*	*		*
ADA/Kul- turKontakt	ALBIZ (2009-2013)	Projekti asistoi shkollat e ekonomisë dhe biznesit në: - zhvillimi i cilësisë së shkollës dhe sigurimi i cilësisë (Përfaqja "Planifiko-Bëj-Kontrollo-Vepro" çdo vit dhe marrja e vendimit për qëllimet e zhvillimit të aftësive për vitin e ardhshëm shkollor - administrimi i shkollës në përputhje me nevojat rajonale - përshtatja e kurrikulës (sipas nevojave të tregut të punës) - trajnimi i mësuesve për metodat moderne të mësimdhënies - prezantimi i firmave të trajnimit klasat sistemohen si zyra dhe përdoren simulatorë për marrje vendimesh biznesi dhe për dinamikat e tregut Mësuesit përdorin platformën në Internet www.al-biz.al për të komunikuar dhe për të shkëmbyer materiale. - intensifikimin e rrjetimit të shkollës duke prezantuar PASO (mësuesi përgjegjës për marrëdhëniet me biznesin) - balancimi gjinor Në fazën e tij përfundimtare, projekti u shtri edhe në shkollat e arsimit profesional në turizëm dhe agrobiznes	Ofrim	ekonomi; TO; AG		13 ofrues në ekonomi (+ TO, AG)	*			

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
Bashkëpunimi Italo-Shqiptar për Zhvillimin (Protokolli dypalësh 2014-2016)	Arsimi dhe formimi profesional nëpërmjet novacionit (5 M euro, hua e butë; 2015-2016)	Do të krijohet një qendër e ekscelencës në bujqësi dhe agropërpunim për të ofruar kualifikime profesionale në përputhje me tregun e punës. Ndërhyrjet do të përfshijnë ndërtimin e shkollës dhe konviktit, ngritjen e laboratorëve dhe bazës prodhuese me pajisjet e nevojshme. (Kontrata është nënshkruar në dhjetor të vitit 2015 dhe nuk ka detaje të tjera.)	Ofrim	AG; AP	Fier, Lushnje	Mekanike Bujqësore R. Kryeziu		*		
	IADSA - Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (20 M euro; 2014-2020)	Fashion-VET AL- koordinuar nga MMSR, synon të zhvillojë një formim profesional të orientuar drejt tregut të punës në operacionet e vlefshme të prodhimit të lëkurës dhe këpucëve për të përmbyshur standardet evropiane. Nxit të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe synon punësimin dhe vetë-punësimin e grupeve të marginalizuara.	Ofrim (2 vjet)	TX	Tirana	Shkolla ekonomike- teknike		*		
		MECAVET- Aftësim dhe Edukim Mekanik Profesional për Rininë, koordinuar nga MMSR, qëllimi i projektit është të rrisë punësimin e nxënësve të mekatronikës duke prezantuar mënyra të reja bashkëpunimit mes sektorit privat dhe një ofruesi të menaxhuar mirë të AFP-së. Shkolla mund të organizojë trajnime për firmat private.	Ofrim (jo formal dhe formal)		Shkodër	A. Broci		*	*	*

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
Bashkëpunimi Italo-Shqiptar për Zhvillimin (Protokolli dypalësh 2014-2016)	IADSA - Programi i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (20 M euro; 2014-2020)	DEV-OPS - koordinuar nga Ministria e Ekonomisë, qëllimet kanë të bëjnë me trajnime për një kurs 4-mujor, të deri në 70 profesionistëve të rinj në sektorin e Turizmit, veçanërisht për guida lokale turistike; marketingun dhe promovimin e produkteve tipike lokale; hotelieri dhe akomodim i turistëve, dhe gjuhë angleze.	Trajnim (jo)formal	TO	Skrapar, Berat			*		
								*		
ILO	Veprim i mbështetur nga buxheti i rregullt	RISE-OP - Mundësitë Ekonomike Gjithëpërfshirës Rurale dhe Sociale. Qëllimi i projektit është të luftojë posaçërisht emigracionin, të krijojë ekonomi, mundësi punësimi dhe sipërmarrje të reja për të papunët: gratë rurale dhe të rinjtë përmes trajnimit profesional në shërbimet e turizmit dhe në aftësitë për art dhe vepra artizanale.	Trajnim (jo)formal	TO	Permet					
		Ofron asistencë teknike për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për mbështetjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2014-2020 si dhe marrëdhëniet e saj me punën përgatitore të nevojshme për ciklin e ardhshëm të financimit IPA II në këtë sektor.	politika							

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
ILO	Projekti IPA 2010 për Zhvillimin e burimeve njerëzore në Shqipëri (3M euro; 2012-2015)	Projekti kishte për qëllim përmirësimin e institucioneve të tregut të punës dhe rifitjen e punësimit të fuqisë punëtore në Shqipëri. Komponentët: Modernizimi i Inspektoratit Shtetëror të Punës; Modernizimi i Shërbimit Kombëtar të Punësimit; Reforma e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Hartimi i SKPA 2014-2020 është lehtësuar nga ky projekt. Instrumentet e zhvilluara dhe pilotuara janë me vlerë të shqyrtohen për evidentimin e ndërhyrjeve në rrjetet rajonale, sigurimin e cilësisë së AFP-së NJMP, duke përdorur TIK në nxitjen e punësimit dhe SNA, etj.	politika				*	*	*	*
Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit	Junior achievement (arritja e të rinjve) (2012-në vazhdim)	Synon të nxisë gatishmërinë për punë, sipërmarrje, dhe aftësi të njohjes së financave tek nxënësit e shkollave të mesme dhe përdor të mësuarit nga përvoja për të frymëzuar nxënësit të arrijnë potencialin e tyre. Projekti shtrihet në një rrjet të gjerë shkollash të mesme të përgjithshme dhe profesionale.	Trajnim jo-formal		Të gjitha qarqet	Tregtare, Pavarësia K. Gjoka		*	*	

Donatori/ agjencia	Projekti	Përshkrimi	Niveli	Sektori	Rajoni	Ofruesi	Komponenti S4J			
							TIK/BL	AFP	LMI	BR
	PROTIK	ProtiK është një qendër e burimeve TIK dhe synon të bëhet qendra shqiptare për TIK: një pikë lidhjeje për ata që kërkojnë ide, produkte dhe shërbime të reja dhe më të fundit. Qëllimet e ProtiK: të nxisë risitë dhe sipërmarrjen; Të ndihmojë në krijën e kërkesës për TIK; të promovojë rritet dhe partneritetet. Partnerët e saj janë: USAID, AADF; CISCO; MICROSOFT; ALBTELECOM. Ka një laborator të praktikës, një klub për novatorët e rinj dhe projekte të tjera për të nxitur risitë përmes TIK. Mjaft të hapur për të bashkëpunuar dhe kanë një rrjet të gjerë.	Trajnim jo-formal					*		*
	Shkolla bujqësore e ekselencës (së shpejti)	Shkolla është përfshirë/do të përfshihet në një projekt binjakëzimi me një shkollë bujqësore në Selanik të Greqisë. Për momentin projekti është në pritje.	Arsimi formal	AG	Korçë	I. Terova		*		
Këshilli britanik	Arsim nëpërmjet novacionit dhe teknologjisë (2015-2017)	Projekti Innovation-Club (I-CLUB) ka për qëllim të mbështesë gjimnazet e përgjithshme dhe ato profesionale me profil IT, të përdorin teknologjinë krijuese, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe rritur aftësitë krijuese e novatore të nxënësve.	ofrim (të mësuarit përmes projekteve)	TIK	Durrës	B. Cela	*	*		
	Aftësi për zhvillim profesional (2012-2015)	promovojmë përdorimin e gjuhës angleze në shkollat profesionale, kryesisht ato me profil IT. Qëllimi i përbashkët është përmirësimi dhe modernizimi i sistemit të arsimit profesional në Shqipëri për të qenë në përputhje me standardet evropiane. (është në plan për të vazhduar)	ofrim (trajnimi i mësuesve të an-glishtes)	TIK; TO	NP		*	*		

nb: me gri janë listuar projektet e përfunduara kohët e fundit por që kanë ndikim në sistemin AFP dhe që përdorin zgjidhje efektive. Shkurtime e sektorit: B – Bujqësi; AP – Agropërpunimi; TO – Hoteleri-Turizëm; TX – Tekstili; TR – Transport; ND – Ndërtim; TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit